



# Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.367 | Prill 2022 | Shaban - Ramazan 1443 | Çmimi 50 den



*Lutje për paqe kudo në botë*



# APEL PËR EVITIMIN E LUFTËRAVE

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 1 maj, 2022, në Xhaminë e Sahatit në Gostivar bëri lutje për paqe në botë dhe apeloj për evitimin e luftërave kudo që janë, në veçanti në Ukrainë, ku çdo ditë po vriten njerëz të pafajshëm dhe ngadalë po rrezikohet paqja në botë. Ai iu lut Allahut të Madhërishëm që të mbretërojë arsyja e shëndoshë dhe imazhet e dhimbjes, gjakderdhjes dhe shkatërrimit të mos përsëriten më, thuhet në njoftimin e BFI.

Këto lutje Kryetari i BFI i bëri në ditën e fundit të Ramazanit, në solemnitetin me rastin e kryerjes së leximit të Kuranit, "Mukabelja qendrore". Në Xhaminë e Sahatit ishin të pranishëm

hafëzllarë dhe imamë, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli me bashkëpunëtorë, shumë xhematë dhe përfaqësues të medias në vend. Njëherësh, ai i bëri lutje Allahut Fuqplotë që të gjitha ibadetet e bëra gjatë muajit të Ramazanit t'i bëjë kabull për të gjithë besimtarët.

Në Mesazhin e Paqes thuhet:

"Sot nga Gostivari edhe një herë theksuam se paqja në botë është më e shtrenjta që mund të kemi dhe se krejt potencialin tonë duhet ta vëmë në shërbim të kultivimit të saj.

Andaj, plotësisht solidarizohemi me popullin ukrainas, i cili është viktimë e agresionit të paparë rus, që merr jetë fëmijësh, grash e burrash të pafajshëm,

bën shkatërrimin e gjithçkaje dhe rrezikon paqen në botë.

Me lutjet tona, në emër të BFI të RMV drejtuar të Madhit Zot, që ta ngre vetëdijen te të gjithë faktorët relevantë të botës që sa më shpejt të ndalet kjo luftë, për të mirën e kombeve dhe të njerëzimit në përgjithësi.

Paqja mbi gjithçka. Amin."

Imazhe nga Lutja për Paqe, posaçërisht në Ukrainë, janë shpërndarë me shpejtësi nëpër të gjitha agjencitë e lajmeve dhe mediet në mbarë botën.

Lutja për paqe në botë vjen si pasojë e invazionit rus në Ukrainë, që po rrezikon paqen në kontinentin evropian dhe në tërë botën. Fotografia nga Xhamia e Sahatit është titulluar "Lutje për Paqe në Ukrainë", thuhet në njoftimin e BFI.

## ËMBËL, PËR TËRË BOTËN

Në ditën e parë të Bajramit, më 2 maj, 2022, në mbrëmje, në hotel "DoubleTree by Hilton" në Shkup u organizua ceremonia "Bakllavaja e Bajramit", me pjesëmarrje të gjerë të të ftuarish, thuhet në njoftimin e BFI.

Morën pjesë përfaqësues të pushtetit lokal dhe qendror, Ambasadori i BE, i OSBE, i Gjermanisë, i Kroacisë, përfaqësues të ambasadave të tjera, ministra dhe zv/ministra, z. Ali Ahmeti (BDI), z. Basri Bajrami dhe Arianit Hoxha nga Lëvizja Besa, z. Xhemal Çupi dhe zv/ministri z. Abdushekur Abedini (të ardhur nga partia Alternativa), pastaj z. Kolasinac-kryetari i Partisë së Lidhjes Boshnjake, z. Shaban Saliu (Forcat Demokratike të Romëve), Kryetarja e Qytetit të Shkupit Daniela Arsovska, Kryetari i Kërçovës Fatmir Dehari, gazetarë e analistë të mirënjohur, si: Seladin Xhezairi, Harun Ibrahim, Xhelal Neziri, Mersel Bilalli, Myftinjte e Myftinive, Drejtorë të Rijasetit, Dekani i FSHI, Drejtori i Medresesë Isa Beu, referentë të Myftinive dhe shumë mysafirë të tjerë, nga sfera e ndryshme të jetës politike-shoqërore, diplomatike, fetare, kulturore e mediale.

Me këtë rast, para të pranishmëve Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu tha:

"Të nderuar mysafirë, zonja dhe zotërinj.

Më lejoni që në emër të Bashkësisë



Fetare Islame, në emër të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut dhe në emrin tim personal, t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe me krenari ta çmoj respektin që po bëni ndaj nesh në këtë festë të madhe të Fitër-Bajramit. S'ka dyshim se çdo festë është më madhështore kur ndahet bashkërisht.

E, si do të ishte bota sot sikur të gjithë njerëzit të ishim njësoj?

Zoti na krijoi të ndryshëm, me qëllim që të njihemi mes vete, të respektohem mes vete. Ndaj, edhe festat i kemi të ndryshme, por me qëllim të qartë: ato na mundësojnë që nga afër ta njohim njëri-tjetrin nëpërmjet respektit të ndërsjellë, nëpërmjet njohjes së vlerave të tjetrit.

Duke ndarë çaste nga koha juaj e çmuar sot, ju, të nderuar të pranishëm, dëshmuat se BFI dhe myslimanët e këtij

nënqielli kanë shumë miq dhe dashamirë, andaj si të tillë do t'ju trajtojnë gjithmonë.

Do të ishte një mrekulli e vërtetë sikur në mbarë rruzullin tokësor të mbretëronte paqja dhe ky lloj respekti që po e përjetojmë ne sot. Por, për fat të keq, edhe pse jemi në shekullin 21, akoma ka njerëz të cilët nëpërmjet forcës dhe dhunës synojnë t'i realizojnë ëndrrat dhe ambiciet e tyre.

Prandaj, i bëjmë lutje Allahut të Plotfuqishëm që arsyeja dhe paqja të mbretërojnë në vend të dhunës, të shtypjes dhe pushtimit.

Tani, më lejoni që t'ju ftoj që të ndajmë disa momente të ëmbla me Bakllavanë e Bajramit."

Në kohë reale, ceremonia "Bakllavaja e Bajramit" u transmetua drejtpërdrejt në platformat elektronike të BFI.

## NDARJA NGA RAMAZANI...

Në dallim nga dy vitet e kaluara, sivjet, si rezultat i largimit të pothuajse të gjitha masave restriktive lidhur me mbrojtjen e shëndetit nga pandemia covid-19, muajin e Ramazanit e pritëm, e përjetuam dhe e shiuam "si më parë".

Nëpër xhamitë tona u rikthye prezenca masive e besimtarëve, u rikthye falja kolektive e namazeve pa distancë, u rikthyen vizitat ramazanie, u rikthyen manifestimet e ndryshme që organizohen gjatë këtij muaji të bekuar, u rikthyen iftaret e përbashkëta - me një fjalë, u rikthye ambienti dhe atmosfera e zakonshme e Ramazanit.

Të vetëdijshëm se vjen koha kur duhet të ndahemi nga ky muaj i bekuar, secili besimtar bën përpjekje që sa më shumë të përfitojë nga begatitë e Ramazanit, të përfitojë shprehje kreative dhe shprehje vepërmirësie, të cilat duhet t'na përcjellin edhe pas Ramazanit. Gjatë këtij muaj, secili prej nesh me dijen dhe aftësitë e veta është përpjekur që të përfitojë sa më shumë nga të mirat dhe begatitë e Ramazanit. Por, se çfarë gjurmësh ka lënë Ramazani te ne dhe sa kemi arritur të bëhemi të devotshëm me agjërimin, do të shihet në veprimet tona jashtë këtij muaji.

Pra, duhet vazhduar me ibadete dhe vepra të mira; në radhë të parë, për të përfitur kënaqësinë e Allahut (xh. sh.) dhe për të treguar se nuk jemi besimtarë sezonal, që vetëm për Ramazan i përkushtohemi Islamit, duke e praktikuar atë. Gjithsesi, besimtari i sinqertë gjatë ndarjes nga Ramazani në shpirtin e tij e ndjen dhembshurinë e ndarjes; aq më tepër, kur nuk e di se a do ta përjetojë edhe një herë kënaqësinë dhe ambientin e muajit Ramazan në vitin tjetër.

Preokupimi tjetër, ndërkaq, i besimtarit të vërtetë e të sinqertë pas Ramazanit është vazhdimi i kryerjes së veprave të mira. Do të ishte mëkat i madh nëse menjëherë pas Ramazanit zhytet në gjynahe dhe e shkatërron çdo gjë të arritur dhe të ndërtuar gjatë Ramazanit.

Në fakt, nga Ramazani besimtari del më i fortë në çdo aspekt. Zemra e tij është mbushur me iman - që është një shtytje dhe rast i mirë për kryerjen e veprave të mira, për të bërë kthesë kah e mira, duke u larguar prej së keqes; kthesë kah toleranca, duke i lënë zënkat dhe ngatërresat; kthesë kah mirëqenia dhe humaniteti, duke ikur nga egoizmi dhe veset tjera të këqija; kthesë kah dashuria dhe paqja, duke u larguar nga konfliktet dhe urrejtjet.

Përmes agjërimit mësuam që të jemi më të disiplinuar, më modestë, më vetëmohues, më të matur, më bujarë, më të çiltër, më fisnikë dhe më solidarë. Këtë bagazh me virtyteve të fituara, gjithsesi duhet ta shfrytëzojmë në jetën tonë të përditshme edhe gjatë kohës pas Ramazanit.

Mësuam se si duhet bërë vetëkontrolli, duke u nisur, në radhë të parë, nga vetvetja jonë, nga familja jonë, nga të afërmit tanë e kështu me radhë, gjithnjë në përpjekje për të ndryshuar gjendjen tonë për një lumturi dhe begati më të madhe për të gjithë njerëzit. Me siguri, në këtë drejtim edhe ndihma e Allahut (xh. sh.) nuk do të mungojë. Me një fjalë, obligimet tona si besimtarë duhet t'i zbatojmë edhe pas Ramazanit, ndërkaq, satisfaksion për dëshpërimin nga ndarja nga ky muaj është falja e namazeve të përditshme, dhënia e zeqatit, kryerja e haxhit - për ata që kanë mundësi materiale dhe shëndetësore etj.

Me rastin e ndarjes nga muaji i Ramazanit, këtij miku të madh i shprehim lamtumirën tonë, duke e lutur Allahun e Plotfuqishëm që t'na i pranojë të gjitha ibadetet e bëra gjatë muajit Ramazan dhe t'na mundësojë që përsëri të takohemi me të, respektivisht t'na mundësojë që të përjetojmë atmosfera dhe begati të më shumë ramazaneve, në të ardhmen.

Q. Osmani



## MESAZHI PËR FITËR-BAJRAM



قَدْ أَفْلَحَ مَنْ تَزَكَّى وَذَكَرَ اسْمَ رَبِّهِ فَصَلَّى

**Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!**

**“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që falet.” (El A'la: 14-15)**

Të nderuar besimtarë e besimtare, vëllezër e motra.

Jemi në kulmin e përjetimit të gëzimit të thellë të festës së madhe të Fitër-Bajramit. Po e përcjellim mysafirin tonë të dashur dhe të begatë, të bindur se me përkushtimin më të madh e kryem kushtin themelor të Islamit - agjërimin e ditëve të tij, që e përshkon gëzimi i madh, me çka dëshmuam vetëdijen e lartë dhe përkushtimin tonë të madh se lidhja jonë me Zotin është bindje e thellë në zemrat, në të menduarit dhe në jetën tonë praktike, konform fjalëve të Allahut të Gjithmëshirshëm kur thotë: **“Që të jeni të devotshëm.”**

Sot, si asnjëherë më parë, jemi bindur se muaji i Ramazanit mbolli te ne bindjen e paluhatshme se dija, meditim, mbi gjithçka që krijoi Zoti, janë argumente mbi ekzistencën dhe rrugëtimin e drejtë të njohjes së Tij, sepse në këtë muaj, në Natën e Kadrit, zbriti imperativi i Zotit: **“Lexo në emër të Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).”**

Etja dhe uria gjatë agjërimit forcuar te ne kujdesin ndaj njeriut, andaj ne sot, në këtë ditë të madhe, jemi më solidarë dhe më humanë se asnjëherë më parë dhe ky parim definoi teoretikisht dhe praktikisht ndjenja të paqes, të tolerancës, të humanizmit dhe të solidaritetit.

Të jesh pjesëtar i denjë i Islamit dhe të kryesh me përkushtimin më të madh muajin e Ramazanit, do të thotë të jesh i pastër në synime dhe qëllime, në shpirt dhe në zemër, në jetë me njerëzit dhe me botën që të rrethon, i qëndrueshëm në provokimet dhe sfidat e jetës për t'i tejkaluar ato, i afërt me njerëzit, i drejtë në jetën e përditshme, falës i lëshimeve, si dhe ndihmës i vërtetë i njerëzve.

Andaj, festa e Fitër-Bajramit është ngadhënjim i së mirës ndaj së keqes, i shpirtërores ndaj epshores dhe emocionale, i moralit ndaj amoralës, i të sinqertës ndaj mashtrimit, i ngritjes ndaj rënies, i aksionit ndaj neglizhencës, i optimizmit ndaj dëshpërimit, i kalitjes ndaj zbehjes, i

dinjitetit ndaj luhatshmërisë, i durimit ndaj mosdurimit, i hyjnosjes ndaj satanikes. E gjithë kjo të bën person të aksionit në kultivimin e të mirës dhe në evitim të të keqes.

Kjo është rruga e vërtetë dhe kjo është ngritja e vetëdijes së besimtarit që në momentin e duhur të jetë i gatshëm t'u japë përgjigje sfidave dhe situatave që i sjell koha në të cilën ai jeton. Sfidat më të madhe sot është lufta, ajo që po lëviz në tërë botën – sot në këtë vend, e nesër në një vend tjetër. Ramazani me vlerat e tij, si dhe kjo ditë e madhe, na mësojnë se lufta është e huaj në Islam, ndërsa paqja është ajo më e shtrenjtja e njeriut dhe synimi kryesor i tij, dhe se i gjithë potenciali i besimtarit duhet vënë në kultivimin e paqes dhe të mirëqenies mes njerëzve kudo që jetojnë dhe veprojnë ata, sepse sipas Islamit të shpëtosh një jetë njerëzore, është sikur të shpëtosh tërë njerëzimin dhe: të mbysësh një jetë njerëzore, është sikur të mbysësh tërë njerëzimin.

Besimtarë të nderuar, vëllezër e motra.

Sot, në këtë ditë të gëzimit të Fitër-Bajramit, me zemra të pastra i drejtohem Allahut të Gjithmëshirshëm që të na japë fuqinë e imanit, guximin e faljes dhe të pajtimit, buzëqeshjen me të tjerët, për të hapur rrugët e shpresës për të ardhmen, duke qenë të vendosur në rrugëtimin tonë për të kultivuar një të tashme dhe të ardhme edhe më të ndritur; t'u japë gëzimin dhe shpresën në zemrat e tyre skamnorëve, njerëzve me telashe fizike-shpirtërore, familjeve që humbën më të dashurit e tyre nga sëmundja e rëndë covid-19, me qëllim që sot dhe gjithmonë në jetë të jemi të lumtur dhe të gëzuar, e mbi të gjitha - falënderues ndaj të Madhit Zot.

Vëllezër e motra,

Në fund, më lejoni që në emër të Bashkësisë Fetare Islame, të organeve, të enteteve dhe të institucioneve fetare-arsimore të saj dhe në emrin tim t'u shprehim urren më të përzemërta, duke iu lutur Allahut fuqplotë që t'i pranojë me mëshirën e Tij të gjitha ibadetet tona, agjërimin tonë, të gjitha veprat tona të bëra gjatë muajit Ramazan.

E gëzofshi Fitër-Bajramin.

**Reis'ul-Ulema i BFI të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu (Shkup, 2 maj 2022, Xhamia Mustafa Pasha)**

## BAJRAMI I RAMAZANIT

**“Ka shpëtuar ai që është pastruar. Që e përkujton emrin e Zotit të vet dhe falet. Po ju i jepni përparësi jetës së dynjasë. Ndërsa ahireti (amshimi) është më i mirë dhe i përjetshëm. Vërtet, kjo ishte në broshurat e lashta. Në broshurat e Ibrahimit dhe të Musait.”**

(A'la: 14-19)

**Nga Mr. Imer ef. Jusufi**

1. Dita e Fitër-Bajramit është ditë gëzimi për besimtarët dhe besimtare. Në Kuran thuhet:

**“E, përgëzoji ata që besuan dhe bënë vepra të mira, se ata do të jenë në Xhenet ku rrjedhin lumenj. Saherë që u jepet ndonjë ushqim nga frytet e tij, ata thonë: ‘Kjo është prej asaj që u ushqyem edhe më parë.’ Ngase, u sillet ushqim i ngjashëm (vetëm në formë, e jo edhe në shije). Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë.”** (Bekare: 20)

Në një ajet tjetër thuhet: **“...kurse ata që besuan, gëzoji, se me të vërtetë kanë pozitë të lartë të Zotit të tyre.”** (Junus: 2)

Në një ajet tjetër thuhet: **“...keni myzhde Xhenetin që ju premtohej!”** (Fusilet: 30)

Kjo ditë është ditë gëzimi për të gjithë: edhe për të varfërit, edhe për të pasurit.

Enes ibn Maliki (r. a.) transmeton nga Muhamedi (a. s.) se një ditë bajrami ka dalë nga xhamia dhe i ka parë fëmijët duke luajtur dhe në mesin e tyre ka qenë një fëmijë që ka qenë i ulur dhe nuk ka luajtur.

Ishte i pikëlluar - i mërziutur, me tesha të grisura e të vjetra, i pangrënë dhe i papirë.

Rrinte aty. Muhamedi (a. s.) i tha: **“O ti fëmijë, përse nuk luan edhe ti sikur shokët tu, por qan?”**

Fëmija nuk e njihte se kush është ky njeri, andaj i tha: “O ti njeri, më ka vdekur babai në një luftë me Pejgamberin (a. s.), nëna m'u ka martuar me një tjetër burrë dhe pasurinë time e kanë ngrënë dhe mua më kanë nxjerrë nga shtëpia dhe

nuk kam as ushqim, as ujë, as tesha, as shtëpi! Kur i shoh fëmijët sot duke u gëzuar, më kaplon dhimbja e babait tim. Për këtë arsye qaj.”

Muhamedi (a. s.) e kapi për dore dhe i tha: **“O djalosh, a pajtohesh që unë të jem babai yt, Aisheja (r. a.) nëna jote, Aliu mixha yt, Hasani dhe Hysejni vëllezërit tu dhe Fatimja motra jote?”**

Fëmija e kuptoi se ky është Muhamedi (a. s.) dhe i tha: **“Përse të mos jem i kënaqur, o i dërguar i Allahut (s.a.v.s.)?”**

Muhamedi (a. s.) e mori te shtëpia e tij, e veshi me tesha të reja, e ushqeu dhe e zbukuroi. Fëmija doli duke qeshur e i gëzuar në mesin e fëmijëve të tjerë.

Fëmijët i thanë: **“Pak më parë ti qaje, ndërsa tash po qesh! Çka u bë me ty?”**

Fëmija tha: **“Ishta i uritur, e tash u ngopa; isha i zhveshur, e tash jam i veshur; isha jetim, e tash Pejgamberin (a. s.) e kam baba, Aishen (r. a.) nënë, Aliun (r. a.) mixhë, Hasanin dhe Hysejnin vëllezër, kurse Fatimen motër. A nuk meritoj të gëzohem?”**

Fëmijët thanë: **“O sikur të kishin rënë dëshmorë prindërit tanë! Edhe ne do të gëzoheshim si ti!”**

Kur vdiq Muhamedi (a. s.), ky fëmijë, duke i hedhur dheun mbi varr, tha: **“E, tash jam i huaj dhe jetim!”**

Ebu Bekri (r. a.) kur e dëgjoi, e përqafoi dhe e mori nën kujdesin e vet. Xhematë i nderuar, ne sot i gëzojmë fukaratë, jetimat dhe gjithë ata që kanë nevojë për tjetrin, duke iu dhënë Sadakatul-fitrin, Zeqatin ose lëmshën e thjeshtë.

2. Dita e Fitër-Bajramit është dita në të cilën falen mëkatet dhe merret shpërblimi. Se në Fitër-Bajram falen mëkatet

dhe merren shpërblimet, këtë na e vërteton hadithi vijues, ku thuhet:

**“Robtë e mi, për Mua keni agjëruar dhe për Mua jeni falur; kthehuni (prej namazit të Bajramit) me mëkatet e falura.”**

3. Dita e Fitër-Bajramit është ditë e pajtimit mes vëllezërve myslimanë. Në Kuran thuhet:

**“S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër; pra, bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kijeni frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti).”** (Huxhurat: 10)

4. Dita e Fitër-Bajramit është ditë vizite (zjareti). Në këtë ditë vizitohen prindërit, familja, farefisi, miqtë dhe fqinjët. Kjo është një ndër vlerat e shënimit të festës së Bajramit. Muhamedi (a. s.) në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejre (r. a.) ka treguar:

„Një njeri është nisur në rrugë për ta vizituar një mik të vetin. Gjersa ka udhëtuar, Allahu (xh. sh.) ia ka dërguar një melaqe që ta takojë atë në rrugë dhe ta pyet:

-Ku po shkon?  
-Kam një vëlla në këtë fshat, tha njeriu.

-A mos ke tek ai ndonjë interes dhe për atë arsye e viziton?  
-Jo, vetëm se për hir të Allahut e dua dhe për hir të Allahut po e vizitoj, tha njeriu.

-Unë jam i dërguari i Allahut (xh. sh.); më ka dërguar të të tregoj se Allahu (xh. sh.) të do sa e do ti vëllain tënd, i tha melaqja.“ (Muslim dhe Buhariu)

5. Dita e Fitër-Bajramit është përkujtim i Tubimit në Ditën e Gjykimit. Në Ditën e Tubimit dikush do të vijë i gëzuar

e dikush i mrrolur; dikush me tesha të reja e dikush me tesha të vjetra; dikush hipur e dikush më këmbë; dikush duke shpejtuar e dikush dalëngadalë, si njeriu i lodhur e i rrsakapitur; dikush në grup e dikush i vetmuar. E gjithë kjo i përngjanë ditës së tubimit në Mahsher-Ditës së Gjykimit. Në Kuran thuhet:

**“Ditën kur do t’i tubojmë të devotshmit tek i Gjithëmëshirshmi si mysafirë të ftuar. Ndërsa mëkatarëve u grahim në Xhehenem të etshëm.”**

(Merjem: 85-86)

Në një ajet tjetër thuhet:  
**“Është dita që i fryhet surit, e ju vini grupe-grupe.”** (Nebe`e: 18)

Sipas Enes ibn Malikut, myslimanët kanë edhe pesë bajrame të tjera dhe ato janë:

1.Ajo ditë që i kalon njeriut dhe nuk bën asnjë mëkat;

2.Ajo ditë që e jep amanetin e Zotit (vdes), por vdes me iman, duke qenë i larguar prej shejtanit-djallit të mallkuar;

3.Ajo ditë që do ta kalojnë urën e Xhehenemit dhe (myslimani) do të jetë i qetë prej largimit nga Xhehenemi;

4.Ajo ditë që do të hyjmë në Xhenet dhe do të jemi larg Xhehenemit; dhe

5.Ditë bajrami dhe dita më e gëzueshme për çdo besimtar do të jetë ajo ditë që do ta shohim Allahun (xh. sh.) në Xhenetin Firdevs.”

*(Autori është nga Radusha, Shkup; është imam, hatib dhe muallim në Kërçovë)*



*Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Xhaminë Mustafa Pasha, Shkup (Fitër-Bajram, 2022).*

## BAJRAMI I MADH...

Bajrami i Ramazanit (Fitër-Bajrami; Bajrami i Madh, siç njihet te shqiptarët) është festë fetare islame, që kremtohet gjatë 3 ditëve të para të muajit Sheval, që është muaji i 10-të dhe vjen menjëherë pas Ramazanit, muajit të 9-të të vitit sipas kalendarit hënor (Hixhri).

Festimi i Bajramit të Madh dhe të Kurban-Bajramit, më vonë, ka filluar në

vitin e 2-të të kalendarit Hixhri. Edhe agjërimi i Ramazanit për herë të parë ka qenë obligim (farz) pikërisht në këtë vit.

Pas Ramazanit, besimtarët myslimanë 3 ditët e para të muajit Sheval, që pason, i kremtojnë në mënyrën më të mirë. Kjo është arsyeja se pse kësaj feste i thonë Bajrami i Ramazanit.

Emri në arabisht është "Id el-fitr".

Në arabisht shprehja "fitr" e ka kuptimin e mëngjesit (si vakt) dhe njihet si mëngjesi i parë që hahet fill pas mbarimit të Ramazanit.

Dita e parë e Bajramit të Madh është më 2 maj, 2022, e hënë. Namazi i Bajramit kryhet në orën 6:10, sipas kohës së Shkupit.

E gëzofshit Bajramin e Ramazanit!

# ZEQATI DHE NDIHMAT PËR MEDRESENË, ARMË PËR FUQIZIMIN E FJALËS SË ALLAHUT

*U bëjmë thirrje të gjithë pjesëtarëve të fesë islame që Zeqatin ta destinojnë dhe ta japin për qëllimet arsimore të Medresesë Isa Beu, sepse me këtë akt do ta ndihmojnë jo vetëm nxënësin, profesorin, pedagogun që punon në Medrese, por dhe do t'i hapin dhe do t'i zgjerojnë rrugën Islamit të vërtetë e të gjithëdobishëm për ne dhe për gjeneratat që vijnë pas nesh.*



**Nga Prof. Ibrahim Idrizi**  
*(Drejtor i Medresesë Isa Beu)*

Medreseja Isa Beu në Shkup që disa vjet ka dëshmuar se është një institucion arsimor-fetar që i prin në mënyrë koherente gjithë spektrit të jetës fetare islame në RMV. Prej vitit 1984, boshti kurrizor që i lidh gjymtyrët e tërë trupit fetar-islam në Maqedoninë e Veriut është Medreseja Isa Beu, me Paralelet e Shtrira.

Jo vetëm për faktin se ajo e ripërtërin kuadrin me njerëz të kualifikuar, jo vetëm për faktin se po shënon një revolucion të vërtetë në pjesëmarrjen edhe të femrës myslimane në jetën fetare islame dhe në jetën e përgjithshme shoqërore, por për faktin se nëpërmjet shkollimit të drejtë dhe me standarde të kohës në të cilën jetojmë, të rinjtë që dalin nga ky institucion janë të armatosur me dije të shëndoshë

fetare islame dhe njëkohësisht janë të plotësuar edhe me dituri nga lëndët e ndryshme me rëndësi të përgjithshme.

Ky kombinim i ngritjes fetare-islame me dituritë shkencore-pedagogjike në Medresenë tonë bëhet me një angazhim të mirëfilltë të stafit pedagogjik dhe njëkohësisht me përkrahjen edhe të kreut të BFI-së.

Dhe, si qëndroi gjithë këto vjet kjo Kala e Diturisë në rrugën e Allahut, Krijuesit të vetëm? Ajo qëndroi falë ndërgjegjes së shëndoshë të popullatës islame, e cila e pa si rrugëdalje të vetme mirëmbajtjen dhe avancimin e shkollimit të mesëm të të rinjve të saj nëpërmjet këtij institucioni.

Është një krenari e jashtëzakonshme të mendohet se në një shtet me karakter social dhe laik, të mundet nga popullata të mirëmbahet me forcat e veta një institucion i këtillë pa ndihmën e shtetit. Me ndihmat dhe Zeqatin që dhanë, pjesëtarët

e Islamit i treguan botës laike përreth se edhe pa ndihmën e shtetit mund të mbahet një institucion që prodhon vlera për fëmijët dhe ardhmërinë e tyre.

Dhënia e Zeqatit dhe e ndihmave për këtë institucion nuk është vetëm një përgjegjësi e lartë për mirëmbajtjen e jetës fetare-islame, por më tepër është përgjegjësi se me këto ndihma çdo njeri që jep, bëhet vetë shtyllë e mbajtjes dhe e përhapjes së Fjalës së Krijuesit të Tij. E, të bëhesh shtyllë mbajtëse e Fjalës së Allahut, do të thotë të jesh në istikame të qëndrueshme dhe t'u bësh ballë sfidave të kohës, duke jetësuar Porosinë e Tij.

**DRITA E ZOTIT SHPËRNDAHET VETËM NËPËRMJET RREZEVE TË DITURISË**

Qytetari i trojeve tona, pa marrë parasysh se a është i pasur ose jo, dhënien e

caktimit të Zotit si Zeqatë dhe Sadaka – kur e jep për institucionin fetar islam, shih se drita e Zotit shpërndahet vetëm nëpërmjet rrezeve të dritës. Numri prej 800 medresantëve e medresanteve që aktualisht mësojnë në bankat e kësaj vatre edukative arsimore dhe mbi 3.117 të diplomuarve deri më tani, prej të cilëve 1.469 janë femra, flet qartë se ky institucion është në nivelin më të lartë të detyrës së shenjtë.

Por, jeta fetare islame, e në veçanti ajo arsimore, me gjithë insistimin tonë permanent që të jetë pjesë e sistemit arsimor të shtetit, është lënë jashtë, me qëllim që të zvetënohet dhe të degradohet; bile, edhe të humbet. Ky është qëllimi i atyre që e kundërshtojnë ekzistimin e institucioneve fetare islame, duke e ditur se jeta institucionale pa përkrahjen e shtetit nuk mund të ekzistojë!

Por, çka ndodhi? Jo vetëm që nuk u shua kjo Kala e Dijes dhe e arsimit islam ndër vite, por ajo si një pranverë e begatë lulëzoi me degë të reja edhe për mësimin e femrave, si një plagë e moçme e të rejave, të cilat pas mbarimit të shkollës fillore mbeteshin nëpër shtëpi në mëshirën e kohës. Kjo është ndër të arriturat kolosale të këtij institucioni dhe të vetë BFI të RMV.

Në anën tjetër, kemi një ngritje të shkallës së lartë të vetë procesit edukativo-arsimor në vetë institucionin e shkollës. Programet vjetore për çdo vit janë duke u begatuar me brendi e përmbajtje të reja, të cilat korrespondojnë me zhvillimet kohore dhe janë më se të nevojshme për integrimin e vetë Islamit në çdo pore të jetës. Më nuk e kemi mendresantin që i di vetëm bazat e fesë islame, por kemi kuadër i cili pas mbarimit të Medresesë është i gatshëm të integrohet jo vetëm në jetën fetare islame, por në çdo institucion tjetër të nevojshëm.

Rezultati i punës sonë është që sot nëpër institucionet publike vërejmë në masë të konsiderueshme vajza krenare, ish-medresante, të cilat i kryejnë të gjitha detyrimet e tyre aty ku punojnë, bile ua kanë lakminë edhe pjesëtarët e feve të tjera për sjelljen, korrektesinë dhe saktësinë e kryerjes së detyrave të punës.

Këto të arritura janë falë punës së pandalshme dhe të palodhshme të Medresesë Isa Beu me qendër në Kondovë (Shkup), si dhe të simotrave të saj, Paraleleve të Shtirra të vajzave në Tetovë, Gostivar dhe Shkup, si edhe ajo e djemve në Shtip.

Një dimension i rëndësishëm për zhvillimin e jetës fetare islame është financimi i objekteve fetare islame dhe, në

kuadër të kësaj, edhe i Medresesë Isa Beu, si qeliza themelore e organizmit të jetës fetare islame në Maqedoninë e Veriut. Ky dimension del nga kushti bazë i Islamit – ku me ajete të qarta i Madhërishti e cakton Zeqatin si kategori elementare të besimit. Ajetet që bëjnë fjalë për shtyllat e besimit qartësojnë se pas namazit, shtyllë kryesore kemi Zeqatin. Mbi 80 ajete në Kuranin famëlërtë namazin dhe zeqatin i paraqesin si obligim paralel për besimtarët. Deviza „Falni namaz dhe jepni Zeqatë” është formulë kuranore, e cila e mbjell, e rrit dhe e zhvillon besimin në Një Zot te çdonjëri dhe kjo është e qartë për mbarë botën islame.

Por, kjo devizë e përgjithshme duhet të konkretizohet sipas legjislacionit kuranor dhe profetik në vetë jetën tonë të përditshme. Këtë problematikë e kanë trajtuar dijetarët e Islamit si: shejh Jusuf Kardavi, i cili në librin e tij Fikh-el Zekat thotë: “Zeqati, ashtu siç e njohim, është obligim që u nënshtrohet rregullave rigoroze (faridatum minallah) dhe jo si e drejtë që u lihet personave që ta zbatojnë në bazë të nivelit të tyre të besimit.

Duhet të jemi të qartë se Zeqati nuk është asfarë mirëbërje ose lëmoshe, por kategori sociale e cila e kontrollon shoqërinë dhe realizohet nëpërmjet mekanizmave administrativë që e mbledhin, që e depozitojnë dhe e shpërndajnë në fonde për qëllime të caktuara.”

Me të drejtë, myslimanët e trojeve tona, duke u bazuar në themelet e Islamit dhe duke zbatuar njërin nga pesë shtyllat e tij, e zbatuan (edhe) këtë obligim. Ky zbatim është me rëndësi të dyfishtë, sepse një mysliman që e jep Zeqatin dhe ndihmën tjetër për institucionet edukativo- arsimore fetare, ka dobi të dyfishtë, sepse, e para: e kryen obligimin e caktuar nga Zoti (ajeti „merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rritësh veprat e mira!”, Teube: 103) dhe e dyta: jeton praktikisht me atë obligim, duke e jetësuar të dhënë e vet për hir të Allahut (xh. sh.) – “thuj: ‘Punoni, se Allahu, i dërguari i Tij dhe besimtarët do ta shohin punën tuaj.’” (Teube: 105)

Këto dy segmente bëjnë të mundur realizimin e vetë Islamit edhe si normë, edhe si praktikë. Në rastin konkret, me ndihmën që i jep Medresesë, ai kryen edhe obligimin që ka si detyrim social ndaj shoqërisë, por njëkohësisht e di se Zeqati apo ndihma e tij është në një rrugë zhvillimore me shumë të mira, sepse edhe nëse nuk mëson fëmija i tij, do të mësojë një i afërm, i cili do t’ia edukojë familjen, ose, së paku, prej të cilit nuk do

të ketë dëm, por do të ketë dobi njerëzia.

Çdo njeri duhet ta pyet veten në prag të dhënies së Zeqatit dhe ndihmës: Ku duhet ta jap të njëjtën? Shumë predikues mbështeten tek ajetet se Zeqati duhet të jepet për të varfrit, për jetimët, për udhëtarët etj. Këto kategori vërtet janë të mbrojtura me normat kuranore dhe me ligjislacionin profetik, por këto kategori në kohën tonë janë të pakta dhe zgjidhen edhe nga shteti me ndihmesa të ndryshme sociale dhe, falë Zotit dhe mëshirës së Tij, shumë pak njerëz kemi që vuajnë për bukë dhe për gjëra elementare.

Sot nevoja e dijës është në rend të parë dhe e padiskuteshme për dy shkaqe: e para, sepse ajo është obligimi i parë i Zotit, pasi ajeti i parë i Shpalljes na obligon në këtë detyrim të shenjtë; dhe e dyta, sot arsimit në përgjithësi i është bërë një hile, duke e politizuar dhe duke e zhveftësuar deri në atë masë, sa që diplomat shiten si një mall pazari, kështu që edhe ai që shet edhe ai që blen janë në rolin e djallit që i ka mashtruar se gjoja bëjnë mirë, se me diploma të blera pa drituri do të kenë ndonjë pozitë të lartë në shoqëri. Këtë mbrapshti ne si Medrese Isa Beu e kemi luftuar dhe do ta luftojmë derisa të jetë e mundur, edhe pse dukuria e këtillë na ka bërë dëm edhe neve, sepse të rinjtë influencohen nga një dukuri e këtillë e shëmtuar.

#### **E KUNDËRTA E MEDRESESË ËSHTË SHKATËRRIMI I QARTË**

Medreseja Isa Beu është një institucion i cili përmes programeve mësimore zhvillon një veprimtari edukativo-arsimor e cila i ngre vlerat njerëzore në bazë të Kuranit dhe të Sunnetit të Muhamedit (a. s.) dhe kjo edukatë është një dritë që duhet ditë e përditë ta ndriçojë dhe ta ngrohë njerëzimin, sepse e kundërta po shihet se po e çon drejt një shkatërrimi të qartë. Për të mos ndodhur kjo katrahurë, ne u bëjmë thirrje të gjithë pjesëtarëve të fesë islame që Zeqatin ta destinonjë dhe ta japin për qëllimet arsimore të Medresesë Isa Beu, sepse me këtë akt jemi të bindur se do ta ndihmojnë jo vetëm nxënësin, profesorin, pedagogun që punon në Medrese, por me këtë veprim do t’ia hapin dhe do t’ia zgjerojnë rrugën Islamit të vërtetë e të gjithëdobishëm për ne dhe për gjeneratat që vijnë pas nesh. Jo rastësisht në shumë vende në Kuranin fisnik qëndron aksioma (apo, dituria që nuk kërkon vërtetim, që d.m.th. se dihet nga përvoja e çdonjërit në jetë) „se këtë e kuptojnë vetëm të diturit, se kjo është për ata që mendojnë, por këtë nuk e kupton



tjetërkush përveç njerëzve të mençur; ose, nëse s’e kuptoni, pyetni ndonjë të ditur”.

Në këto porosi kuranore ka urtësi të shumta, të cilat neve në shërbejnë për të jetuar një jetë të qetë, të begatë dhe larg sherrit dhe cytjes së shejtanit të mallkuar. Dhe, të bësh detyrimin tënd, pra të japësh Zeqatin ose ndihmën në një institucion që mbjell dituri, prej së cilës kanë dobi të gjithë, është një mirësi e madhe, që na vendos te njerëzit më të merituar tek Allahu fuqiplotë.

Zeqati është urtësi e Zotit, që ka për qëllim të mirën e përgjithshme – është shprehur dijetari i madh Sheltuti në veprën e tij të njohur El-Fetava dhe ne do të shtojmë se a ka të mirë përgjithshme sesa shkollimi i të rinjve në frymën e Islamit dhe të Kuranit plotëditë?!

Të njëjtë e kemi edhe qëndrimin e komentuesit të spikatur Reshit Rida, i cili në librin e tij Tefsirul- Kur`ani Kerim arsyeton se në kohën tonë është më e rëndësishme që Zeqati të jepet për shkollimin dhe aftësimin e njerëzve, që ta shpjegojnë dhe ta kuptojnë të vërtetën e Islamit. Ndërkaq, revolucionari i Islamit, Sejti Kutub, në tefsirin e tij Fi-Dhialil Kur’an thotë: “(Babun Vasiun jeshmelu kule maslehatin lil xhemati), pjesa 4, fq. 245: Zeqati ka një kuptim të gjerë, që përfshin gjithçka që është e rëndësishme për shoqërinë. Dhe, a ka dilemë se arsyeshmëria e dhënies së Zeqatit dhe e Sadekatul-fitrit për nevojat e shkollimit të fëmijëve tanë është dhënia më e qëlluar për të gjithë ne?! Kjo dhënie (Zeqati, Sadekatul-fitri dhe ndihma të tjetër) është prova e vërtetë se si i kemi fituar dhe si i harxhojmë ato me të cilat na ka begatuar i Madhi Zot. Nëse dikush dëshiron ta manipulojë xhematin me ajetet dhe hadithet që gjoja se është me e arsyeshme që Zeqati t’u jepet jetimëve dhe të varfërve, si më parësore sesa shkollimit, u themi me

të drejtë dhe me arsye të shëndoshë se dhënia për këto kategori është obligim kuranor, po në këto momente këto norma shumë pak kanë të bëjnë me jetën reale.

Me ndihmën e shkollimit, ne nuk i evitojmë pasojat ku kanë rënë këta njerëz, por i evitojmë shkaqet që e kanë krijuar problemin, pra: për zgjidhjen e problemit në tërësi. Populli ynë i dashur ka një fjalë të urtë që thotë: „Mos i jep fëmijës peshkun, por mësoje ta përdorë grepin, për ta zënë peshkun.” Ne sot, fatmirësisht, nuk kemi nevojtarë për bukën e gojës; sot ushqimet e tepruara hidhen dhe kemi përbuzjen e tyre. Shumë nga fëmijët tanë me frigoriferat plot ankohen se s’kanë çka të hanë.

Kjo mosëmërimnjohje luftohet vetëm me shkollim, që e rrit besimin se Krijuesi i të gjitha të mirave është Zoti i Plotfuqishëm dhe se njeriu duhet të jetë mirënjohës për këto të mira. Ne nuk përjashtojmë ndihmesën ndaj të varfërve dhe njerëzve në nevojë dhe kuadrot tona këtë obligim e ngrenë në nivel të obligimit të përditshëm nëpër xhami dhe e njëta po zbatohet në çdo kohë.

Jeta institucionale është tentativa kryesore e Medresesë Isa Beu. Në kemi platformë legjislacionin e traditës profetike, që duhet zbatuar në kohën tonë dhe në kushtet tona të zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor. Për ta bërë Islamit normë gjithëpërfshirëse, duhet vepruar institucionalisht dhe duke prodhuar sa më shumë medresantë të ditur e të devotshëm, që do t’i dalin zot si duhet fesë së vetme të vërtetë. Dedikimi e Zeqatit dhe i ndihmave të tjera për nxënësit e Medresesë Isa Beu është një obligim që duhet të përmbushet, që t’na sigurojë neve se jemi në rrugën e atyre të cilët Zoti i begatoi me të mira, e jo në rrugën e atyre që e humbën veten.

Asgjë nuk do të mund t’na shpëtojë nga joshjet e kësaj bote, të cilat i nxit

shejtani i mallkuar, nëse të diturit nuk i marrin në dorë gjërat me të cilat ndeshemi dita-ditës. Një i ri medresant, që ka dituritë dhe sjelljet me bazë kuranore, është më i dobishëm se shumëkushi që nuk i ka këto virtyte. Një e re do të jetë një nënë e mrekullueshme nëse është e devotshme dhe nëse ka kulturën islame, të cilën do ta përdorë për shtëpinë dhe fëmijët e saj, sesa një nënë që di të shfrytëzojë vetëm pasuritë e kësaj bote, pa e ditur se nga vijnë dhe pa e ditur se për gjithçka duhet falënderuar Krijuesi Madhështor.

I bëjmë lutje Allahut të Gjithëfuqishëm që ky shkrim të prekë zemrat e besimtarëve dhe – më fuqishëm, edhe gjatë këtij muaji të bekuar të ndihmohet buxheti i Medresesë Isa Beu, të cilën e mohojnë si Ministria e Arsimit e RMV, ashtu dhe mbarë pushteti, i cili nuk parasheh asnjë donacion siç parasheh për Kishën Autoqefale dhe për grupacionet tjera fetare. Ky institucion është krijim i popullit tonë dhe unë besoj se puna e tij do të vazhdojë me përkrahje edhe më të fuqishme të besimtarëve tanë.

Nëse ato nuk kujdesen për jetën tonë fetare islame, a do të thotë kjo se ne do të rrimë duarkryq dhe do të presim që rininë tonë ta çorientojë rruga e drogës, e alkoolit, e kamatës, e kurvërisë dhe e mëkateve të tjera, të cilat janë duke e shkatërruar njerëzimin?!

Besoj se, edhe përkundër telasheve të kohës, ne do të dalim më të fortë dhe do t’i tregojmë botës se kemi ndihmën e Allahut të Madhërishtëm dhe prandaj ne jemi në ndihmë të njëri-tjetrit në të mira.

Zoti ju Mëshiroftë, Zoti agjërim të këndshëm ju dhashtë, duke e ndërjerë erën e Xhenetit përmes urtësisë së agjërit. Paqja dhe mëshira mbi Muhamedin e dashur; paqja dhe mëshira mbi të gjithë ju, të nderuar vëllezër dhe motra të Islamit tonë të dashur!

# NISABI I ZEQTIT NË KËTË RAMAZAN



## 1. ZEQATI NË AR

Nisabi i arit, prej ku fillon llogaritja e Zeqatit, është 91.6 g. Prej sasisë së arit që kemi, për zeqatë jepet 2.5%.

Nëse zeqatin e jep nga vetë esenca e pasurisë, pra nga ari, atëherë jepet 2.5 % nga lloji që kemi. Kjo llogaritet si vijon:  $91.6 : 40 = 2.29$  g.

## 2. ZEQATI NË ARGJEND

Nisabi i Zeqatit në argjend është 700 gramë argjend, nga e cila jepet 2.5 % nga esenca, ose nga kundërvlera e saj.

## 3. ZEQATI NË VLERA MONETARE

Nisabi i Zeqatit edhe për valutat e ndryshme monetare përfitohet nga nisabi i arit, sipas bursës aktuale, që është 5.141 Euro (ose kundërvlera e çdo valute me këtë).

## 4. ZEQATI NË BAGËTI – KAFSHË

a. Nisabi i Zeqatit për kafshët e imëta (dele/dhi).  
- Nga 40 dele/dhi deri në 120 dele/dhi, zeqatë jepet një dele/dhi.  
- Nga 121 – 200, zeqatë jepen dy dele/dhi.  
- Nga 201 – 300, zeqatë jepen tri dele/dhi.  
- Nga 301 – 400, zeqatë jepen katër dele/dhi.  
- Nga 401 – 500, zeqatë jepen pesë dele/dhi.

Pastaj, në çdo 100 dele/dhi, zeqatë jepet nga një dele/dhi.

b. Nisabi i Zeqati për kafshët e mëdha (lopë, buallica).

Për bagëtinë e madhe nisabi fillon nga numri tridhjetë. Si vijon:

- Nga 30 – 39, zeqatë jepet një viç që ka mbushur një vit.  
- Nga 40 – 59, zeqatë jepet një viç që ka mbushur dy vjet.  
- Nga 60 – 69, zeqatë jepen dy viça që kanë mbushur nga një vit.  
- Nga 70 – 79, zeqatë jepet një viç që ka mbushur një vit dhe një viç që ka mbushur dy vjet.  
(Parim: Për çdo 30 lopë/buallica jepet një viç njëvjeçar, kurse për çdo 40 lopë/buallica zeqatë jepet një viç që ka mbushur 2 vjet.)

*Shërbimi për Çështje Fetare i Rijasetit të BFI të RMV - Shkup (25.03.2022)*

## PAGESA ONLINE

Nga Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë bërë të ditur për pagesa online. Në njoftim thuhet:

Të nderuar besimtarë! Sadekatul-fitrin, Zeqatin dhe ndihmat tjera vullnetare mund t'i paguani edhe online në vegëzat e mëposhtme:

<https://bfi.mk/sadakatul-fitri/>

<https://bfi.mk/zeqati/>

Për të mësuar si bëhet pagesa online, BFI ka bërë dhe një video:

[https://m.facebook.com/story.php?story\\_fbid=10158955231924627&id=283542399626](https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=10158955231924627&id=283542399626)

Pagesa e Sadekatul-fitrit dhe e Zeqatit tuaj mund të bëhet edhe në lokacionet e mëposhtme:

- Në zyrat e Myftinive të BFI;

- Në të gjitha xhamitë e Maqedonisë së Veriut;

- Në institucionet edukativo-arsimore të BFI: SHMI "Medreseja Isa Beu" dhe Fakulteti i Shkencave Islame.

Jepeni kontributin tuaj për Medresenë; bëhuni pjesë e shpërblimit të vazhdueshëm! – thuhet në njoftimin e BFI. (4.04.2022)

## TRYEZË SHKENCORE PËR ZEQTIN NË MEDRESE

Më 20 prill, 2022, në Medresenë Isa Beu në Shkup, nën patronazhin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, u realizua paneli shkencor më temë "Zeqati-vlerë islame në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare", thuhet në njoftimin e BFI.

Këtë tubim e madhështoi prezenca e Kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë.

Në fjalën e tij të rastit, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu shprehu përkrahjen e tij për institucionin e Zeqatit dhe tha se panelet e këtilla janë qasje e thellë, me baza krejtësisht shkencore, ndaj këtij institucioni.

Myftiu i Kosovës h. Naim ef. Tërnavë e përkrahu fuqishëm këtë tubim fetar dhe potencoi se tubimet e këtilla i afrojnë dy Bashkësitë Islame në veprimin e tyre.

Drejtori i Medresesë Isa Beu, prof. Ibrahim ef. Idrizi, në fjalën e tij u ndal te roli i Medresesë Isa Beu në përgatitjen dhe nxjerrjen e kuadrove fetare me qëllim rritjen e nivelit të organizimit të jetës fetare islame si në vend, ashtu dhe në diasporë.

Kumtesat e dy panelistëve: prof. Jusuf ef. Zimeri dhe dr. Islam Hasani dhanë një qasje burimore të Islamit mbi Zeqatin, definicionin, distribuimin dhe metodat bashkëkohore të kuptimit të tij.

Më pas u shtrua iftari i përbashkët në mensën e Medresesë Isa Beu.

Në këtë tubim morën pjesë myftinjët e Myftinive të BFI të RMV, Drejtorët e Drejtorive të Rijasetit, profesorë të Medresesë dhe të Fakultetit të Shkencave Islame, afaristë dhe mysafirë nga e gjithë Maqedonia e Veriut e më gjerë.

Ju shprehim falënderime të përzemërta të gjithëve për kontributin e dhënë në organizimin dhe madhëstimin e këtij tubimi, thuhet në njoftimin e BFI.

Tryeza shkencore "Zeqati-vlerë islame në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare" në të njëjtën ditë, në kohë reale, u transmetua drejtpërdrejt në platformat elektronike të BFI.

## URTËSITË E ZEQTIT

Urtësitë e Zeqatit janë të shumta. Por, do t'i theksojmë vetëm disa prej tyre:

1. Me dhënien e zeqatit bëhet pastrimi shpirtëror i njeriut dhe pastrimi i pasurisë.

2. Dhënia e zeqatit ndikon në ruajtjen e pasurisë nga njerëzit e pandërgjegjshëm, nga kriminelët dhe zullumçarët. Pejgamberi (a. s.) i porosiste Sahabët (shokët e vet), duke iu thënë: "Ruajeni pasurinë tuaj me anë të dhënies së zeqatit, shëroni të sëmurët tuaj me anë të sadakave dhe largoni belatë (të këqijat) me anë të lutjeve."

3. Me dhënien e zeqatit luftohet më e rrezikshmja e shoqërisë njerëzore: varfëria, e cila sjell pasoja të mëdha.

4. Me anë të zeqatit arrihet edhe mënjanimi i vetive të liga të njeriut dhe shtohet pasuria, bereqeti etj.

U bëjmë apel besimtarëve islamë, në veçanti të pasurve, që një pjesë të zeqatit ta japin dhe ta destinonjë për ngritjen dhe fuqizimin e fjalës së Allahut dhe të Pejgamberit (a. s.), e ajo është Medreseja Isa Beu në Shkup.

Përgatiti: Abedin ef. Imeri, Myfti i Myftinisë së Kumanovës

# TRIBUNË PËR DITËN E BEDRIT NË DIBËR



Më 18 prill, 2022, 17 Ramazan 1443 H, në Dibër u mbajt tribuna "Bedri, simbol i fitores", thuhet në njoftimin e BFI.

Bedri është në ditën e 17-të të muajit Ramazan dhe për nder të kësaj dite Rijaseti i BFI të RMV, në bashkëpunim me Myftininë e Dibrës, e organizoi këtë tribunë. Pjesëmarrës ishin shumë figura eminente, profesorë të FSHI dhe të Mëdresës Isa Beu, imamë, hoxhallarë dhe xhematë nga Dibra.

Tribuna shkencore u mbajt në Xhaminë e Sahat Kullës, pas namazit të iqindisë. Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, ligjëroi më temë "Dimensioni strategjik shpirtëror i Bedrit", ndërsa mr. Qamil ef. Rushiti, Myfti i Myftinisë së

Kërçovës, foli për "Pikëpamjet e studiuesve islamë dhe të huaj mbi Bedrin".

Më pas u shtrua iftari tradicional dibran me anëtarët e Komisionit Qendror të Ramazanit dhe imamët, gjatë të cilit Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së h. Irsal ef. Jakupi i përshëndeti të pranishmit në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, duke u dëshiruar agjërim të lehtë dhe lutje të pranuar tek Allahu Fuqplotë.

Këtë iftar e madhështoi edhe prezenca e mysafirëve të shumtë, ndër të cilët: Kryetari i Komunës së Dibrës dr. Hekuran Duka, Myftiu i Gostivarit hfz. Sabahudin ef. Zendeli, Drejtori i Agjencisë për Standardin Hallall h. Muha-

mer ef. Veseli, Drejtori i Sektorit për Kulturë Musanif ef. Rufati, Prodekani i FSHI dr. Muadh ef. Agushi, profesorët e nderuar dr. Fahrudin ef. Ebibi, prof. Mevlud ef. Aliu, prof. Shafi ef. Osmani, dr. Abdylxhemil ef. Nesimi, Zekirija Metushi, Lutfi ef. Nexhipi, Mallzim ef. Zendeli, hfz. Jusuf Xheladini e të tjerë.

Menjëherë pas iftarit, anëtarët e Komisionit Qendror të Ramazanit u shpërndanë dhe vizituan xhematet e xhamive të Dibrës, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjatë ditës, në kohë reale, BFI e RMV kishte transmetim të drejtpërdrejtë në platformat e saj elektronike nga Tribuna në Dibër.

## STUDENIÇANI SHËNON BEDRIN

Më 18 prill, 2022, 17 Ramazan 1443 H, Myftinia e Shkupit në bashkëpunim me xhaminë "Hafëz Xhavit ef. Ibrahim" në Studeniçan realizoi program fetar për nder të Ditës së Bedrit, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit Qenan ef. Ismaili.

Na nderuan me prezencën e tyre: Kryetari i Komunës së Studeniçanit z. Azem Sadiku, hoxhallarë, hafëzllarë dhe xhematlinj të xhamisë.

Nuk mungoi, si çdoherë, mirëpritja e veçantë, nderi dhe respekti nga hatibi i Xhamisë, Muhamed ef. Sadiku, imami hfz. Xhelil ef. Shabani dhe Këshilli i Xhamisë.

Programi i përgatitur enkas për be-

simtarët e kësaj ane për nder të Ditës së Bedrit përmbante Kuran dhe ilahi, që i sollën xhematit freskinë shpirtërore.

Berat ef. Ramadani mbajti ligjëratën e tij, ku mes tjerash paraqiti disa mësimet dhe mesazhe që mund të nxirren nga Dita e Bedrit.

Vëllezërit Allajbegu nga Prizreni: Menduh Allajbeg dhe Deniz Allajbeg, si dhe vëllezërit Nuhiju: hfz. Sabaatin Nuhiju dhe hfz. Xhemal ef. Nuhiju ishin ata që me zërin e tyre e zbukuruan këtë program.

Beteja e Bedrit u zhvillua në ditën e 17 të muajit Ramazan, në vitin e dytë të Hixhretit.

Bedri nuk është thjesht një kujtesë

apo ngjarje historike. Kjo datë është e rëndësishme për shkak të shumë mesazheve që na janë dërguar përmes saj, të cilat i themi çdo vit dhe të cilat duhet të na bëjnë të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm në përpjekjet tona për mirësi, të drejtën dhe të vërtetën.

Krahas shumë mësimëve të tjera që mund të nxirren nga kjo ngjarje madhështore e përplot mesazhe të mëdha është edhe kjo: Bedri na mëson se ne duhet t'i bindemi plotësisht Allahut (xh. sh.) dhe Resulullahut, Muhamedit (s.a.v.s.), sepse vetëm në këtë mënyrë mund të shpresojmë në ndihmën e Allahut, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit.

# MESAZHET NGA BETEJA E BEDRIT

*Kjo betejë ishte një dëshmi e cila shoqërisë islame të asaj kohe i dha një stimul të fuqishëm se beteja për të vërtetën është një ideal që nuk mund të shuhet asnjëherë.*

**Shkruan: Mr. Lutfi Nexhipi**

Në muajin e bekuar të Ramazanit, përveç shumë ngjarjeve të rëndësishme, ka ndodhur edhe Beteja e Bedrit, që është beteja e parë dhe më e rëndësishme në historinë islame.

Beteja e Bedrit shënon ngjarjen me rëndësi të veçantë jo vetëm për historikun e Islamit dhe të myslimanëve, por edhe për porositë dhe mesazhet që duhet përfituar nga kjo ngjarje. Kjo betejë e zhvilluar mes myslimanëve të udhëhequr personalisht nga Pejgamberi (a. s.), në njërin anë, dhe idhujtarëve të Mekës, në anën tjetër, u zhvillua në vendin e quajtur Lugina e Bedrit, dhe atë pikërisht në ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit Ramazan, në vitin e dytë sipas Hixhretit. Pra, nëse këtë ngjarje e shikojmë vetëm nga aspekti historik, sigurisht se mesazhet e kësaj ngjarjeje do të jenë shumë të zbehta, mirëpo nëse kemi parasysh kohën kur u zhvillua kjo betejë, pastaj palët pjesëmarrëse në këtë betejë, situatën dhe rrethanat në të cilën kalonte shoqëria islame atëbotë, atëherë me lehtësi konstatojmë se kjo ngjarje shënon një datë shumë të rëndësishme për myslimanët, sepse kjo betejë përveç tjerash konsiderohet edhe beteja mes qurit/kufrit (pabesimit) dhe Imanit (besimit), betejë mes të vërtetës dhe të pavërtetës. Në anën tjetër, nëse kemi parasysh aspektin numerik të myslimanëve dhe idhujtarëve si palë konfrontuese, si dhe përgatitjen ushtarake mes dy palëve si faktor vendimmarrës në betejë, sigurisht se nuk do të kishim ngurrar të përfundojmë me konkluzionin se fitimtarë i kësaj beteje do të jetë pala më e përgatitur numerikisht dhe ushtarakisht. Megjithatë, kjo betejë ishte një dëshmi e cila shoqërisë islame të asaj kohe i dha një

stimul të fuqishëm se beteja për të vërtetën është një ideal që nuk mund të shuhet asnjëherë.

Kjo ngjarje praktikisht hedh poshtë edhe shumë imagjinata të atyre që pretendojnë të nxjerrin në shesh dhe të kultivojnë idenë se që në fillim Islami ishte përhapur me fuqi ushtarake dhe përmes tehut të shpatës. Këtë hipotezë, krahas shumë fakteve tjera historike dhe shkencore, e mposht edhe vetë fakti se myslimanëve vetëm pas pesëmbëdhjetë viteve të torturave që përjetuan nga idhujtarët, iu lejua ballafaqimi i drejtpërdrejtë fizik me idhujtarët, edhe atë për të mbrojtur të drejtat esenciale të tyre, siç janë e drejta e jetës, e pasurisë, e fesë, e moralit, e dinjitetit etj.

Vlerat qytetëruese të dala nga Beteja e Bedrit meritojnë një trajtim më vete, sepse sinjalizojnë për një arritje të re qytetëruese në historinë njerëzore. Në këtë luftë Muhamedi (a. s.) nuk e vendosi fitoren me çdo çmim të mundur. Ai refuzoi ndihmën e ofruar nga disa idhujtarë që të luftojnë kundër idhujtarëve, sepse nuk dëshironte që të përzihej qëllimi i pastër, e që ishte fitorja e besimit – imanit ndaj pabesimit – qufrit, pastaj vuri në praktikë parimin e konsultimit (parlamentarizmit), respektoi mendimin e ushtarëve, dialogoi para Betejës për ta evituar konfliktin, u tregua mirënjohës ndaj idhujtarëve që nuk kishin torturuar myslimanët sa ishin në Mekë, dha garanci për mostorturimin e robërve etj. Këto vlera bota e qytetëruar, e identifikuar me perëndimorin, edhe pse disa shekuj prapa myslimanëve, tenton t'i paraqet si arritje të veta, në emër të një bote progresive dhe përparimtare. Mirëpo, Abu Garibi në Irak, Guantanamo në Amerikë, Srebrenica në Bosnjë, internimi i shqiptarëve të Kosovës gjatë

luftës së fundit për në vendet e treta, tolerimi i terrorit dhe masakrimet të popullit sirian, seriozisht e kanë vendosur në diskutim moralin njerëzor të njeriut modern, i liruar nga "robëria e religjionit", që për burim ka dijen humane.

Pra, kjo që një betejë për ta vrarë analfabetizmin e të gjitha llojeve, për ta theksuar vlerën e dijes dhe shkrimit dhe të leximit. Kjo që beteja e Bedrit, me mesazhe dhe dimensionet tejkohore, të cilat akoma nuk janë absorbuar nga njerëzit e penave.

Mesazhet nga Beteja e Bedrit:

### 1. NDIHMJA E ALLAHUT (XH. SH.)

Përkujtoni kur ishit pakicë e dobët në tokë (Mekë) dhe frikësoheshit se do t'ju rrëmbejnë njerëzit (idhujtarët), e Ai ju mundësoi vend të sigurt (në Medinë) dhe ju përkrahu me ndihmën e Tij, ju furnizoi me të mira, në mënyrë që të jeni mirënjohës. (El-Enfal: 26)

"Ju kërkua ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj: Unë do t'ju ndihmoj me një mijë engjëj, të cilët do të vijnë njëri pas tjetrit." (El-Enfal: 9)

### 2. KUALITETI E JO KUANTITETI

Numri i myslimanëve në Betejën e Bedrit ishte më i vogël se numri i idhujtarëve. Por, edhe krahas kësaj, myslimanët korren fitore bindëse. Kjo duhet të kuptohet si mesazh i qarte që jep Bedri për domosdoshmërinë e kualitetit.

Myslmanët duhet të mundohen për kualitet në të gjitha sferat e jetës dhe në fe, para së gjithash, sepse kualiteti ka vlerë dhe mundëson sukses e fitore, siç ishte rasti në Betejën e Bedrit kur fituan kualitativët, edhe pse ishin pak, ndërsa kuantiteti është i zbehtë dhe joproduk-

tiv, edhe pse mund te duket shume ne vëllim, por në esencë është i dëmshëm. Pra, ne si myslimanë te mundohemi të arrijmë kualitet në të gjitha fushat, ashtu siç kemi qenë në të kaluarën e jo të mbelemi në vagonin e fundit të zhvillimit.

### 3 .KONSULTIMI I MUHAMEDIT (A. S.) ME SAHABËT

Pejgamberi (a. s.) vendosi të nisej me ushtrinë e tij dhe të zë pozitë afër lumit në Bedër. Në mëngjes arritën afër burimit të Bedrit. Habab ibn Mundhiri, njëri nga vëzhguesit, u ngrit dhe tha: A mendon, o Pejgamber i Allahut, të qëndrojmë këtu? A të ka urdhëruar Allahu që të jemi në këtë vend dhe se nuk guxojmë të shkojmë as përpara, as prapa, apo kjo është çështje e mendimit të lirë: luftë dhe taktikë? Pejgamberi (a. s.) u përgjigj: “Ky është vend për konsultim, për luftë dhe për taktikë.”

### 4. NGRITJA E THIRRJES ISLAME NË NIVEL SHETËROR

Myslmanët në asnjë mënyrë nuk duhet të kënaqen me pozitën aktuale në qarqet vendimmarrëse botërore, por duhet të punojë me vendosmëri në marrjen e vendit meritore në arenën botërore, në drejtim të hartimit të strategjive për zhvillimin ekonomik, politik, social, kulturor e teknologjik të njerëzimit.

Myslmanët nuk ngelën të mbyllur në Medinë, por vepruan fuqishëm në drejtim të afirmimit të tyre në arenën botërore, gjë që shkaktoi ballafaqim me palë të ndryshme, të cilat shihnin se terreni u është ngushtuar dhe periudha e zbramsjes veç ka filluar. Rreziku nga ballafaqimi ushtarak me palët, nuk mundi t'i shuajë ambiciet e myslimanëve për të qenë faktor stabiliteti dhe përparimi në botë.

### 5. TË BINDUR NË VEPRIMET E TYRE

Myslmani ec në rrugën e realizimit të objektivave të veta me dinjitet, me vendosmëri dhe maturi, përkatësisht vepron konform parimeve hyjnore dhe për të realizuar qëllime madhore të cilat do të jenë të dobishme për të gjithë njerëzit, e nuk vepron sipas logjikës së inatit e me mendjemadhësi, që çon në nënçmimin e tjetrit.

Pala idhujtare doli duke manifestuar mendjemadhësi dhe duke e festuar para kohe, në formën më të pahijshme, të djallëzuar dhe jonjerëzore, fitoren të cilën në Bedër kurrë nuk e arriti. Vepri-

met që u bënë me rastin e daljes së palës idhujtare në Bedër, tregonin qartë për krizën e thellë morale në të cilën gjendeshin dhe njëkohësisht argumentonin fuqishëm nevojën e tyre për misionar dhe mësues, që t'i kap për dore e t'i nxjerrë nga humnera e errët e idhujtarisë në dritën e besimit.

Së këndejmi, edhe myslimanët e sotëm duhet ta kuptojnë qartë këtë porosi: Ne veprojmë për të realizuar objektiva madhore, që do të sjellin prosperitet për të gjithë njerëzit, e nuk veprojmë të frustruar nga dikush apo për inat të dikujt tjetër. Ne nuk besojmë në inat, por besojmë në idealet e larta islame.

### 6. EDUKIMI I ALLAHUT (XH. SH.) NË KOHË TË PËRSHTATSHME

Beteja e Bedrit ishte beteja e parë në të cilën myslimanët u ballafaquan drejtpërdrejt me armiqtë e tyre. Pas disfatës që pësuan pabesimtarët dhe pas tërheqjes së tyre në mënyrë të pakontrolluar, ata pas vete, për të shpëtuar kokat e tyre, lanë shumë pasuri, kështu që ky ishte rasti i parë kur myslimanët para tyre vërejtën sasi të konsiderueshme të pasurisë. Në këtë gjendje, kur ata për herë të parë korrën fitore, për herë të parë kështu iu mundësohet pasuria në mënyrë të papritur, ndërsa ata ishin të varfër dhe kishin shumë nevojë për pasuri. Në këtë gjendje ishte krejtësisht normale që kjo surprizë të ndikojë tek ata. Disa sahabi filluan të polemizojnë se kush e meriton këtë pasuri, derisa për këtë çështje mes sahabëve filluan të ngrihen zërat. Kështu, disa nga sahabët e pyetën Pejgamberin (a. s.) se si duhet ndarë këtë pasuri dhe kush sa duhet të marrë.

Në këtë gjendje, Allahu (xh. sh.) zbriti ajete kuranore në të cilat tregon se kjo pasuri i takon Allahut dhe të dërguarit të Tij, askujt tjetër. E tërë pasuria le të ngelë aty ku është; detyra e tyre është që ata të pajtohen dhe t'ia shtrijnë dorën njëri-tjetrit për mosmarrëveshjet që kishin më parë; le të kujtojnë se ata nuk luftuan për plaçka dhe pasuri, por për hir të Allahut (xh. sh.) dhe se furnizimin e garanton i madhi Zot.

Në lidhje me këtë Allahu (xh. sh.) thotë: “Të pyesin ty (o Muhamed) për plaçkën e luftës. Thuaj: Plaçka e luftës i përket Allahut dhe të Dërguarit. Prandaj, frikësojuni Allahut, rregulloni marrëdhëniet midis jush dhe bindjuni Allahut dhe të dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (El Enfal: 1)

Pasi që myslimanët u vetëdijesuan, u penduan për atë që doli prej tyre, i shtrinë dorën njëri-tjetrit dhe u pajtuan, shpirtat e tyre u qetësuan, pranuan vendimet e Allahut (xh. sh.) dhe mbetën të kënaqur me ato furnizime me të cilat Allahu do t'i furnizojë. Atëherë zbritën ajetet kuranore të cilat shpjeguan se kush dhe sa merr nga plaçkat e luftës.

Kjo me të vërtetë ishte një mësim në kohë të duhur. Sepse, myslimanit nuk i lejohet që të veprojë për interesat e kësaj bote, por për qëllim duhet të ketë kënaqësinë e Allahut (xh. sh.) dhe shpërblymet e botës tjetër.

### 7. NË KËTË BETEJË MUHAMEDI (A. S.) I DHA PËRPARËSI DITURISË

Islami është fe e dijes dhe e ngritjes intelektuale, kështu që myslimanëve nuk u ka hije të jenë analfabetë, pasi kontribuuan për ngritjen shkencore të botës, në veçanti të Evropës. Pa dije dhe mësim, nuk ka ardhmëri për asnjë popull, e po ashtu edhe për myslimanët. Analfabetizmi nuk është vetëm nënçmim para botës, por edhe mëkat ndaj Krijuesit dhe mosfalënderim ndaj Tij për mirësinë e trurit dhe të logjikuarit.

Kjo më së miri shihet te sjellja e Muhamedit (a. s.) me robërit e luftës: ai i cili dinte shkrim-lexim dhe nuk kishte mundësi të shpengohej, ka pasur për detyrë t'u mësonte shkrim-leximin dhjetë medinasve. Ky ka qenë çmimi i shpengimit.

Muhamedi, paqa dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në Betejën e Bedrit dha shembull të shkëlqyeshëm se duhet trajtuar njerëzit e ditur. Ai tregoi praktikisht se dituria është shpëtim dhe se dijetarët duhet shfrytëzuar, edhe nëse janë të palëve të tjera.

Beteja e Bedrit është ndër ngjarjet më madhore të historisë islame. Kjo betejë nuk ishte vetëm një përleshje fizike, ndërmjet myslimanëve e idhujtarëve. Bedri ishte më shumë se aq. Ecuria e mëtejme e shoqërisë së parë islame varej pikërisht nga sukcesi në Bedër. Fitorja në këtë ditë të madhe të Ramazanit myslimanëve ua garantoi zhvillimin e mëtejme të jetës religjioze, sociale e kulturore jo vetëm në Medinë, por edhe gjetkë, në çdo kohë.

*(Kumtesë e paraqitur në Akademinë solemne me rastin e Ditës së Bedrit, më 29 prill 2021, në Kërçovë, organizuar nga BFI dhe Myftinia e Kërçovës. Autori është Sekretar i SHMI “Medreseja Isa Beu”, Shkup)*



*Nga Shaqir ef. Fetahu*

**B**ëhuni të lumtur që e përjetuam muajin e begatë të Ramazanit. Agjërue qetë dhe me përkuishtim të sinqertë. Le të jenë fjalët dhe veprimet tona në përputhshmëri të plotë me porosinë e agjërimit: përplot paqe, afërsi me tjetrin, qetësi të shpirtit dhe të trupit, kënaqësi në familje, harmoni me të tjerët, ambient të këndshëm kudo qoftë. Kjo është superiorja e muajit të Ramazanit dhe kjo e bën lidhjen me Zotin e Madhërishtëm.

# BËHUNI TË LUMTUR

**Fenomeni profetik kuranor është një model tipik dhe shumë domethënës. Atë e përshkruajnë vuajtja, vështirësitë, rreziqet, shpifjet, denigrimi, nënçmimi etj. Rindërtimi i pandërprerë i personalitetit shkon tek ai që ka qëllim në jetë, tek ai që e kupton shenjtërinë e misionit dhe të amanetit që mban mbi supet e tij dhënë nga Zoti i Madhërishtëm.**

Njeriu shpeshherë e harron pozicionin e tij të lartë, duke qenë i shurdhër për të dëgjuar zërin e arsyes, të logjikës, të të kuptuarit, të hyjnore dhe bëhet fuqi e karakterit tjetër destruktiv – satanik. Ai në këtë harresë i jep hapësirë botës materiale, botës destruktive, e cila e robëron atë dhe ia ngushton hapësirën e vetëdijes shpirtërore, hyjnore.

Kjo e shndërron atë prej subjektit dhe kultivuesit të së mirës, në objekt dhe të udhëhequr, në ndjekës të verbër të urdhrit të epshit dhe të materiales, dhe me apo pa vetëdije bëhet udhëheqës i trasimit të rrugës satanike, destruktive, të errët dhe luftëtar i pakompromis i kultivimit të së keqes, negatives, shkatërrues etj.

Agjërimi është balansuesi i shpirtërores, morales, hyjnore dhe asaj materiales, epshores dhe emocionale, dhe në këtë mënyrë formon dhe edukon personalitet të shëndoshë për veprim të matur dhe të dobishëm në shoqëri.

Ramazani 2022 ishte në një ambient krejt tjetër nga ai i dy viteve të kaluara. Besimtarët ishin më të relaksuar, më të qetë dhe më me kënaqësi e përjetuan agjërimin. Të çliruar sadopak nga shqetësimi i sëmundjes Covid-19, plotësisht u janë përqendruar agjërimin, lutjeve, faljes, humanitetit dhe falënderimit për Zotin. E gjithë kjo e ka relaksuar gjendjen. Kjo ka bërë që të ngrihet niveli i tyre shpirtëror, të ndryshojë gjendja e tyre drejt së mirës, ata të mendojnë më tepër për synimet dhe qëllimet e jetës në këtë botë dhe të mendojnë mbi lidhjen më të sigurt me Zotin.

Ajo që e përjetuam, le të kuptohet si një sprovë për t'u kalitur në rrugën drejt

synimeve fisnike në jetë, sepse ndonjëherë edhe sprova është shoku më i sigurt dhe më i sinqertë në këtë rrugëtim të shenjtë. Në sprova është ngritja e atyre që dinë të thellohen në urtësinë e sprovës, janë të paluhatshëm në bartjen e saj, nxjerrin ide të shumta dhe të begata për të kuptuar dhe shfrytëzuar jetën më së miri dhe për të vazhduar drejt amshueshmërisë.

Nuk është e rastit që gjatë historisë janë sprovuar më tepër personalitetet e misioneve të shenjta, të idealeve të larta, bartësit e ngritjeve të fuqishme, reformatorët e mëdhenj, humanistët bujarë dhe shumë të tjerë. Fenomeni profetik kuranor është një model tipik dhe shumë domethënës. Atë e përshkruajnë vuajtja, vështirësitë, rreziqet, shpifjet, denigrimi, nënçmimi etj. Rindërtimi i pandërprerë i personalitetit shkon tek ai që ka qëllim në jetë, tek ai që e kupton shenjtërinë e misionit dhe të amanetit që mban mbi supet e tij dhënë nga Zoti i Madhërishtëm.

Është ide kuranore se: nuk ka vepra madhore, pa sakrifica të mëdha.

Besimtarët pas vështirësive psiko-fizike që i solli gjendja dyvjeçare, në këtë Ramazan ishin më të prirë për aktivitet, ishin më të qëndrueshëm, më të paluhatshëm në përpjekjet e tyre dhe më të fortë në lidhjen e tyre me Zotin, më afër kënaqësisë së Tij dhe më afër pranimit të veprave tona.

Qofshin të bekuara veprat tona të Ramazanit.

**(Autori është Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut)**

# TRIBUNË “ÇLIRIMI I MEKËS” NË MANASTIR



Myftinia e BFI-Manastir, në bashkëpunim me Rijasetin e BFI të RMV dhe nën patronazhin e Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 22 prill, 2022, organizoi një tribunë me rastin e Çlirimit të Mekës Fet’hi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Manastirit.

Myfiu Amit Rasimi përshëndeti të pranishmit, përfaqësuesin e BFI - prof. Jusuf Zimeri, Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor me bashkëpunëtorë; dy ligjë-

ruerit e Tribunës: Mytiun e Myftinisë së Strugës mr.Salim ef. Sulejmani dhe dr. Fatmir Zaimi, Myftiun e Myftinisë së Prilepit Shefket ef. Imeri me Sekretarin Muhamed Gaziu, Myftiun e Myftinisë së Resnjës Gjynejt ef. Jashar, Imamët e Myftinisë së Manastirit, operativën, anëtarët dhe Këshillat e Xhamive.

Fjalë përshëndetëse në emër të Reis’ul-Ulemasë mbajti Drejtori i Sektorit

Fetar-Arsimor prof. Jusuf ef. Zimeri, kurse në temën “Çlirimi i Mekës” folën dy panelistët: mr. Salim ef. Sulejmani, Myfti i Strugës dhe dr. Fatmir Zaimi, Referent në Myftininë e Shkupit.

Komisioni i BFI për teravi-namaz u shpërnda nëpër xhamitë e qytetit, për të vizituar dhe uruar xhematin e Myftinisë së Manastirit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Manastirit.

## SHKUPI KUJTOI ÇLIRIMIN E MEKËS

Myftinia e Shkupit më 21 prill, 2022, 20 Ramazan 1443 H, organizoi manifestimin tradicional të Ditës së Çlirimit të Mekës. Manifestimi u organizua në Xhaminë me Dy Minare në Saraj, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Programi fetar para faljes së namazit të jacisë nisi me Fjalën e Allahut (xh. sh.), me lexim të Kuranit famëlartë, me ilahi e ligjëratë kushtuar kësaj dite të rëndësishme të historisë islame.

Për ta bërë këtë natë edhe më shpirtë-

rore e të paharrueshme për besimtarët e pranishëm, Myftinia e Shkupit ftoi hoxhallarë dhe hafëzllarë nga të gjitha rajonet e Shkupit, që t’i prijnë xhematit në faljen e namazit të teravisë.

Falja e namazit të teravisë u shoqërua me një program të begatë, të udhëhequr nga ana e hoxhallarëve, të cilët përcollën këshilla dhe mesazhe mbi mësimet që mund të nxirren nga Dita e Çlirimit të Mekës.

E ndjej për obligim, thuhet në njoftimin e dr. Qenan ef. Ismailit, që në emër

të Myftinisë së Shkupit dhe në emrin tim personal t’i falënderoj të gjithë hoxhallarët dhe hafëzllarët që ishin pjesë e programit: mr. Fadil ef. Ramadani, Shefket ef. Baftjari, Muharrem ef. Ismaili, Burhan ef. Ramani, Rasim ef. Ademi, hfz. Xhemal ef. Nuhiju, hfz. Abdylqerim ef. Ebibi, Sead ef. Jashari, Bejan ef. Baki.

Allahu i pranofte lutjet dhe namazin e kësaj nate dhe të të gjitha netëve të këtij dhjetëditëshi të fundit të muajit Ramazan! – thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

## FITOREVE U PRIJNË ATA QË TREGOJNË PËRULËSI

*Nga Dr. Qenan ef. Ismaili*

Sot është dita e 20-të e muajit të bekuar të Ramazanit. Në këtë ditë e përkujtojmë Çlirimin e Mekës.

Çlirimi i Mekës është një ngjarje e madhe, nga e cila mund të nxirren shumë mësimë e mesazhe madhështore.

Muaji i bekuar i Ramazanit, përveç që është muaj i Kuranit, i agjërimit, është edhe muaj i sakrificës, i betejave dhe i fitoreve më të mëdha që kanë arritur myslimanët.

Qyteti i Mekës u çlirua me 20 Ramazan, viti i 8-të Hixhrij. Fitorja arriti pa asnjë pikë gjaku, pas shumë vitesh sakrificë. Ajo ishte e merituar, sepse ki-

shte qëllim të pastër e fisnik.

Pas çirimit, mësuesi ynë, Muhamedi (s.a.v.s.), hyri në Mekë me modesti e përrulësi, me lutje dhe falënderime drejtuar Allahut Fuqplotë.

Ky veprim përcjell mesazhin e madh se fitoreve u prijnë ata që tregojnë përrulësi e modesti edhe në momentet kur ngadhënjnë.

Mesazhi tjetër që mund të nxjerrim nga kjo ditë e madhe është momenti kur Muhamedi (s.a.v.s.) i kërkoi Bilallit që ta thërret ezanin. Me këtë nënkuptojmë thirrjen për shpëtim, thirrjen për në Rrugën e Drejtë, të besimit tek Allahu (xh. sh).

Ky çlirim dhe ngadhënjim i myslimi-

manëve dhe i pejgamberit tonë të dashur - vulës së pejgamberisë, Muhamedit (s.a.v.s.), është vërtetim nga Allahu i Gjithëdijshëm, për të gjithë ummetin, se besimtarët e vërtetë do të jenë fitimtarë në luftën e tyre kundër injorancës, duke qenë parimorë e të bashkuar, sado të fortë të jenë mbështetësit e të pavërtetës.

Urime të gjithë besimtarëve myslimanë Ditën e Çlirimit të Mekës, të ditës kur u dëshmuua fuqia e besimit tek Allahu (xh. sh), te forca e myslimanëve dhe ngadhënjimi i tyre mbi idhujtarinë. /21.04.2022/

*(Autori është Myfti i Myftinisë së Shkupit)*

## MALL PËR RAMAZANIN

*Nga Muhamed B. Sytari*

Çdo gjë gëzon, drita është simbol i tij, kandili ndriçon e fytyrat qeshen në Ramazan!

Ky është muaji i familjes; bashkë e presim, bashkë falemi, bashkë lutemi, bashkë ulemi në sofrën e syfyrit, bashkë bëjmë dhikër, bashkë argëtohem me pak hurma e ujë para duarve, bashkë lexojmë Kuran. Elhamdulillah!

Ky është muaji i ndezjes së kandilave të bamirësisë e të bujarisë, muaji i përkushtimit dhe fetarizmit të dëshmuar në fshehtësi, si nijeti i agjërimit dhe ndjenisë së tij, por edhe haptas, si buzëqeshjet,

fjalët e ëmbla, hapat drejt xhamisë, puna me sakrificë e ndershmëri dhe lutjet me xhematë në ditët e tij...

Ky është muaji i shpresës, i mëshirës dhe i faljes, i adhurimit dhe pendimit, i kthimit nga namazi dhe leximi, i heqjes dorë nga shumë prapësi. Ky është muaji i llogarive me veten. "A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e Allahut dhe me atë të vërtetën që zbriti (me Kuran)...?"

Është koha për pushim. Boll me stërmundime e lodhje pas kësaj bote! Boll i vetëm, pa mbështetjen e përmendjes së Zotit e pa dritën e Tij! Boll me drita artificiale e udhërrëfyes të kopjuar keq, si

ciceron i fjetur në këtë udhëtim të jetës së papërcaktuar!

Boll me hutim! Unë e kam akoma një mundësi! Zoti im nuk më ka braktisur! Zoti im po më pret..! Ky muaji, pikërisht mundësia më e mirë! Ramazani është ripërtëritje e gjallërim! Është rimëkëmbje e kthim në origjinë! Është bekim e thirrje që gëzon qiej e tokë, që zbulon me pastërti sipërfaqen e tokës, larë me ujë sihariqesh nga lartësi të pamatura...

Ky është Ramazani, o njerëz! Allah, sa më merr malli për të.

# VIZITOHEN MË SHUMË XHAMI NË ZVICËR GJATË RAMAZANIT



Ramazani në mesin e bashkatdhetarëve tanë në Zvicër: Delegacioni i Ramazanit i Rijasetit të BFI të RMV, i udhëhequr nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, disa ditë të muajit të bekuar ua ka kushtuar bashkatdhetarëve tanë në Zvicër, duke i vizituar shumë xhami dhe qendra islame në shenjë respekti për gjithçka që japin ata në të mirë të kombit dhe të besimit, thuhet në njoftimin e BFI.

Kështu, më 13 prill, 2022, menjëherë pas një iftari modest të shtruar në Aeroportin e Shkupit, delegacioni u nis për në Zürich. Reis'ul-Ulemani e shoqëronin: dr. Selver Xhemaili, Drejtor për Diasporë; prof. Jusuf ef. Zimeri, Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor; mr. Salim ef. Sulejmani, Myfti i Myftinisë së Strugës; dhe dr. Abdylqerim Iseni, Shef i Kabinetit.

Kjo vizitë organizohet nga Komuniteti Mysliman Shqiptar i Zvicrës dhe parashihet që të zgjasë disa ditë. Anëtarët e delegacionit të Ramazanit nga Rijaseti i BFI të RMV do të vizitojnë një numër të madh xhamish dhe qendrash islame, gjithandej ku jetojnë dhe veprojnë mërgim-

tarët tanë.

Më 14 prill, në ditën e parë në Zvicër, delegacioni i Ramazanit i BFI të RMV qëndroi në mesin e bashkatdhetarëve tanë në Kantonin e Lucernit (Luzern), në Xhaminë Uniteti, në Emmen, bashkë me Kryetarin e KMSH të Zvicrës, h. hfz. Mehas Alija, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjatë vizitës, delegacioni pati një pritje të ngrohtë vëllazërore nga besimtarët tanë atje, në krye me Kryetarin e Xhamisë z. Muharrem Baftijari dhe Imamin z. Xhabir ef. Emini.

Pas iftarit, në tribunën fetare, tubimin e përshëndeti Kryetari i KMSH të Zvicrës h. hfz. Mehas ef. Alija, duke u uruar të pranishmëve muajin e bekuar të Ramazanit, ndërsa Reis'ul-Ulema dhe tërë delegacionit i dëshiroi mirëseardhje në mesin e bashkatdhetarëve në Zvicër. Njëherësh, informoi besimtarët për punën e madhe që bën Komuniteti Mysliman i Shqiptarëve në organizimin e jetës fetare islame aty.

Një shpjegim të bukur vlerave të Ramazanit dha ligjëratat e prof. Jusuf ef. Zimerit, ndërsa pas tij e mori fjalën Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu,

i cili shprehu falënderime të përzemërta për besimtarët tanë, si dhe i informoi për të arriturat dhe punën e BFI dhe të organeve të saj, si dhe për rolin e organizimit të besimtarëve në diasporë, në veçanti në Zvicër.

Me rastin e kësaj vizite u ndanë edhe mirënjohje në shenjë respekti për punën dhe përkushtimin e palodhshëm në shërbim të Islamit.

Anëtarët tjerë të delegacionit të BFI u shpërndanë nëpër qytetet tjera, me qëllim që të vizitojnë sa më shumë xhamate të bashkatdhetarëve tanë. Kështu, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni vizitoi xhamatin e Xhamisë në Gebenstorf (Kanton Aargau), Drejtori për Diasporë dr. Selver Xhemaili Xhaminë në Kreuzlingen (Kanton Thurgau), ndërsa Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani Xhaminë në Wetzikon (Kanton Zürich), ku janë pritur në mënyrë të mirë nga xhamatet e tyre.

Delegacioni publikisht shpreh falënderimin për organizimin e mirëfilltë dhe ambientin fetar gjatë këtij muaji të shenjtë të Ramazanit në Zvicër, thuhet në njoftimin e BFI.



## XHUMAJA FALET TË “BUHARA”

Më 15 prill, 2022, tërë ditën, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, kanë qëndruar në Xhaminë Buhara në Sulgen (Kanton Thurgau), thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte një pritje e nivelit lartë nga xhamati i kësaj qendre të bukur, ku u fal xhumaja dhe u mbajt ligjëratat (hytbeja) e xhumasë.

Përshtypje të veçantë la edhe ambienti i teravisë, si dhe tribuna para besimtarëve, me një pjesëmarrje masive. Zëri i bukur i Arben Eminit i dha një shije të veçantë ambientit të kësaj nate, ndërsa nuk munguan as falënderimet ndaj Kryesisë së Xhamisë, Kryetarit h. Ajvaz Ameti, i cili detyrën e ushtronte me përgjegjësi dhe me vullnet të paluhatshtëm. Organizimi dhe pritja e mr. Ahmet Mehmetit dhe fjalët e tij përshëndetëse inspiron xhamatin.

Dr. Abdylqerim Iseni në fjalimin e tij emocionoi të gjithë të pranishmit. Haxhi Mustafa në elegancën e tij la përshtypje të veçantë, sikundër dhe Ristem Rustemi, angazhimi i të cilit ishte mbresëlënëse. Në veçanti, besimtarët e të gjitha vendeve (prej nga kanë ardhur) formuan një ambient të jashtëzakonshëm.

Vizitat tjera u bënë në qendrat e mirënjohura: prof. Jusuf Zimeri në Schlieren (Kanton Zürich), mr. Salim Sulejmani në Limmatal (Kanton Zürich) dhe dr. Selver Xhemaili në Xhaminë Drita në Emmen-Emmenbrücke (Kanton Luzern).

Të gjithë vijnë me përshtypje impre-

sionuese. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në faqen e vet në Facebook Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, të njëjtën ditë ka shkruar: “Vizitat tjera iu bënë qendrave të mirënjohura: prof. Jusuf Zimeri në Schlieren, mr.

Salim Sulejmani në Schwamendingen (pjesë e qytetit Zürich), Xhamisë Tulipan në Reinach (Kanton Aargau) dhe dr. Selver Xhemaili në Xhaminë Drita në Emmen-Emmenbrücke. Të gjithë vijnë me përshtypje impresionuese. Zoti i bekoftë.”



*“Ndonjëherë rasti s'të pyet: në Xhaminë El-Hidaje në St. Gallen, në një iftar imponant, bashkërisht u gjetëm me hoxhën e mirënjohur Alivebi ef. Mediu, njëherësh shok nga Medreseja dhe studimet. Respekti im qëndron ndaj punës së madhe që ka bërë në Zvicër, në dekada, për kultivimin dhe organizimin e jetës fetare. Trasoji rrugën e një zhvillimi të lartë të jetës fetare të besimtarëve. Vazhdon të jetë i palodhshëm edhe sot e kësaj dite. Ishte kënaqësi”, ka shkruar më 17 prill, 2022, në faqen e vet personale në Facebook Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.*

# XHAMITË QË FASCINOJNË



Bashkësia Islame El-Hidaje në St. Gallen (Zvicër) më 16 prill, 2022, mbledhi në një iftar të përbashkët xhematin e saj dhe mysafirë të xhamive të tjera, përfshi hoxhallarë dhe personalitete të shquara nga fusha të ndryshme fetare e kulturore, thuhet në njoftimin e Xhamisë El-Hidaje.

Në këtë organizim mori pjesë edhe Reis'ul-Ulemaja i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili pati edhe ligjëratën kryesore të tribunës, e cila pasoi menjëherë pas u hëngër iftari dhe pasi u fal namazi i akshamit.

Një fjalë përshëndetëse e dha edhe Shefi i Kabinetit të Reisit, dr. Abdylqerim ef. Iseni.

Tribunën e drejtoi imami i Xhamisë, Mehas ef. Alija, kurse e përshëndeti edhe Kryetari i Xhamisë, Naser Zeka.

Pas ligjëratës së Reis'ul-Ulemasë u bë paraqitja e rezultateve të çastit nga tu-

bimi i mjeteve financiare në lidhje me xhaminë e re, duke thënë se xhemati dhuroi edhe mbi 300.000 franga zvicerane, kështu që deri më tani janë tubuar mbi 1 milionë franga zvicerane.

Allahun e falënderojmë për këtë rezultat të madh, si dhe pastaj të gjithë vëllezërit e motrat që i dhanë një mbështetje të madhe aksionit për mbledhjen e parave për xhaminë e re, thuhet në njoftimin e Xhamisë El-Hidaje.

Më vonë, të njëjtën ditë, në faqen e vet në Facebook Mehas ef. Alija kishte shkruar: "Dhurata e Tribunës: 1.030.100 franga të Zvicrës. Elhamdulillah!"

Më 17 prill, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, vizitoi xhaminë "Ebu Hanife" në Grenchen (Kanton Solothurn, Zvicër), pas ftesës së Kryesisë së kësaj xhamie, e cila udhëhiqet nga z. Sunaj ef. Osmani, ish-nxënës i Medresesë Isa Beu dhe i Reis'ul-Ule-

masë, dhe Nënkryetari Z. Regaip, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjatë vizitës Reis'ul-Ulemaja mbeti i fascinuar nga vlerat e prezantuara në këtë xhami, si: stili, arkitektura, diseni dhe bukuria e Qendrës. Por, ajo që la më shumë përshtypje ishte përbërja e xhematit nga të gjitha trojet shqiptare, nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Lugina e Preshevës dhe Shqipëria, të cilët me gëzim të madh pritën përfaqësuesit e BFI të RMV, posaçërisht Kryetarin e institucionit fetar, të shoqëruar nga Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni.

Imami i njohur nga Kumanova, h. Ibrahim ef. Sulejmani, dhe hafëz Ensar ef. Fejzullahu ishin inspirimi dhe esenca e vlerave fetare të kësaj xhamie të bukur, me të gjitha funksionet bashkëkohore. Fundja, kjo qendër fliste vetë për imanin e paluhatsëm të besimtarëve të këtij xhemati. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

# NË FRAUENFELD TG DHE NË SCHLIEREN ZH



Delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i kryesuar nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 17 prill, 2022, u prit nga Kryesia e Xhamisë së Frauenfeldit (Kanton Thurgau, Zvicër) dhe xhemati i saj, thuhet në njoftimin e BFI.

Menjëherë pas iftarit filloi ligjëratë e rastit para një mase me prezencë masive. Në fjalimin e tij, Reis'ul-Ulema falënderoi organizatorët për pritjen madhështore dhe e vlerësoi lart organizimin e jetës fetare në këtë xhami të mirënjohur. Posaçërisht e Reis'ul-Ulemasë ishin me një konsideratë të veçantë për kontributin që jep kjo xhami në vendlindje në mirëmbajtjen e institucioneve fetare islame, si dhe në zhvillimin e njohurive mbi pozicionin e Islamit në Evropë dhe në rrjedhat bashkëkohore.

Në këtë vizitë kreu i BFI shoqërohej nga Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Isini. Me këtë rast ai i shprehu urime të përzemërta Kryesisë së Xhamisë me rastin emërimit të Imamit të ri mr. Fesal ef. Fetahut, duke i dëshiruar atij suksese në detyrën e Imamit dhe të shpjegimit të Islamit.

Po ashtu, mirënjohje të veçantë kreu i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shprehu Kryetarit të Xhamisë z. Fatmir Sanakosi, bashkë me Kryesinë e Xhamisë, për udhëheqje të mirëfilltë të kësaj xhamie, si dhe Imamit të ri për programin e zhvilluar para dhe mbas namazit të jacisë, ku u zhvillua një debat i lirë me besimtarët.

Anëtarët tjerë të delegacionit: mr. Salim ef. Sulejmani vizitoi xhematin

e xhamisë "Ebu Bekër EsSidiku" në Biel/Bienne (Kanton Bernë), prof. Jusuf ef. Zimeri vizitoi xhematin e Xhamisë në Fribourg (Freiburg), ndërsa dr. Selver ef. Xhemaili vizitoi xhematin e xhamisë "En Nur" në Buchs SG. Që të gjithë lanë përshtypje të veçantë, si dhe iu bë një pritje e jashtëzakonshme. Përjetime të paharruara. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

Një vizitë të rëndësishme Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i bëri Qendrës Islame në Schlieren (Kanton Zürich, Zvicër), xhemati i mirënjohur i së cilës bën përpjekje maksimale që të përmbush nevojat e veta fetare dhe shpirtërore, thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte kërkesë e Kryesisë së Qendrës, në krye me Kryetarin h. Muhamed Ibrahim, që kreu i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ta vizitojë këtë qendër dhe të ndajë disa çaste me xhematin e saj gjatë muajit të bekuar të Ramazanit.

Reis'ul-Ulemaja në fjalimin e tij drejtuar besimtarëve përshëndeti aktivitetet e tyre, duke iu uruar dhe dëshiruar suksese të reja.

Të pranishmit i përshëndeti edhe dr. Abdylqerim Iseni, Shefi i Kabinetit, i cili e shoqëronte Reis'ul-Ulemanë në këtë vizitë.

Ata patën mundësi që të takojnë edhe shumë aktivistë që e themeluan këtë qendër si: haxhi Ahmetin, z. Kasamin, z. Uzeirin e të tjerë, të cilët ua shtuan kënaqësinë çasteve të ndara me xhematin e kësaj qendre, thuhet në njoftimin e BFI të datës 18.04.2022.

## LETËR FALËNDERIMI

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu me rastin e vizitës që u bëri bashkatdhetarëve tanë, respektivisht qendrave islame në Zvicër në organizim të KMSHZ, shpreh mirënjohje të sinqerta për pritjen e ngrohtë dhe mirë të organizuar, thuhet në letrën e falënderimit të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Delegacioni i udhëhequr nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në përbërje të dr. Selver Xhemailit - Drejtor për Diasporë në Rijasetin e BFI, prof. Jusuf ef. Zimeri - Drejtor i Sektorit për Arsim

Fetar, mr. Salim ef. Sulejmani - Myfti i Strugës dhe dr. Abdylqerim ef. Iseni - Shefi i Kabinetit, u kthye në vendlindje me përshtypje të larta dhe me bindje se bashkatdhetarët tanë, të udhëhequr nga imamët dhe kryetarët e tyre, janë shembull për prezantimin e vlerave islame në Zvicër, në veçanti gjatë muajit të Ramazanit, duke treguar në praktikë se Islami është fe e besimit, e moralit dhe e paqes.

Duke marrë parasysh se kishte kërkesa dhe dëshira edhe për vizita të tjera, kërkojmë falje që për shkak të kohës së

ngushtë nuk kishim mundësi për realizimin e tyre.

Bashkësia Fetare Islame e RMV është e vendosur që në çdo kohë të jetë në shërbim të besimtarëve tanë dhe të KMSHZ në krye me h. hfz. Mehas Alija në sfera të ndryshme, në veçanti në shpjegimin dhe prezantimin e Islamit në çdo vend ku ata jetojnë dhe veprojnë.

Ju faleminderit dhe Zoti ju bekoftë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 19.04.2022.

Përfunduar vizitën disaditëshe në

Zvicër, ku me ftesë të Komunitetit Mysliman Shqiptar të këtij vendi qëndruam disa ditë, si pjesë e një delegacioni të BFI të RMV me në krye Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Në shtetin helvetik vizituum disa Qendra Islame, ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Strugës Salim ef. Sulejmani një ditë më parë, më 18 prill.

Pata rastin të vizitoj disa xhami të bashkatdhetarëve tanë atje, ku shihet një organizim i mirëfilltë i jetës fetare.

Një falënderim i veçantë për KMSHZ dhe Kryetarin hfz. Mehas Alija për ftesën dhe organizimin perfekt të agjendës së vizitave atje.

Gjithashtu, mirënjohje pa fund për imamët dhe kryesitë e xhamive që patëm

mundësinë t'i takojmë dhe t'i vizitojmë. Vërtet na kanë bërë një mikpritje të mrekullueshme. Zoti i nderoftë dhe i shpërbleftë me të mirat e Tij të pakufishme.

Suksese dhe ju priftë e mbara, vëllezër dhe motra tona në diasporë. Mirutakofshim - ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Strugës Salim ef. Sulejmani.

Në kuadër të programit të BFI të RMV "Ramazani 2022", një delegacion prej pesë anëtarësh, i udhëhequr nga Reis'ul-Ulemaja, për pesë ditë me radhë qëndroi në mesin e vëllezërve tanë në Zvicër, ka shkruar Drejtori për Diasporë Selver ef. Xhemaili.

Me organizimin e mrekullueshëm nga ana e KMSHZ-së, patëm rastin të vizi-

tojmë dhjetëra xhami shqiptare anekënd shtetit helvetik e të bashkëbisedojmë me vëllezërit tanë.

Me këtë rast falënderojmë KMSHZ-në, në krye me Kryetarin hfz. Mehas ef. Alija, të palodhshmin h. Ismail Ademi, imamët e respektuar, kryesitë e xhamive, të gjithë ata që u angazhuan për mbarëvajtjen e kësaj vizite, si dhe mbarë xhematin, të cilët na ofruan një mikpritje të ngrohtë.

Mirë u takofshim vetëm për punë të hairit. Qofshin të bekuar bashkatdhetarët tanë kudoqofshin, ka shkruar Drejtori për Diasporë Selver ef. Xhemaili më 18.04.2022.

# PYET AMERIKA: “ÇFARË KA NGA VENDLINDJA?”

Xhamia te shqiptarët nuk është vetëm vend i kohëve të namazit, me theks të veçantë kur kemi të bëjmë me besimtarët e diasporës. Kur i pyet se çfarë është xhamia, ata thonë: ‘Vendi ku madhërohet Zoti, aty ku ne takohemi me njëri-tjetrin, aty ku kuvendohet lirshëm, aty kur ulemi - na kujtohen gjyshërit tanë kur kanë pritur namazet para xhamisë; është vendi ku me pak lot lajmë syrin e me disa fjalë të mbushura plot krenari themi: çfarë ka nga vendlindja?’...

Gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, nga data 14 prill, 2022, një delegacion i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, me autorizim të Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, qëndron në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nën udhëheqjen e Myftiut të Dibrës h. Reshat ef. Kaçalniku, thuhet në njoftimin e BFI.

Atë e shoqëron imami me zërin e mrekullueshëm të Xhamisë së Sahat-Kullës në Dibër, Hysein ef. Mirzo, të cilët po vizitojnë xhemate të qendrave islame kryesisht në rajonin e Nju-Jorkut, Staten Islandit, Nju-Xhersit, Bruklinit e vende të tjera.



Delegacioni i BFI kalon çaste të mrekullueshme ramazani në mesin e bashkatdhetarëve tanë nga Dibra, Qendra Zhupë, Gostivari, Struga, Kërçova, Tetova, Shkup, Kumanova e nga të gjitha viset e vendit tonë e më gjerë. Ata në takimet dhe vizitat e tyre nëpër qendrat kulturore islame në SHBA xhemateve ua përcjellin selamet e Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, duke i falënderuar për gjithë kontributin që e japin në organizimin e jetës fetare në SHBA, por dhe ndaj institucioneve edukativo-arsimore të BFI.

Vlen të theksohet bujaria dhe mikpritja e besimtarëve, e Këshillave të këtyre qendrave dhe e imamëve të respektuar si: mulla Omer ef. Musa, Burhan Kukaj, prof. dr. Ziber Lata, mr. Omer Kadriu, hafëz Dhulkarnejn Vardari, Imam Feridi, Imam dr. Tahiri, Imam Bajrami e të tjerë, të cilët janë shembull dhe ambasadorë të popullit dhe të besimit tonë në SHBA.

Zoti i bekoftë mërgimtarët tanë në SHBA e kudo që janë nëpër botë, thuhet në njoftimin e BFI. (23.04.2022)

## DY HOXHALLARË TË AUTORIZUAR TË REISIT VIZITOJNË GJERMANINË

Në datat 7- 11 prill, 2022, një delegacion hoxhallarësh i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i përbërë nga dr. Selver Xhemaili - Drejtor i Sektorit për Diasporë në Rijasetin e BFI dhe dr. Mevlud Aliu - Profesor në Medresenë Isa Beu, mbi bazë të autorizimit të Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu vizitoi Qendrat islame shqiptare në Gjermani për Ramazan, thuhet në njoftimin e BFI.

Me këtë rast, dr. Selver Xhemaili ligjëroi në Xhaminë Shqiptare "El Buhari" në Somborn Freigericht, në Xhaminë Shqiptare në Offenbach, në Qendrën Kulturore Islame në Frankfurt, në Xhaminë Shqiptare "DAI" në Mannheim, në Xhaminë Shqiptare në Kassel, në Xhaminë Shqiptare në Bilefeld, në Xhaminë Shqiptare në Sennestadt etj.

Dr. Mevlud Aliu ligjëroi në Xhaminë Shqiptare "Furkan" Dortmund, "Nur" Dortmund, "Mesxhidi Aksa" Leverkusen, "Medina" në Essen, "Furkan" në Duisburg, në Xhaminë Shqiptare "Ezan" në Remscheid dhe në Qendrën Islame Shqiptare - Diseldorf.

Vlen të theksohet se delegacioni i BFI u prit shumë mirë. Përfaqësuesit e Bashkësisë Fetare Islame të RMV xhemateve në diasporë ua përcollën selamet e organeve të BFI, të institu-



cioneve siç janë Medreseja Isa Beu dhe Fakulteti i Shkencave Islame etj.

Po ashtu, në ligjërimet e tyre shpjeguan punën dhe organizimin e BFI, me theks të veçantë sistemin edukativo-arsimor.

Delegacioni që përfaqësoi Bashkësinë Fetare Islame në Gjermani është mirënjohës ndaj të gjithë kryetarëve të këtyre xhamive dhe imamëve, bashkë me xhematet e tyre, për mikpritjen dhe përkushtimin e treguar gjatë vizitës në Gjermani, thuhet në njoftimin e BFI.

# MESAZHI I MUAJIT TË RAMAZANIT 1443 H (2022)

**M**ë 1 prill, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka dalë me Mesazhin e Ramazanit 1443 H (2022), në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke, në të cilin thuhet:

"O ju që keni besuar. Agjërimi është bërë obligim për ju, sikurse që ka qenë obligim edhe për ata që ishin para jush. Për t'ju bërë më të devotshëm." (El-Bekaretu: 183)

Të nderuar besimtarë e besimtare!  
Vëllezër e motra!

Me gëzimin më të madh po hyjmë në muajin e bekuar të Ramazanit, muaj ky më i madhi dhe i më dalluari nga muajt tjerë të vitit.

Në këtë muaj kryejmë njërën ndër shtyllat e Islamit - agjërimin e ditëve të tij, që është obligim i deryrueshëm, ku abstenojmë nga haja dhe pija dhe punët e shëmtuara për hir të Allahut Fuqplotë.

Përmes agjërimit dëshmojmë përkushtimin tonë ndaj Krijuesit, formojmë vetëdije të lartë mbi pozicionin tonë në Tokë për të qenë në shërbim të së mirës dhe për të evituar të keqen nga vetvetja

dhe njerëzit në përgjithësi.

Ky muaj është muaj i dijes, sepse në të zbriti imperativi për të lexuar, për të mësuar, për të hulumtuar, me qëllim që të njohim krijimtarinë e Allahut Fuqplotë.

Përmes agjërimit dhe dijes ne e kuptojmë qëllimin kryesor të jetës, e ai është kujdesi ndaj njeriut, që shprehet përmes paqes, tolerancës, humanitetit dhe solidaritetit. Në këtë ambient të lidhshmërisë sonë me Krijuesin, i drejtohem Madhërisë së Tij me lutjet tona për të na falur lëshimet, gabimet dhe të mëkatet.

Me rastin e ardhjes së këtij muaji të madh, i drejtohem me lutje të Madhit Zot që të ndërpriten të gjitha konfliktet luftarake, sepse në konfliktet e këtuja pësojnë njerëzit e pafajshëm, hapen plagë të pashlyera te njerëzit, që formojnë psikologji të dhunës, të urrejtjes, të vrasjes e të shfarosjes së qenies njerëzore.

Të nderuar besimtarë,

Muaji i Ramazanit është muaj i begative të shumta, rast i formimit të personalitetit tonë, të pastrimit tonë shpirtëror dhe fizik, të fisnikërimit të shpirtit, të trupit tonë, të të menduarit, të forcimit të lidhjeve tona reciproke, të

kultivimit të respektit dhe të thellimit të dashurisë ndaj njëri-tjetrit. Ky muaj është edhe rast i volitshëm i pajtimit tonë, i shtrirjes së ndihmës atyre që kanë nevojë - në veçanti, të varfërve dhe skamnorëve, sepse vetëm në këtë mënyrë do të jemi më afër kënaqësisë dhe faljes së Allahut Fuqplotë.

Më lejoni që në emër të BFI të RMV dhe në emrin tim t'ju shpreh urime të përzemërta me këtë rast, me lutje Allahut Fuqplotë që të na japë forcën e imanit, vetëdijen e lartë, vullnetin e paluhatsëm, që me përkushtimin më të madh të kryejmë agjërimin.

Ibadetet dhe lutjet tona të sinqerta - në veçanti, lutjet tona për një botë në paqe e tolerancë, shkojnë konform fjalëve të Muhamedit (a. s.): "Kush e agjëron muajin e Ramazanit me besim (të sinqertë dhe me shpresë se do të shpërblehet nga Zoti për të), do t'i falen të gjitha mëkatet e mëparshme."

Urojmë ambient të këndshëm të muajit të Ramazanit dhe: qoftë i bekuar ky muaj i madh dhe i shenjtë.

Zoti ju bekoftë.

*Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu*

## DHEMBJA E NJERËZVE

Shumë herë mund t'i lëndojmë njerëzit, pa e kuptuar kurrë dhembjen e tyre. I lëndojmë jetimët kur i pyesim "si ndërruan jetë prindërit e tyre", kur i pyesim prindërit "si ndërruan jetë fëmijët e tyre", kur e pyesim njeriun e papunë "pse nuk punon", kur e pyesim të uriturin "a ke ne-

vojë për ushqim" dhe të varfrin "a ke nevojë për para?"

Ne jemi të varfër, sepse nuk jemi mësuar të dhurojmë; jo pse nuk kemi, por pse nuk dimë! E kemi fytyrën, me të cilën mund të ndajmë buzëqeshjen; i kemi sytë, me të cilët mund të shikojmë të

mirën te të tjerët; e kemi gojën, me të cilën mund t'u japim këshilla e ngushëltime të tjerëve; e kemi zemrën, që mund ta hapim për të tjerët; dhe, i kemi duart, me të cilat mund t'i ndihmojmë ata që kanë nevojë për ndihmën tonë.

*(Hajrudin S. Muja)*

# BFI PRANË BESIMTARËVE NË NORVEGJI

Një delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i autorizuar nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, nga data 22 prill, 2022, po qëndron në Norvegji, thuhet në njoftimin e BFI.

Në delegacion janë Drejtori i Sektorit për Diasporë i Rijasetit të BFI, dr. Selver ef. Xhemaili dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame, prof. dr. Shaban ef. Sulejmani.

Ditën e parë ata vizituan Oslon, ku në Qendrën Shqiptare Fetare dhe Kulturorë të Norvegjisë (QIKSHN) dr. Selver ef. Xhemaili ligjëroi para namazit të xhumasë, ndërsa prof. dr. Shaban ef. Sulejmani mbajti një ligjëratë gjatë namazit të xhumasë.

Më pas, Drejtori i Sektorit për Diasporë dhe Dekani i FSHI dhanë një intervistë të drejtpërdrejtë (live) për Radio-Rilindja, e cila dëgjohet në tërë



Norvegjinë.

Për nder të delegacionit të BFI organizatori shtroi një iftar. Pas iftarit u mbajt edhe një tribunë fetare para namazit të teravisë, ku mori pjesë edhe Ambasadori i Maqedonisë së Veriut në

Norvegji, z. Serxhim Muhamed.

Qëllimi i vizitës së tyre gjatë ditëve të bekuara të Ramazanit është që të jenë sa më pranë xhemateve dhe bashkatdhetarëve tanë që jetojnë në këtë shtet evropian.

## TE BASHKATDHEARËT NË DANIMARKË

Pas vizitave të suksesshme në qendrat islame në Norvegji, delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV e vazhdoi rrugën në Danimarkë, thuhet në njoftimin e BFI.

Drejtori për Diasporë dr. Selver ef. Xhemaili dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame prof. dr. Shaban ef. Sulejmani më 23 dhe 24 prill, 2022, vizituan Bashkësinë Islame Shqiptare në Kopenhagë, Xhaminë Qendrore Shqiptare në Kopenhagë dhe Xhaminë Shqiptare në Ballerup.

Më 23 prill prof. dr. Shaban ef. Sulejmani vizitoi xhematin e Bashkësisë Islame Shqiptare në Kopenhagë, ku u prit nga Imami Abdurrahim ef. Kurtishi, ndërsa dr. Selver ef. Xhemaili vi-

zitoi xhematin në Xhaminë Qendrore Shqiptare në Kopenhagë, ku u prit nga Imam Abdylgafari. Një ditë më vonë, më 24 prill, bashkërisht vizituan Xhaminë Shqiptare në Ballerup në namazin e drekës.

Gjatë këtyre vizitave delegacioni i BFI u përcolli bashkatdhetarëve tanë selamet e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe falënderimet për gjithë kontributin në organizimin e jetës fetare në Perëndim, por dhe për angazhimin e palodhshëm për mirëmbajtjen e institucioneve edukativo-arsimore të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, thuhet në njoftimin e BFI.

## TURRI SKANDINAV PËRFUNDON NË MALMÖ

Delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV më 24 prill, 2022, vizitoi bashkatdhetarët tanë në Malmö (Suedi), si destinacion i fundit i vizitës në shtetet skandinave, thuhet në njoftimin e BFI.

Selver ef. Xhemaili dhe Shaban ef. Sulejmani vizituan Qendrën Islame në Malmö, ku u pritën nga Imami Roland Vishkurti dhe xhemati i mrekullueshëm i kësaj qendre islame.

Të dy pjesëtarët e delegacionit mbajtën ligjëratë dhe patën takime me bashkatdhetarët tanë, të cilëve u përcolllën selamet e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe falënderuan ata në emër të BFI dhe të Kryetarit të saj për kontributin që japin në prezantimin e Islamit dhe në organizimin e jetës fetare në vendet skandinave, por edhe në vendlindje, në institucionet edukativo-arsimore të BFI. Në përgjithësi, për tërë bashkëpunimin e mirëfilltë gjatë viteve.

Vlen të theksohet se Qendra Islame në Malmö është një qendër e madhe, me organizim të mirëfilltë dhe, përpos faltores me minare, ka edhe shkollën private, që i mëson nxënësit deri



në klasën e 9-të. Kjo qendër funksionon që nga viti 1983 dhe dhashtë Allahu fuqiplotë që të funksionojë deri në Ditën e Kiametit.

Allahu i bekoftë të gjithë ata që kontribuan dhe që kontribuojnë në ngritjen, në mirëmbajtjen dhe në ruajtjen e imazhit të kësaj qendre islame në Suedi, thuhet në njoftimin e BFI.

# ÇASTE RAMAZANI ME MËRGATËN TONË NË AUSTRI

Një delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV nga data 22 prill, 2022, ka vizituar Qendrat Islame në Austri, thuhet në njoftimin e BFI.

Vizita është bërë me autorizimin e Kryetarit të BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe në përbërje të tij kanë qenë Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti dhe Myftiu i Ohrit h. Samet ef. Ajdari. Vizita ishte me qëllim që të përndajë disa çaste ramazani me mërgatën tonë në Austri.

Ditën e parë h. Sabahudin ef. Zendeli dhe Sekretari i Përgjithshëm Jakupi vizituan Xhaminë e Bashkësisë Islame Shqiptare në 16 Bezirk të Vjenës. Përfaqësuesit e BFI fillimisht u mirëpritën nga Imami i Xhamisë, h. Afrim ef. Xhelili dhe Kryetari i Qendrës z. Senad Asani, Arkëtarë z. Adili dhe anëtarët e

Kryesisë. Më pas, Sabahudin ef. Zendeli mbajti ligjëratën e ditës së xhuma, me ç'rast falënderoi xhematin dhe përcolli selamet e Reis'ul-Ulemasë për mërgimtarët. Ai e falënderoi këtë xhematë të mrekullueshëm dhe potencoi se kjo xhami dhe ky xhematë janë zanafilla e organizimit të jetës fetare të shqiptarët në Austri.

Sekretari i Përgjithshëm, ndërkaq, mbajti hytben e xhumasë, ku potencoi vlerat e mëdha që sjell Ramazani, si dhe falënderoi xhematin në emër të Bashkësisë Fetare Islame dhe të Reis'ul-Ulemasë për kontributin që ata e japin në vazhdimësi për mbarëvajtjen e institucioneve edukativo-arsimore në Maqedoninë e Veriut.

Myftiu i Kërçovës, mr. Qamil ef. Rushiti, vizitoi qendrën kulturore shqiptare "Ikre" në Vjenë. Në këtë qendër u prit nga Imami Usam Alimi dhe Kryesia e Xhamisë, ku iu mundësua që të përcejllë

përshëndetjet në emër të delegacionit të BFI dhe të Reis'ul-Ulemasë. Po ashtu dhe falënderimet për punën që ata kanë bërë në promovimin e vlerave të larta fetare dhe kombëtare. Njëkohësisht, priu edhe në namazin e xhumasë.

Myftiu i Ohrit, h. Samet ef. Ajdari, i priu namazit të xhumasë në xhaminë "El-Buhari" të Vjenës. Ai falëndroi Imamin e Xhamisë, h. Ylli Buraniqi, për mikpritjen dhe xhematin e kësaj xhamie.

Vlen të theksohet organizimi i mirëfilltë i këtyre qendrave, të cilat janë shtylla të rëndësishme të diasporës sonë dhe janë mbështetëse të shumë projekteve tona në vendlindje. Vizita e delegacionit të BFI organizohet nga Komuniteti Shqiptar pranë Bashkësisë Islame të Austrisë-ALKIG.

Zoti i shpërbleftë me të mirat e Tij në këto ditë të bekuara të Ramazanit të gjithë mërgimtarët tanë kudo që ndodhen, thuhet në njoftimin e BFI.

## NË TERNITZ, LINZ, WELS, ST. PÖLTEN...

Delegacioni i Bashkësisë Fetare Islame të RMV më 22 prill, 2022, ishte në Ternitz, Linz, Wels dhe St. Pölten të Austrisë, thuhet në njoftimin e BFI.

Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, vizitoi xhematin e Xhamisë Bashkimi në Linz. Aty u prit nga Kryetari i Bashkësisë Islame Shqiptare ALKIG të Austrisë, z. Vahidin ef. Beluli, si dhe nga Imami, h. Menderez ef. Alili. Në pritje ishin edhe Hasim ef. Rexhepi dhe stu-

denti Abdusamed ef. Adili, bashkë me shumë anëtarë të tjerë.

Sekretari i Përgjithshëm i Bashkësisë Fetare Islame, h. Irsal ef. Jakupi, vizitoi xhematin në Ternitz. Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti vizitoi xhematin në Wels, ndërsa Myftiu i Ohrit h. Samet ef. Ajdari ishte në St. Pölten.

Të gjithë anëtarët e delegacionit të BFI i përshëndetën besimtarët dhe u dërguan selame në emër të Reis'ul-Ulema h.

hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe përcolllën falënderimet dhe mirënjohjet e tij për kontributin që japin në organizimin e jetës fetare atje, si dhe kontributin në vazhdimësi për institucionet edukativo-arsimore dhe jetën fetare në përgjithësi në vendin tonë.

Zoti i shpërbleftë me të mirat e Tij në këto ditë të bekuara të Ramazanit të gjithë mërgimtarët tanë kudo që ndodhen, thuhet në njoftimin e BFI.

## NË QENDRËN ISLAME NË MÜNCHEN

Sekretari i Përgjithshëm i BFI h. Irsal ef. Jakupi vizitoi Qendrën Islame në München dhe me këtë mbyllti vizitën për Ramazan në Austri-Gjermani, thuhet në njoftimin e BFI.

Një ditë më parë në Xhaminë Nur të Vjenës ishte Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, ndërsa në xhaminë "Ymer Pri-

zreni" në Graz (Grac) prezantoi Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli.

Me këtë ata mbyllën turrin e vizitave Austri-Gjermani për muajin e bekuar të Ramazanit.

Gjatë vizitave që bëri delegacioni i BFI përcolli selamet e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, duke falënderuar

këto xhemate të mrekullueshme për gjithë kontributin në organizimin e jetës fetare si në vendet ku punojnë, ashtu dhe në vendlindje.

Zoti i shpërbleftë me të mirat e Tij në këto ditë të bekuara të Ramazanit të gjithë mërgimtarët tanë kudo që ndodhen, thuhet në njoftimin e BFI. (25.04.2022)

# DOBITË E AGJËRIMIT

**Agjërimi është institucion që e ngre vetëdijen, që e shton vullnetin, që e rrit shpresën, që e heq depresionin dhe që jep kurajo për jetë të lumtur në të ardhmen.**

**Shkruan:**

**Prof. dr. Abdylxhemil Nesimi**

Agjërimi i muajit të Ramazanit është adhurim i pasur me dobi shpirtërore, sociale dhe mjekësore.

## a. Aspekti shpirtëror

Nga dobitë shpirtërore mund të përmendim atë se agjërimi e forcon më shumë besimtarin në sinjeritetin e tij ndaj Allahut, e bën atë më të durueshëm nga uria dhe etja dhe kjo gjë e forcon atë më shumë për sprovat e jetës.

Agjërimi e bën besimtarin të mendojë më shumë praktikisht për njerëzit e varfër, të cilët në shumë raste kanë uri dhe i merr etja. E largon njeriun nga mëkatet dhe në të njëjtën kohë e nxit besimtarin të punojë brenda këtij adhurimi e të bëjë punë të mira. E motivon besimtarin të ndihet më pranë vëllait të vet, e pastron nga veset e liga e kështu me radhë.

## b. Aspekti shëndetësor

Agjërimi si institucion fetar dhe si subjekt mjekësor është aq i vjetër, sa edhe vetë njerëzimi. Në lidhje me efektin shërues të agjëritimit, myslimanët përcjellin thënien famoze të Muhamedit (a. s.) të para XV shekujve: “Agjëroni, që të jeni të shëndetshëm” dhe përmes kësaj nxjerrin në pah vlerat kuruese të agjëritimit. Shprehja “do të jeni të shëndetshëm”, paraqet formën maksimale kurative për agjëruenin, në favor të dy pjesëve përbërëse të njeriut, të trupit dhe të shpirtit.

Se agjërimi është i dobishëm për shëndetin, dëshmojnë edhe shumë studime si të shkencëtarëve islamë, ashtu edhe të tjerët.

Agjërimi si parandalim është shumë i efektshëm për shëndetin e njeriut. Njeriu, duke agjëruar, e ndryshon orarin e punës



së organeve të tretjes, i lë të pushojnë organet e ushqimit. Ato pastrohen nga hehja e mbeturinave të trupit, e helmeve të tubuara nga konsumimi i ushqimit, i ilaceve, i pirjes së duhanit etj. Organizmi e shpenzon dhjamin e tepërt, duke zvogëluar peshën e trupit, duke ulur tensionin e gjakut, ndërsa me këtë rregullohet frymëmarrja, forcohet tonusi i zemrës etj. Sipas Hipokratit, babait të mjekësisë, “njeriu është mjek i vetvetes; nëse trupi nuk është i pastruar, sa më shumë ta ushqesh, aq më shumë do ta dëmtosh”.

Duhet të kemi një gjë të qartë se Krijuesi i gjithësisë nuk e ngarkon krijesën më tepër se sa duhet dhe sa mund të bart. Nuk kërkon prej tij më shumë se sa ai mund të realizojë. Është absurde dhe e palogjikshme që të mendohet se Krijuesi do të ngarkonte krijesën e Tij me atë që do të dëmtonte dhe do të ishte në disfavor të tij. Kësaj, njëherësh, i referohet ajeti kuranor në të cilin thuhet: “E, kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë; ndërkaq, kush është i sëmurë

ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju dhe nuk dëshiron vështësim për ju.” (El-Bekare: 185)

## c. Aspekti social

Agjërimi përpos asaj që ka karakter fetar dhe moral, ka edhe karakter human. Besimtari në këtë muaj solidarizohet më tepër se kurrë. Ai është më afër të varfërit, ngase tërë ditën kalon me stomak të zbrazët dhe është i obliguar që në këtë muaj t’u japë Zeqatin dhe Sadekatul-fitrin të varfërvë.

Ai që agjëron, ndjen se si njerëzimi ka nevojë, madje, për një kafshatë bukë, për një gllënjë ujë, se si i dobëti e i pamunduri është përballë Allahut - sado i fuqishëm qoftë dhe cilido qoftë pozita dhe posti i tij. Andaj, gjatë Ramazanit njerëzit tregojnë kujdes dhe i kushtojnë rëndësi edhe ndihmës ndaj të tjerëve, sidomos të varfërvë. E para në këtë aspekt është edhe aspekti social i Ramazanit, ku

myslimani pikërisht në këtë muaj e jep Zeqatin. Madje, të ftosh dikë në iftar, e forcon akoma edhe më shumë ndjenjën e miqësisë dhe të solidaritetit. Kështu, nëpër qytete të ndryshme të botës islame shtrohen sofrat e iftarit (Maidetu er Rahman) për skamorët. Qëllimi është që gjatë muajit të Ramazanit të gjithë të jenë të qetë shpirtërisht dhe të lumtur.

Agjërimi kultivon te njeriu virtutin e çiltërsisë shpirtërore, për arsye se individi kur agjëron, këtë akt ia dedikon Zotit të Gjithësisë. Individi që e kryen këtë ritual në mënyrë të përpiktë, pa dyshim është një njeri që mund t’i disiplinojë dëshirat dhe pasionet e tij nga gacmimet instinktive materiale. Këtë person e karakterizon një personalitet dhe karakter i lartë me devocion. Agjërimi njeriut i rikujton Allahun Fuqiptotë dhe tek agjëruesi zhvillon ndjenjën e përgjegjësisë.

Mbi të gjitha, agjërimi është sprovë e mirë morale që e pastron njeriun nga veset e këqija, që e largon individin nga veset e shëmtuara dhe i mbjell tek ai zakone të mira. Ai që agjëron dhe që qëndron për një kohë të kufizuar larg të mirave që na i ka dhuruar Krijuesi, e kupton edhe më mirë vlerën e këtyre mirësive. Qëndrimi larg mirësive që ia ka falur Perëndia njeriut, ka për qëllim kuptimin, ruajtjen dhe të falënderuarit e Zotit për të gjitha këto mirësi që i ka falur. Kjo sprovë morale, që vazhdon përgjatë një muaji, e rrënjës në zemër frikën ndaj Allahut.

## RAMAZANI, MUAJ I TRIUMFIT TË BESIMTARËVE

Duhet ta kemi të qartë se muaji i Ramazanit nuk është muaj i stagnimit, i shpenzimeve, i mbushjes së strajcave dhe stomakut. Aq më pak, muaj i pushimit, rehatisë dhe gjumit, duke e ndryshuar orarin e ditës me të natës: ditën t’i kalojmë në gjumë, kurse natën të lozim, të shikojmë telenovela, apo duke i lëvizur faqet e facebook-ut.

Nëse shfletojmë faqet e historisë sonë të lavdishme, do të kuptojmë se arritjet dhe ngjarjet më të mëdha të myslimanëve kanë ndodhur pikërisht në këtë muaj. Lirisht mund të themi se muaji Ramazan është muaj i ngjarjeve më të rëndësishme që njeh historia Islame.

Është muaj në të cilën triumfuan myslimanët, ngase më 17 Ramazan, vitin e 2 hixhrij, myslimanët triumfojnë për herë të parë kundër idhujtarëve në Bedër. Në vitin e 8-të hixhrij, po në Ramazan, myslimanët e çlirojnë Mekën. Po në Ramazan të vitit 15 hixhrij ushtria myslimane

korre fitoren e njohur në Kadisiye kundër zjarputistëve.

Një rëndësi të veçantë merr muaji i agjëritimit të Ramazanit përmes thënies në Kuran, sipas së cilës pikërisht ky muaj ka qenë ai kur më 27 të Ramazanit të vitit 610, kur Muhamedi (a. s.) i kishte mbushur të katërdhjetat, zbrasin ajetet e para të Kuranit Famëlartë. Pra, Allahu (xh. sh.) e nderoi këtë muaj dhe e veçoi me dy gjëra: obligimin e agjëritimit dhe zbritjen e Kuranit Famëlartë. Kjo ndodhi festohet gjatë natës së 27 të Ramazanit, si nata e përcaktimit hyjnor, e cila natë në gjuhën arabe quhet ‘Lailatul-kadr’. Kjo festë është me orgjinë kuranore; përkujtimin të zbulësës së Kuranit i përkushtohet surja 97, kaptina El-Kadër.

Pra, agjërimi është përgatitje e shpirtit për të lexuar Kuranin dhe për ta studiuar atë. Në agjërim shpirti gjen qetësi dhe përgatitet për të pranuar fjalët e Allahut të Madhërishtëm.

Mirësitë që i arrin individi përmes agjëritimit, namazit, leximit të Kuranit etj., kanë një dimension të gjerë dhe i përfshin të gjitha veprat. Studio ajetin kuranor ku thuhet: “**Ti nuk do të bësh asgjë, as nuk do të lexosh asgjë nga Kurani, as nuk do të punoni kurrfarë pune, e që Ne mos të jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të.**” (Junus: 61)

Agjërimi nuk është thjesht të privuarit e vetes nga të ngrënë dhe të pirët. Thjesht, kjo do të ishte një gabim shumë i madh nëse e vlerësonim agjërimin vetëm në këtë aspekt.

Shprehja “që të mbroheni”, që ndodhet në fund të ajetit të agjëritimit, ku thuhet se agjërimi është obligim, flet për domethënien e agjëritimit. Madje, i dërguari i Allahut thotë se agjërimi është një mburojë: “*Atëherë, ai që agjëron të mos thotë fjalë të këqija. Atij që kërkon ta ngacmojë dhe grindet me të ti thotë dy herë se është me agjërim.*”

Ashtu siç e ruan mburoja të zotit nga armiku, në të njëjtën mënyrë e ruan edhe agjërimi njeriun nga të këqijat dhe gjynahet.

## OBLIGIMET FETARE NUK JANË STINORE

Duhet të jemi të vetëdijshëm se obligimet fetare nuk janë stinore, por ato janë jetike dhe nuk pranojnë reduktim. Disa nga mosdija thonë se ‘Ramazani fal mëkatet pa bërë kurrfarë dallimi mes mëkatëve’. Prandaj, me të përfunduarit e tij vazhdojnë me avazin e vjetër.

Më habit fakti që shumë myslimanë gjatë Ramazanit me tespihe në dorë dhe

me gojën plot e shqiptojnë shehadetin, duke menduar se në këtë mënyrë bëhet dhikër - përkujtohet Allahu i Madhërishtëm. Por, me lamtumirën e Ramazanit fillojnë një jetë tjetër dhe më nuk janë ata myslimanë të Ramazanit. Vallë, a thua Ramazani vjen për t’i edukuar myslimanët vetëm në këtë muaj, apo për t’i edukuar ata që të jenë gjatë tërë vitit si në këtë muaj? Në këtë kontekst, Ramazani vjen për të na orientuar dhe mbrojtur fenë, apo për të na edukuar sipas fesë? Atëherë, parashtrahet pyetja: çfarë vlere dhe rëndësie do të kishte Ramazani që myslimanët të ishin korrektë dhe t’u përkushtoheshin ritualeve fetare vetëm në këtë muaj, duke harruar se viti ka 12 muaj.

Për atë, bamirësia është nën mbikëqyrje dhe vështrim. Mbikëqyrja e Allahut nuk ka të bëjë vetëm me një punë e të anashkalojë të tjerat, por Ai i ka nën mbikëqyrje të gjitha veprat, duke filluar nga namazi, kur myslimani është direkt në kontakt me Zotin, po ashtu edhe gjatë profesionit që e ushtron gjatë jetës së tij. Bamirësia të cilën e arrin individi nëpërmjet agjëritimit, namazit, leximit të Kuranit, ka një dimension të gjerë dhe i përfshin të gjitha veprat. Në Kuran thuhet: “Ti nuk do të bësh asgjë, as nuk do të lexosh asgjë nga Kurani, as nuk do të punoni kurrfarë pune, e që Ne mos të jemi dëshmitarë, kur ju të thelloheni në të.” (10: 61)

Ramazani e ndryshon gati në tërësi jetën e myslimanëve mbarë: gjithçka ndryshon te myslimanët - ngrënia, fjetja etj.; të gjithë hanë syfyri gati se në një kohë dhe çelin iftar po në të njëjtën kohë - sikur me u ushqye në një sofër. E tërë bota ndriçon nga ky mysafir i Allahut. Të gjithë lexojnë Kuran, falin namaz etj.

Qëllimi final i agjëritimit është mirëqenia e njeriut dhe lumturia e tij në të dy botët. Nuk ka gjuhë që mund ta përshkruajë momentin e gëzimit të agjëruetit kur çel iftar. Andaj, me gotën në dorë, me buzë të thata, me shpirt të gjallë, në këto çaste kujton përshkrimin e të dërguarit të Allahut, i cili thotë: “*Ai që agjëron ka dy gëzime: kur bën iftar, gëzohet me iftarin e tij; dhe, kur të takojë Zotin e tij, do të gëzohet me agjërimin e vet.*” Dhe, do t’i thuhet: “*Hani e pini shijshëm, ngase në ditët e kaluara ju e përgatitët këtë.*”

Agjërimi është institucion që e ngre vetëdijen, që e shton vullnetin, që e rrit shpresën, që e heq depresionin dhe që jep kurajo për jetë të lumtur në të ardhmen.

I tillë është Ramazani - muaj i pastrimit, i mëshirës, i gëzimit dhe që e largon njerëzimin nga mëkatet.

# BFI ME "KARVAN HUMANITAR" GJATË RAMAZANIT

Në prag të muajit të bekuar të Ramazanit, më 29 mars, 2022, Bashkësia Fetare Islame e RMV filloi aksionin e shpërndarjes së ndihmave humanitare për skamnorët, jetimët dhe nevojtarët në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut me titull "Karvan humanitar", thuhet në njoftimin e BFI.

Pejgamberi (s.a.v.s.) është lutur: "O Zoti im! Më bëj që të bëj punë të mira, të cilat më ofrojnë pranë Teje." Bazuar në këto parime të bamirësisë dhe të humanitetit, Bashkësia Fetare Islame e RMV tradicionalisht ka dëshmuar se akti i bamirësisë dhe humanitetit është cilësia më e përkryerë që e dallon njeriun prej krijesave të tjera, ashtu siç e dallon këtë institucion, duke e ngritur në nivelin më të lartë të humanitetit dhe të devotshmërisë.

"Cilësitë si: humaniteti, bamirësia dhe bujaria, dhe të gjitha aktet humane që bëhen për hir të Allahut Fuqplotë, janë predispozita që e shtypjnë Bashkësinë Fetare Islame të RMV që vazhdimisht, përmes organizimit të jetës fetare në vend e jashtë, të jetë çdo ditë pranë atyre që kanë nevojë", ishte mesazhi i Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili e përshëndeti fillimin e aksionit dhe apeloj që ai të



realizohet në përpikëri.

"Karvani humanitar" në formë solemne filloi nga Selia e Rijasetit të BFI të RMV, të cilin e nisi Kryetari i BFI h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Kryetari i OH "Hilal" mr. Fadil ef. Ramadani, Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, bashkë me operativat e Rijasetit dhe të Myftinisë së Shkupit.

Gjatë aksionit janë paraparë të shpër-

ndahen 3.200 paketa mish, respektivisht mbi 20.000 kilogramë. Aksioni për shpërndarjen e mishit do të vazhdojë edhe ditëve në vijim, në të gjitha myftinitë e BFI të RMV dhe do të koordinohet drejtpërdrejt nga Reis'ul-Ulemaja, bashkë me myftinjët, në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut. Me "Karvanin humanitar" gjatë muajit të bekuar të Ramazanit janë paraparë të shpërndahen edhe produkte ushqimore dhe sanitare, thuhet në njoftimin e BFI.

## "KARVANI", NË TËRË MAQEDONINË E VERIUT

Më 22 prill, 2022, Bashkësia Fetare Islame e RMV e filloi pjesën e dytë të aksionit të gjerë "Karvani humanitar", me shtrirje në tërë Maqedoninë e Veriut, thuhet në njoftimin e BFI.

Aksioni filloi në vigjilje të muajit të bekuar të Ramazanit, kur Bashkësia Fetare Islame në bashkëpunim me OH 'Hilal' nisi shpërndarjen e ndihmave humanitare. Bëhet fjale për ndihma humanitare të ardhura nga Turqia, donacion nga Drejtoria e Vakëfeve e Turqisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turqisë. Ndihmat tradicionalisht shpërndahen nga organizata humanitare e BFI 'Hilal'.

Në prezencë të Myftiut të Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, të Kryetarit të OH 'Hilal' mr. Fadil ef. Ramadani dhe përfaqësuesit të Vakëfeve të Turqisë, z.

Omer Tajfun dhe medies vendore, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e startoi këtë aksion të dytë, dedikuar skamnorëve, nevojtarëve, jetimëve etj.

"Bëhet fjalë për 4.000 paketa, të cilat vijnë nga Drejtoria e Vakëfeve e Turqisë, me të cilën vit për vit kemi, me të vërtetë, një bashkëpunim të mirëfilltë", tha mes tjerash Kryetari i BFI dhe shtoi: "Duke i ndarë këto dhuratat, unë e falënderoj Drejtorinë e Vakëfeve, si dhe të gjithë aktivistët që janë marrë me këtë punë me qëllim që këto ndihma, këto dhuratat të Ramazanit, të arrijnë në vendin tonë.

Falënderoj angazhimin e palodhshëm të Kryetarit të OH 'Hilal' mr. Fadil ef. Ramadani, i cili prej sot filloi të menaxhojë me shpërndarjen e të gjitha ndihmave, dhuratave të Ramazanit. Njëherësh, këtu jemi bashkë edhe me

dr. Qenan ef. Ismailin, pasi që ky aksion fillon nga Myftinia më e Madhe e BFI, pra Myftinia e Shkupit."

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu paraprakisht falënderoi të gjitha Myftinitë e BFI, të cilat do të përkujdesen që bashkë me OH 'Hilal' të bëjnë shpërndarjen e këtij amaneti për të gjitha ato familje besimtarësh që kanë nevojë. Ai gjithashtu, së bashku me Kryetarin e OH 'Hilal', falënderoi edhe pronarët e Magazinës JUS-MB, të cilët i kanë lëshuar hapësirat e depos së tyre dhe janë bërë pjesë e këtij aksioni gjatë muajit të bekuar të Ramazanit.

Në fund, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu të gjithë besimtarëve myslimanë u dëshiroi që këtë Ramazan ta përfundojmë sa më mirë, duke u uruar agjërim të lehtë dhe ibadete të pranuar tek Allahu Fuqplotë.

# "SHPORTA E RAMAZANIT" NGA ARABIA SAUDITE

Bujaria dhe bamirësia gjatë muajit të Ramazanit janë vetitë që e karakterizojnë këtë muaj në zemrën e besimtarit. Është fakt i patjetërsueshëm se në Ramazan shtohet bamirësia dhe shpërndahet mëshira ndaj njerëzve në nevojë. Bamirësia është çdoherë e rëndësishme për Islamin, andaj edhe Bashkësia Fetare Islame me seriozitet të madh e ka marrë këtë detyrë që të jetë gjithmonë pranë atyre që kanë nevojë, e sidomos gjatë muajit të bekuar të Ramazanit. Një nga shtyllat kryesore të Islamit është detyrimi që të pasurit duhet t'u dhurojnë një shumë të caktuar, monetare apo ushqimore, të varfërve, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë parim, më 21 prill, 2022, pak para iftarit, Bashkësia Fetare Islame në kuadër të aksionit "Karvani humanitar" në Medresenë Isa Beu në Shkup organizoi shpërndarjen e ndihmës "Shporta e Ramazanit", donacion nga Mbretëria e Arabisë Saudite, përkatësisht nga Mbreti Selman bin Abdulaziz al-Saud dhe trashëgimtari i fronit mbretëror Mohammed bin Selman.

Aksioni në fjalë u realizua nga Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri, Shkëlqesia e Tij z. Fejzal bin Gazi Hifdhi, nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Çështjeve Fetare Islame të Arabisë Saudite.

Në këtë ngjarje Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi për zemërsisht Mbretin e Arabisë Saudite dhe djalin e tij, trashëgimtarin e fronit mbretëror Mohammed bin Selman, duke iu dëshiruar shëndet dhe jetë të gjatë dhe duke lutur Allahun Fuqplotë që edhe më tej të udhëheqin me Mbretërinë në mënyrë të suksesshme, siç kanë bërë deri më tani.

Reis'ul-Ulemaja gjithashtu përcolli mesazhe edhe për popullin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, duke i dëshiruar muaj të begatë të Ramazanit dhe agjërim të pranuar tek Allahu Fuqplotë.

Edhe Shkëlqesia e Tij, Ambasadori Fejzal bin Gazi Hifdhi, përcolli fjalë miradije për popullin mysliman të Maqedonisë së Veriut. Ai falënderoi Reis'ul-Ulemanë për këtë organizim të mirëfilltë e të sinqertë, duke e çuar në vend amanetin e Lartmadhërisë së Tij,



Mbretit Selman bin Abdulaziz al-Saud, thuhet në njoftimin BFI.

Në një njoftim tjetër të BFI-së thuhet: Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 21 prill, 2022, pas iftarit, bashkë me miqtë nga Mbretëria e Arabisë Saudite, pati një telefonatë të drejtpërdrejtë me Ministrin e Vakëfit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Shkëlqesinë e Tij Abdulatif bin Abdulaziz el-Shejh, nën patronazhin e të cilit organizohet programi "Shporta e Ramazanit".

Ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, të nderuarin Fejzal Gazi el-Hifdhi, e shoqëronin personalitete të larta si: z. Hamed el-Seiri, Përgjegjës për Çështje Fetare; z. Saud el-Otaibi, përfaqësues i Ministrisë së Vakëfit të Arabisë Saudite, njëherësh menaxhues i programit "Shporta e Ramazanit";

z. Abdullah el-Anezij, shoqëruar dhe gazetar special i Ministrisë të Vakëfit. Mediat e Mbretërisë së Arabisë Saudite menjëherë raportuan mbi këtë ngjarje. Linku në vijim: <https://www.adwaalwatan.com/3500265/>


Në faqen e vet në Facebook, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir Fetahu, të njëjtën ditë ka shkruar: "Janë planifikuar 450 paketa dhe një sasi e konsiderueshme e miellit. Ambasadori Fejzal Gazi el-Hifdhi shprehu për zemërsisht kënaqësinë e tij për pritjen dhe organizimin e mirëfilltë nga ana e BFI të RMV, duke premtuar bashkëpunim në vazhdim. Në shenjë respekti, në Restorant Bushi në Shkup u realizua një iftar, ku morën pjesë personalitete të jetës fetare islame nga i gjithë territori i BFI-së, si dhe personalitete të sferave të ndryshme në shoqëri."



"Mikpritje nga Drejtori i Ndërmarrjes USMB në Komunën e Sarajit, z. Muharrem Bexheti, pasi startuam me ndarjen e dhuratave dhe ndihmën për besimtarët tanë. USMB është një ndërmarrje e mirënjohur, që ka të punësuar mbi 200 persona, dhe udhëhiqet nga dy afaristë të mirënjohur: z. Jusuf Jusufi dhe z. Muharrem Bexheti. Ata njihen si donatorë aty ku e do nevoja e fesë dhe e kombit. Unë i shpreha falënderimet tona në emër të BFI për ofrimin e ndihmës për çdo nevojë, e në veçanti për bartjen e ndihmave deri në ndarjen e tyre. Zoti i bekoftë", ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (21.04.2022)



**Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, me një postim në Facebook ka njoftuar se ka qëndruar për iftar në një familje në Kondovë të Shkupit. Ai me këtë postim u ka uruar qytetarëve të fesë islame muajin e Ramazanit, është bërë e ditur në rrjetet sociale më 8 prill, 2022. "Të gjithë bashkëqytetarëve të fesë islame në muajin e Ramazanit iu dëshiroj periudhë të qetë agjërimit, lutjesh dhe ditë të lumtura me të afërmit e tyre. E falënderoj familjen Tanallari në Kondovë për mikpritjen, të cilët më mundësuan që të jem pjesë e darkës së tyre të iftarit", ka shkruar Pendarovski.**



**TË JEMI DINJITOZË...**

“Përrjetojmë ditët e fundit të muajit të bekuar të Ramazanit. Jepni gjithçka nga potencialet tuaja shpirtërore dhe fizike, që në mënyrë dinjitoze ta përcjellim mysafirin tonë të madh dhe të begatë, që të jetë dëshmitar para të Madhit Zot për reformimin e personalitetit tonë gjatë këtij muaji për vepra madhore dhe ardhmëri të shëndoshë në këtë nënqiell. Zoti i Madh, na ndihmo”, ka deklaruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI. (25.04.2022)

# GËZIM E HARE NË ÇDO SHTËPI

Falënderojmë Allahun (xh. sh.) që na e mundësoi që edhe një herë të përjetojmë muajin e bekuar të Ramazanit, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Uniteti, mëshira e përgjithshme, ndihma, solidariteti, sakrificat dhe virtetet e ngjashme vijnë në shprehje gjatë çdo ibadeti e më së shumti në agjërimit, kur të gjitha zemrat bëhen një zemër dhe të gjithë trupat bëhen një trup, sepse flijimi bëhet vetëm për ta fituar kënaqësinë e Allahut Fuqiplotë.

Ne e dimë që Allahu (xh. sh.) nuk ka nevojë për sakrificat tona. Ai për tridhjetë ditë rresht na vë para sprovave për ta provuar gatishmërinë tonë, imanin tonë, për realizimin e premtimit që bëhet në emër të Tij. Po ashtu, ky muaj i bekuar na rikujton për kujdesin që duhet të kemi ndaj

nevojtarëve, ndaj të dobtëve dhe të paafetëve, ndaj të varfërve, me qëllim që në çdo shtëpi të myslimanit të përjetohet atmosfera e Ramazanit dhe të mbizotërojë gëzimi e hareja.

Shëndet, mbarësi dhe bereqet në familje. Agjërimit të lehtë e të pranuar; Allahu ju bekoftë, thuhet në njoftimin e dr. Qenan ef. Ismailit, Myfti i Myftinisë së BFI-Shkup.

# RAMAZANI ERDHI ME PRANVERËN

Muaji i agjërimit të Ramazanit këtë vit praktikisht përko me fillimin e pranverës. Kudo gjelbërim, lulëzim, cicërima zogjsh të lumtur herët në mëngjes.

E gjithë kjo na bën të mendojmë për një fillim të ri, për një shpresë, qoftë edhe në kohë të vështira.

Ramazani jep mundësi. Është kohë kënaqësie, pastrimi - fizikisht dhe shpirtërisht dhe për të marrë forca dhe energji të reja.

Sepse, të gjithë jemi lodhur nga lajmet e vazhdueshme në li-

dhe me pandeminë, por dhe nga ngjarje të tjera negative, trishtuese, shqetësuese, si: lufta aktuale. Të gjithëve na duhen energji të reja, përpjekje të reja për një jetë më të mirë për të gjithë.

Ne shpresojmë me gjithë zemër që kjo luftë e pakuptimtë (në Ukrainë-shën.) të përfundojë së shpejti.

Me përshëndetjet dhe selamet më të mira,

*(Zekirija Sejdini, Austri)*

# EDHE AGJËRIMI NA MBAN NEVE

Të agjërosh, nuk do të thotë të qëndrosh vetëm i etur dhe i uritur. Në Ramazan e kemi faljen (namazin) e shtuar, që na dhuron bashkim, pastërti, gjallëri, pajtim mes vete, sinqeritet dhe solidaritet.

Agjërimit gjatë tij në mënyrë më të bukur na gjallëron ndjenjën e empatisë dhe në formën më praktike na mundëson

që ta kuptojmë situatën e tjetrit.

Nuk e mbajmë vetëm ne agjërimit, por edhe ai na mban neve. Në fakt, na bën të përmbajtur nga gjuha, nga fjalët, nga shikimet, nga ecjet dhe lëvizjet tona.

Ramazani është muaj i afrimit dhe i bashkimit të radhëve tona. Ne do të falemi pranë njëri-tjetrit. Dhe, sa herë që do

të rreshtohemi pranë njëri-tjetrit për t’u falur, sikur një mesazh tingëllon në vesh: ‘ju mund të lartësoheni, të përparoni, të zhvilloheni vetëm kur punoni bashkë’.

Gjithmonë le të vazhdojë në mesin tonë kjo klimë e bekuar...

*(Dr. Selver ef. Xhemali)*

# RAMAZAN, RAMADAN...

Termi Ramadan rrjedh nga fjala "er-ramda", që e ka kuptimin "shi që bie në fund të verës dhe e pastron tokën nga pluhurat".

Sipas një shpjegimi tjetër, termi buron nga fjala "er-ramad", me kuptimin "nxehje apo djegie e gurëve nga rrezet e diellit".

Ashtu sikur ky shi që e pastron tokën; ashtu si vendi i nxehur që ua djeg këmbët atyre që ecin mbi të, edhe muaji i Ramazanit i pastron, i djeg dhe i zhdruk njollat e mëkateve nga besimtarët.

*(Salim ef. Sulejmani, Myfti i Myftinisë së Strugës)*

# MYFTIU I KOSOVËS URON RAMAZANIN

**B**ashkësia Islame e Kosovës ka sjellë më 1 prill, 2022, urimin e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan. Në urim, njofton BIK, thuhet:

Kam kënaqësinë që sot, para kohës së xhumasë, në natën e madhe të Ramazanit, t'ju drejtohem me këtë mesazh urimi, duke ju përgëzuar me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan, gjatë të cilit, besimtarët myslimanë anekënd globit kryejnë me bindje e përkushtim një ndër kushtet e besimit islam - agjërimin.

Për muajin e agjërimin, Allahu (xh. sh.) në Kuranin fisnik ka thënë: "Muaji Ramazan është muaji në të cilin zbriti Kurani, ai është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i së vërtetës nga gënjeshtria). Prandaj, kush e arrin prej jush këtë muaj, le të agjërojë..."

Agjërimi i muajit Ramazan për çdo besimtar është një ibadet që kryhet vetëm për hir të Krijuesit, me shpresën se për këtë do të ketë shpërblim vetëm nga Allahu (xh. sh.). Përmes agjërimin, besimtari mysliman synon që të jetë më i devotshëm, më i përkushtuar, më i ndjeshëm, më racional, më human dhe më tolerant në raport me vetveten, me familjen, me komunitetin dhe me shoqërinë në përgjithësi. Përveç kësaj, agjërimi i Ramazanit - ky ibadet i veçantë, e fisnikëron besimtarin, e bën atë më të durueshëm, më të afërt e më të çiltër.

Gjatë këtij muaji, ndër besimtarët agjëruar shtohet edhe ndjenja e përkrahjes dhe e solidaritetit shoqëror, sepse në këtë muaj ne jemi shumë më pranë familjeve, farefisit, miqve dhe komunitetit tonë. Këto ndjenja afrimi e dashurie shfaqen sidomos kur gjendemi rreth sofrës së Ramazanit në kohën e iftarit e të syfyrin, në vaktin e faljes së namazeve në shtëpitë dhe në xhamitë tona, si dhe në kohët e bashkëbisedimeve me të dashurit tanë.

Andaj, Ramazani përveç se një ibadet dhe farz i fesë sonë, ai është një muaj



i bekuar që na i freskon dhe na i ujit zemrat me begatitë e tij të shumta dhe na bën që të bashkohemi me familjarët tanë dhe, kështu, na mundëson që ta ruajmë e ta kultivojmë dashurinë dhe kujdesin për familjen dhe misionin e saj. Gjatë këtij muaji duhet të gjendemi edhe më pranë prindërve tanë, të cilët kanë shumë nevojë për dashurinë dhe kujdesin tonë; duhet të jemi më afër fëmijëve tanë, të cilëve u duhet mbështetja dhe ngrohtësia prindërore; duhet të gjendemi në ballë dhe t'u japim dorën e ndihmës vëllezërve dhe motrave tona, të cilët kërkojnë mirëkuptimin, pëlqimin dhe mbështetjen tonë. Të gjitha këto vlera e virtyte, në sajë të agjërimin, shumëfishohen, shprehen më fort dhe jetësohen gjatë gjithë muajit Ramazan.

Kur jemi te familja, më lejoni që në këtë natë të madhe, në vigjilje të muajit të bekuar të Ramazanit, t'u bëj apel të gjithë neve që të angazhohemi në ruajtjen dhe në edukimin e drejtë të familjes, ashtu siç na ka krijuar e na ka porositur Krijuesi i Gjithësisë, Krijuesi ynë - Zoti

i Madhërishtëm.

Zoti i Madhërishtëm llojin njerëzor e ka krijuar të tillë, me dy gjini e me mision të caktuar, aq sa asnjë akt a vendim nuk mund ta zëvendësojë rolin e nënës me të babait dhe as të babait me të nënës. Prandaj, në këtë muaj të mëshirës, të ibadetit e të solidaritetit, në këtë muaj Ramazani, ju ftoj të gjithëve që të jemi pranë familjes, ta ruajmë familjen dhe atë ta mbajmë në pedestal. Sepse, kur familja është e shëndoshë, edhe shoqëria është e shëndoshë dhe kështu e ardhmja jonë është e sigurt.

Në këtë muaj të bekuar Ramazan po hyjmë më të lehtësuar nga sfida e pandemisë covid-19, e cila dita-ditës po e humb forcën e saj, ndaj dhe lus të Madhin Zot që kjo të përfundojë sa më parë. Mirëpo, në këtë Ramazan, fatkeqësisht, po hyjmë me atmosferë luftërash e konfliktesh nëpër botë, nga të cilat po e pësojnë qytetarët e pafajshëm. Prandaj, në këtë muaj të rahmetit lutemi për paqe, për qetësi, për dashuri dhe mirëkuptim!

Gjatë muajit Ramazan të bëjmë më të mirën e mundshme me ibadete, me lutje, me namaz, me sadaka e solidaritet, që ta meritojmë dhe të na arrijë kënaqësia e Krijuesit.

Duke ju uruar mbarësi e shëndet, të gjithëve ju dëshiroj që muajin e madhërishtëm Ramazan ta përjetoni me të gjitha mirësitë e begatitë e tij, ju dhe familjet tuaja, kudo që gjendeni! I bëj lutje të Madhit Zoti që të na lehtësojë agjërimin dhe të na fisnikërojë me moralin dhe etikën e Ramazanit. Urime të gjithëve muaji Ramazan! – thuhet në urimin e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të bekuar të Ramazanit, njofton BIK.

## NDJESË

**Autor i tekstit "Veliu e Gazmendi në Natën e Miraxhit", në numrin e kaluar (faqe 34), është dr. Ilmi Veliu, Kërçovë. Në faqen 2 titulli duhet të jetë në trajtën e shquar: "Agresioni rus..." Nga Redaksia.**

# KORÇA ME "FTESË HYJNORE TË PËRVITSHME"

Muaji i Ramazanit është muaj i duriimit, i lutjes, i Kuranit, i bujarisë; është muaj i dashurisë, i vlerave njerëzore, i respektit dhe dorëzimit ndaj Krijuesit, thotë h. Ledian Cikalleshi, Myfti i Myftinisë së KMSH-Korçë.

Gjatë këtij muaji rizgjojmë ndjenjat e bukura, ndezim shpresat, pastrojmë ndërgjegjet dhe lutemi.

Feja islame u ka dhënë një rëndësi të madhe xhematit, adhurimeve të përbashkëta në grup, por Allahu i ka dhënë mundësinë njeriut që ta adhurojë Atë edhe individualisht. Kjo vlen edhe për Ramazanin.

Allahu (xh. sh.) në Kuranin famëlartë na jep sihariqin në suren Inshirah: "E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi". Pa harruar gjatë këtyre ditëve edhe ata që kanë nevojë për ndihmën tonë.

Ramazani është një ftesë hyjnore e përvitshme drejt njohjes së përgjegjësisë tona në raport me Zotin, me veten, me familjen, me të afërmit dhe shoqërinë. Ne kemi nevojë të pendohejmë për gabi-



met tona dhe, kur jemi agjërueshëm, është momenti i duhur t'i kërkojmë falje Zotit.

Të nderuar vëllezër dhe motra besimtare, kudo që gjendeni, i bëjmë lutje Allahut të Madhërishtëm që të na e pra-

nojë agjërimin, të na i pranojë adhurimet dhe veprat e mira. Ky muaj na sjell të begati, mirësi, paqe në familjet tona dhe në mbarë shoqërinë, thuhet në njoftimin publik të Myftiut të Korçës h. Ledian Cikalleshi.

# NJË SHËMBËLLTYRË NGA DIBRA

Myftinia e BFI-Dibër më 31 mars, 2022, në faqen e vet në Facebook ka shkruar:

"Dituria është vlerë dhe njësi matëse e përkushtimit të sinqertë ndaj Thirrjes, drejt sukseseve, largimit nga imitimi i verbër; për ndriçimin e mendjes, pastriqin e shpirtit, ruajtjen e vlerave morale, shpëtimin e vetes, rrëzimin e idhujve ideorë, të cilët i sjellin robërim dhe tjetërsim qenies njerëzore.

I nderuar dr. Kujtim Ameti, mirë se vjen në mihabin e devotshmërisë, në kursinë e këshillës, në hytben e urdhërimin në të mirë, të ndalimit nga e keqja dhe e shëmtuara, në dobi të qytetit dhe të besimtarëve tanë. Ngritja juaj shkencore islame i bashkohet karvanit të dr. Kujtim Mirzos, si dhe gjithë thirrësve të vendit tonë që lartësojnë ezanin Muhamedi, që zgjojnë zemrat drejt përkushtimit dhe adhurimit vetëm ndaj Krijuesit të gjithësisë, adhurimit të sinqertë, vlerave morale shoqërore, luftimit të padrejtësive - herë të imponuara, herë djallëzore e herë nga imitimi i verbër



dhe heshtja e ndërgjegjes dhe e shpirtit qortues.

I nderuar dr. Kujtim Ameti, institucioni ku ju do të veproni ka bërë nijet që themelet të jenë të ngritura me sinqeritet, me punë të dobishme - qofshin ato

të pakta. Ju si shëmbëlltyrë e shkencave islame, të vazhdoni t'i ngritni vlerat kombëtare-islame ashtu siç e ngriti Qabenë Ibrahimit (a. s.) me djalin e tij, Ismailin (a. s.). Suksese në misionin tuaj deri në takimin me të madhin Zot."

# MË LIRSHËM NË KËTË RAMAZAN

I kemi bërë të gjitha përgatitjet për muajin e bekuar të Ramazanit, ka njoftuar më 29 mars, 2022, Myftinia e BFI-Kumanovë. Myftiu i Myftinisë, Abedin ef. Imeri, ka uruar me këtë rast, duke lutur Allahun e Madhërishtëm që ta pranojë agjërimitin.

Myftiu Abedin Imeri ka thënë se këtë muaj po e fillojmë disi më të gëzuar,

ngase situata e pandemisë nuk është si ka qenë vitin e kaluar, kur kishte edhe disa kufizime. Ai falënderoi Allahun që pandemia është në fund, duke thënë se shpreson që njerëzimi të marrë frymë më lirshëm.

Gjatë Ramazanit kemi Komisione si nga BFI e RMV, ashtu dhe nga Myftinia e Kumanovës, detyra e të cilave është që t'i vizitojnë xhematet tona. Myftiu tha se

gjatë këtij muaji besimtarëve duhet t'u sqarohet mirë se Fitri dhe Zeqati u takojnë dy institucioneve arsimore: Medresesë Isa Beu dhe FSHI, me qëllim që amanetin që e kanë marrë mbi supet e tyre ta kryejnë me përgjegjësi më të lartë.

Agjërimit të lehtë, me ibadete të pranuara nga Allahu (xh. sh.), thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

## ALLAHU (XH. SH.) MËSHIRON OHRIN

Miku ynë i quajtur Ramazan troket në dyert tona për të na dhuruar dashurinë, mëshirën, harmoninë, lumturinë, kënaqësinë, faljen dhe shpresat e jetës, thuhet në njoftimin e h. Samet ef. Ajarit, Myftiu i Myftinisë së BFI-Ohër.

Mësuesi dhe edukatori i njerëzisë dhe mëshira e të gjitha botëve - Muhamedi (s.a.v.s.) - na mësoi se natën e parë të Ramazanit Allahu (xh. sh.) e lëshon shikimin e Tij, mëshirën e Tij te besimtarët islamë dhe, kush përfshihet në këtë mëshirë, ai do të jetë i shpëtuar.

Këtë muaj, për hir të zbritjes së Kuranit fisnik, për hir të agjërimit ditën dhe të faljes së namazit natën që bëjnë besimtarët islamë, Allahu (xh. sh.) e urdhëron Xhenetin dhe i thotë: 'Zbukurohu për besimtarët e Mi, që kanë agjëruar këtë muaj.'

Ky ibadet kryhet me sukses dhe lehtësi, me sinqeritet dhe dashuri. Prej këtij muaji dilet i pastër prej mëkateve, me shëndet dhe mirëqenie të përgjithshme për familjet tona, thuhet në njoftimin nga Myftinia e Ohrit.

## MIRËNJOHËS NDAJ RADIO-SHKUPIT



Me rastin e realizimit të emisionit fetar në lidhje me hyrjen në muajin e Ramazanit, pata nderin që të takohem me Përgjegjësin e Radio-Shkupit në gjuhën shqipe, z. Haki Mustafa, gazetarin e mirënjohur, i cili me suksesin më të madh, me dekada, e

kreu këtë detyrë të shenjtë. Na priti me kënaqësi dhe biseduam për punën e tij të madhe në këtë institucion, duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe ngritjen e këtij institucioni. Hapësirë të veçantë u ka dhënë vlerave fetare e kultu-

rore. Ne u shprehëm mirënjohjet tona dhe i falënderuam shumë - ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook më 4 prill, 2022.

# NË PRITJE TË NATËS SË KADRIT

*Nga Shaqir ef. Fetahu*

Jemi në vigjilje të Natës së madhe të Kadrit, natës së vlerave të pakufishme, ku çdo vepër në këtë natë vlen sa një mijë muaj.

Kjo është nata e një lidhje kulminante me Krijuesin, nata e një ambienti dhe e një ndjenje të prezencës së melaqeve në krye me Xhibrilin, nata e ndjenjës së zbritjes së Kuranit dhe e ambientit të përmbushur me mëshirë, falje, vetëdije, sinqeritet, meditim, vetërikthim në vete, paqe me gjithçka; që bën të jesh me Zotin, që dëshmon ngritjen e madhe

shpirtërore, intelektuale dhe fizike.

Këtu edhe fillon kulmi i definicionit të gjithçkaje që të rrethon, duke e gjetur qëllimin e jetës dhe lidhshmërinë me botën tjetër.

Është fat i madh që këtë natë e presim më të përgatitur se kurrë.

BFI e RMV në tërë territorin e saj jep maksimumin me aktivitetet që bën. Myftinitë dhe institucionet fetare-arsimore e shkencore, me programet e tyre në mënyra të ndryshme sensibilizuan ambientin islam, saqë depërtuan te çdo njeri dhe në çdo shtëpi e familje, edhe atë: nga Kumanova deri në Strugë.

Uroj Natën e Madhe të Kadrit, me qëllim që t'i qasemi nga të gjitha aspektet me aktivitete maksimale, për të dëshmuar edhe një herë para Zotit të Madhërishtëm se jemi të denjë ta bartim amanetin e shenjtë të besimit, të kombit dhe të vatanit tonë.

Zoti i Madh! Udhëzimi Yt është i domosdoshëm për ne. Lësho paqen dhe faljen Tënde mbi ne. Pranoji prej nesh mundin, përpjekjet dhe veprat tona në Natën e Madhe të Kadrit.

Amin. /27.04.2022/

*(Autori është Reis'ul-Ulema i BFI të RMV)*

## NATA E KADRIT SHËNOHET NË SHKUP



Më 27 prill, 2022, në natën e 27-të të Ramazanit, Myftinia e Shkupit organizoi një program të begatë fetar për nder të Natës së Kadrit në Xhaminë e Mustafa Pashës, thuhet në njoftimin e BFI.

Me këtë rast, xhematit të Shkupit i janë ofruar disa caste shpirtërore me program të begatë fetar, me Kuran, ilahi e këshilla.

Manifestimin e nderuan: Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetari i Parlamentit të Turqisë prof. dr. Mustafa Shentop (Mustafa Şentop),

Ambasadori i Turqisë në Shkup Hasan Mehmet Sekizkök, Atasheu për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë, hoxhallarë, hafëzllarë dhe shumë

personalitete nga sfera të ndryshme.

Me mikpritjen e tyre nderuan edhe imami i Xhamisë Mustafa Tarik Koxha, Këshilli i xhamisë dhe xhemati i pranishëm.

Hoxhallarët dhe hafëzllarët që ishin pjesë e programit dhe që i prinë xhematit në faljen e namazit të teravisë: dr. Talha ef. Kurtish, hatib në xhaminë "Kasim Beu", Shkup; Llokman ef. Kamberi, hatib në xhaminë "Allaxha", Shkup; Mustafa ef. Mesten, Atashe për Çështje Fetare pranë Ambasadës së Turqisë; hfz. Xhemal Nuhiju, përgjegjës i Institutit të Hifzit "Hafëz Ismail Efen-diu", Shkup; hfz. Fatih Derdiyok, imam në Xhaminë e Mustafa Pashës; hfz. Abdylqerim ef. Ebibi, imam në Xhaminë e

Dyqanxhikut; hfz. Mustafa Tarik Koxha, imam në Xhaminë e Mustafa Pashës; Furkan ef. Jahja, myezin në Xhaminë e Mustafa Pashës, thuhet në njoftimin e BFI. Një njoftim kishte bërë edhe Myftinia e Shkupit.

Në faqen e vet në Facebook Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu të njëjtën ditë kishte shkruar: "Natë e Madhe në Xhaminë Mustafa Pasha në Shkup."

Në këtë natë të pranimit të lutjeve, i bëj lutje Allahut të Madhërishtëm që të na i pranojë të gjitha ibadetet tona dhe të përfitojmë nga mirësitë e panumërta të saj, me shpresë që të na kaplojë Mëshira dhe Falja e Tij! – ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në rrjetet sociale.

# MYFTINIA E SHKUPIT, MË PRANË BESIMTARËVE

Ramazani për Myftininë e Shkupit është muaj përplot angazhime e aktivitetet, por ajo që më së tepërmi ka rëndësi është se ky muaj na e jep mundësinë që të jemi sa më pranë besimtarëve, thuhet në njoftimin e Myftiut Qenan ef. Ismaili.

Gjatë këtij muaji të bekuar jemi munduar që t'i nderojmë besimtarët e katër anëve të Shkupit, hoxhallarët dhe Këshillat e xhamive.

Dua të shpreh mirënjohje dhe falënderim për gjithë kolegët tanë – hoxhallarë, si dhe për Këshillat e xhamive në katër rajonet e Myftinisë së Shkupit që na ftuan për të mbajtur ligjëratë dhe për të prezantuar në namaz të teravisë.

Këtë Ramazan, si çdo vit, kemi pranuar ftesa nga shumë xhami. Aty ku kemi hapësirë e mundësi, kemi qenë të pranishëm; aty ku nuk kam mundur që të jem

i pranishëm për shkak të angazhimeve shtesë, kam deleguar referentët e rajoneve që të jenë pranë besimtarëve.

Ky respekt që gëzojmë në të gjitha rajonet e Shkupit na jep edhe më shumë detyrim që të jemi në shërbim të besimtarëve tanë; ditë e natë.

Qofshim gjithmonë në rrugë të mbarë e pranë besimtarëve, thuhet në njoftimin e Myftiut Qenan ef. Ismaili. (30.04.2022)

## “DHJETËNETËSHI I FUNDIT”, NË BATINCË

Më 25 prill, 2022, 24 Ramazan 1443 H, në xhaminë “Fatih Sulltan Mehmed” të fshatit Batincë organizuam një program të begatë kushtuar dhjetënetëshit të fundit të muajit të bekuar të Ramazanit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Në këtë program morën pjesë Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef.

Ismaili, operativa e Myftinisë, hoxhallarë, hafëzllarë dhe xhemati i Karshia-kës e më gjerë.

Fjala e rastit i takoi nikoqirit të këtij organizimi, Myftiut dr. Qenan ef. Ismaili. Imami i xhamisë, hfz. Ramadan ef. Hajredini, pati fjalën përshëndetëse.

Pjesë e këtij programi ishin: Ibrahim

ef. Ibrahim, hatib dhe imam në Xhaminë me Dy Minare, Vizbeg; Llokman ef. Aliu, imam në xhaminë “Omer ibn Abdulaziz”, Kamenik; Ali ef. Sadiku, hatib në xhaminë “Rezistenca”, Haraçinë; hfz. Nesim ef. Bajrami, hatib dhe imam në xhaminë e Nerezit; hfz. Mesud ef. Jusufi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.


## “NJË JETË NË SHËRBIM TË ISLAMIT”

Myftinia e BFI-Shkup sjell për të gjithë besimtarët projektin më të ri “Një jetë në shërbim të Islamit”. Projekti më i ri mediatic do të jetë në moderim dhe nën kujdesin e hoxhë Ali Ziberit, ka njoftuar më 24 mars, 2022, Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili.

Projekti u kushtohet hoxhallarëve tanë, të cilët jetën ia kushtuan xhamisë, mejtepit dhe besimtarëve në predikimin e fesë islame dhe në edukimin e brezave në Shkup e më gjerë.

Personaliteti i hoxhës; jeta personale, detyra që ka mbartur mbi supet e tij ndër vite, sprovat, peripetë, sakrifica, momentet më të mira e më të vështira gjatë kryerjes së këtij misioni të shenjtë; me një fjalë, gjithçka rreth kontributit dhe jetës së hoxhës.

Mulla Sali Murtezani nga fshati Semenishtë është personaliteti i parë me të cilin do të fillojë videoprojekti “Një jetë në shërbim të Islamit”. Allahu i Madhërishtëm na dhashtë sukses edhe në këtë videoprojekt të radhës, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.



# RAMAZAN, PAS DY KUFIZIMEVE SOCIALE

*Nga Kujtim Mirzo*

Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhërishtëm, i Cili na e mundësoi ta arrijmë edhe sivejt muajin e bekuar të Ramazanit.

S'ka dyshim se arritja e muajit të Ramazanit është një dhunti dhe begati shumë e madhe nga Allahu i Madhërishtëm. Dëshira e shumë njerëzve ka qenë që ta agjërojnë këtë muaj të bekuar, mirëpo sivejt ata nuk janë në mesin tonë. Allahu i mëshiroftë!

I dërguari i Allahut, Muhamedi (alejhi salatu ve selam), lutej që Allahu t'ia mundësojë arritjen e këtij muaji madhështor. Shokët e tij, kur përfundonte muaji i Ramazanit, gjashtë muaj luteshin që Allahu t'ua pranojë adhurimet e bëra në Ramazan, ndërsa gjashtë muaj luteshin që Allahu t'ua mundësojë ta arrijnë Ramazanin tjetër.

Çka do të thotë të arrish një ramazan? Transmetohet nga Talha bin Ubejdilal (r. a.), se dy shokë shkuan tek i dërguari i Allahut (s.a.v.s) dhe e pranuan Islamin. Më pas, njëri prej tyre përpiquej më shumë në fe, mori pjesë në një betejë dhe ra dëshmor. Ndërsa tjetri jetoi edhe një vit pas tij dhe vdiq me vdekje të rëndomtë.

Thotë Talha (transmetuesi i kësaj ngjarje): *Pasi që ata kishin vdekur, i pashë të dy në ëndërr. Unë dhe ata të dy qëndronim te dera e Xhenetit. Doli dikush nga Xheneti dhe i dha leje të hyjë në të atij të dytit, i cili vdiq një vit më pas me vdekje të rëndomtë. Pastaj doli edhe një herë dhe i dha leje të hyjë atij të parit, që ra dëshmor në betejë. Ndërsa mua më tha: Kthehu! Akoma nuk ka ardhur koha për ty.*

Talha u zgjua në mëngjes shumë i habitur. U tregoi shokëve të tij; edhe ata u habitën shumë. Derisa kjo ëndërr arriti tek i dërguari i Allahut (s.a.v.s) dhe ai tha: *'Pse po habiteni?'* Thanë: *'O i dërguar i Allahut! Ai i pari përpiquej më shumë në fe; po ashtu, ra edhe dëshmor. Pse ai i dyti hyri para këtij në Xhenet?'* I dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha: *'Po mirë, a nuk jetoi ky i dyti*



edhe një vit më shumë? A nuk arriti edhe një ramazan duke agjëruar, duke u falur dhe duke bërë aq shumë sexhde për një vit?' Thanë: *'Gjithsesi!'* I dërguari i Allahut (s.a.v.s) tha: *'Dallimi mes atyre të dyve në Xhenet është aq sa është largësia mes qiellit dhe tokës.'* (Ibn Maxhe dhe Ahmed)

Ky ramazan sivejt erdhi pas dy ramazaneve me kufizime dhe me masa të caktuara të pandemisë. Le të jetë ky ramazan një ramazan çlirimi, një ramazan kënaqësie, një ramazan i përjetimit të begatave dhe të mirësive të tij më shumë se në dy vitet e kaluara.

I shfrytëzuar me agjërim, me namaze vullnetare, me lexim Kurani, me dhikër, me istigfar dhe me pendim tek Allahu i Madhërishtëm, muaji i bekuar i Ramazanit është zotëri i të gjithë muajve dhe dyfishues i mirësive dhe dhuntive të Allahut Famëlartë. Ky muaj i bekuar ditët i ka të caktuara, kujtimet dhe kënaqësitë të paharruara dhe veprat e mira të shumëshpërblyera.

Ramazani është sezon i mirë dhe mejdani i gjerë për të bërë punë të mira, për t'u afruar me të Allahun e Madhërishtëm. Andaj, ta njohim vlerën e tij, të mos e harrojmë atë, të pajisemi dhe të përgatitemi për të dhe ta shfrytëzojmë sa më shumë atë.

Kur vinte muaji i bekuar i Ramazanit, i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) i përgëzonte shokët e tij duke u thënë: *"Ju erdhi muaji i Ramazanit, muaji i bekuar. Allahu ju ka urdhëruar të agjëroni në të. Në këtë muaj hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe shejtanat prangosen. Në këtë muaj është një natë, vlera e së cilës është më e madhe se një mijë muaj. Kush privohet nga kjo e mirë, ai është vërtet i privuar."*

Njerëzit në pritjen e Ramazanit janë në tri grupe: 1. Besimtarë të mallëngjyer për muajin e Ramazanit, të cilët atë e presin me padurim dhe me dëshirë të madhe, gëzohen shumë që ai po vjen, që të marrin energji imanore dhe pozitive që ta ndërtojnë shtyllën e agjërit, mbi të cilën qëndron besimi i tyre, që ta arrijnë mëshirën dhe faljen e Allahut të Madhërishtëm dhe të afrohen me Të me punë të mira; 2. Njerëz me qëndrim normal, ndoshta me pak frikë, që mjaftohen vetëm me agjërimin e tij, duke mos u përpjekur për ta shfrytëzuar atë; 3. Të tillë (njerëz), që aspak nuk tregojnë asnjë interesim për të - sikur të mos jetë Ramazan dhe e vazhdojnë jetën e tyre në mënyrë normale.

Ata që e kuptojnë Ramazanin si sezon mësimi dhe edukimi shpirtëror, si sezon për përfortimin e imanit, për pastrimin e moralit dhe forcimin e vullnetit - ata janë që përfitojnë prej tij.

Myslmanët e gjeneratave të para i kuptuan mirë urtësitë e Ramazanit. Ditët dhe netët e tyre ishin të mbushura dhe të gjallëruara me adhurime të ndryshme. Mbi të gjitha, i kushtonin kujdes të madh leximit të Kuranit Fisnik.

I bëjmë lutje Allahut të Madhërishtëm që në këtë muaj të na falë e të na mëshirojë, që adhurimet dhe lutjet të na i pranojë dhe të gjithë neve në familjet tona të në begatojë.

Agjërim të pranuar! Urime!

*(Autori është Hoxhë me shërbim në Myftininë e BFI-Dibër)*

# HAFËZ MUSLIU KËNDON NË XHAMINË E BARDHË...

Nga **Nehat V. Ismaili**

Zëri i ëmbël dhe i bukur është një bekim nga Zoti i Madhërisëm, të cilin ia dhuron kujt të dojë prej robve të Vet. Disa prej tyre e përdorin atë në bindje dhe devotshmëri, e disa prej tyre e përdorin atë në mosbindje.

E njëjta gjë vlen edhe për leximin e Kuranit fisnik. I dërguari i Allahut na ka urdhëruar që ta zbukurojmë zërin tonë me Kuran dhe të këndojmë - të jemi të mirë dhe të jemi edhe më të mirë në leximin dhe këndimin e Kuranit fisnik.

Gjatë gjithë kohës së lirë shpesh shikoj kanal in satelitor të Kuranit fisnik, i cili transmetohet nga Xhamia e Shenjtë në Mekë. Këtë kanal të bekuar e përcjell sa herë që ulem në sofrën e iftarit dhe në syfir dhe më bëjnë përshtypje disa zëra të bukur. Që nga koha e studimeve në Universitetin Islamik në Medinë, ishin disa lexues të mrekullueshëm. Edhe sot, dorën në zemër, veçohen disa lexues të mrekullueshëm.

Por, sot jemi me fat që në mesin tonë kemi lexues shqiptarë të mrekullueshëm, të cilët, dorën në zemër, aspak nuk dallojnë nga imamët me origjinë arabe në dy



Xhamitë e Shenjta, në Mekë dhe në Medinë.

Xhemati i Xhamisë së Bardhë në Aarburg (Zvicër) këtë vit është nderuar dhe nuk ka pse të shikojë në kanalet zyrtare të dy Xhamive të Shenjta, sepse një zë të tillë të bukur, të ëmbël dhe shumë të këndshëm, e kemi në mesin tonë gjatë Ra-

mazanit. Është ai një djalë që e ka bekuar Allahu me një zë të mrekullueshëm, unikat dhe të fuqishëm...

Kush tjetër, pos hfz. Musli Musliu. Allahu e ruajtë!

Atmosferë e mrekullueshme në Xhaminë e Bardhë-Aarburg gjatë Ramazanit 2022.

## DY RAMAZANE IKËN ME MASA KUNDËR KOVIDIT

Nga **Irfan Agushi**  
(Zvicër)

Viti i parë ishte vërtet keq, pasi namazi nuk mund të falej në xhami. Ishte viti kur u mbyllën thuajse të gjitha institucionet shoqërore-publike, përshfi këtu edhe shtëpitë e kultit si: kishat dhe xhamitë.

Viti i dytë ishte pak më i lehtë, por përsëri me masa strikte. Në xhami mund të merrnin pjesë 50 persona, të larguar nga

njëri-tjetri, me maskë, me certifikatë etj.

Sot, elhamdulillah, pas dy ramazaneve falim namazin e teravive pa asnjë ndalesë. Pikërisht

më 1 prill, në natën e parë të Ramazanit, Qeveria e Zvicrës hoqi të gjitha masat e kovidit. Një kontribut i Ministrisë të Shëndetësisë, Berset. E kaluara le të jetë një shembull se si duhet vepruar në situata të veçanta dhe të mos ndjekim qëndrimin e një shoferi autobusi, bie fjala, dhe të hedhim pas krahësh mendi-

min e një eksperti të lëmisë, siç na ndodhi në shumë raste.

Falë Zotit, sot jemi në një situatë ku pengesa e vetme e një besimtari për të shkuar në namazin e teravive mund të jetë ushqimi i tepërt, ose një lojë dominosh në kafenenë e lagjes - një vegël kjo që punon për shejtanin e mallkuar, ndërkohë që ai është i prangosur.

P. s. Ju lutem, të mos më thotë kush se dominot dhe "gurëzit" i kanë shpikur Sorosi dhe Bill Gejtsi!

# RAMAZANI, SHPIRT QË NUK PLAKET

Nga **Hysein Rizai**

Ora 7 pasdite. Ditë Ramazani.

Ashtu, me sebeb, isha te dyqani i mëhallës për të blerë ca pije për iftar.

Si asnjëherë më parë më kapluan ca ndjenja trishtimi. Mendova se eci vetëm unë dhe hija ime.

Gjithçka ishte e qetë, sikur tërë qyteti për një moment ishte zhvendosur në një pjesë tjetër të gjeografisë.

Fillova të flas me veten dhe doja të ndalet koha e të më bart në fëmijërinë time.

Interesant!

U futa në botën e emocioneve dhe e shihja veten se si jam duke pritur të ndizen dritat e minares e të filloja thirrjet: "Jandile."

Sa dua ta kthej këtë ndjenjë dhe buzëqeshje të fëmijët e sotëm.

Oh, sa mall kam për atmosferën që ngjallte çdo ndjenjë në vigjilje të Ramazanit në kohën e iftarit, kur jeta në çdo cep bëhej e zjarrtë, e emocionuar dhe, në të njëjtën kohë, e mbushur me kënaqësi dhe gëzim të veçantë.

Ku humbën këta fëmijë? Ku humbi ajo rrëmujë para iftarit? Më vjen të bërtas, që e kaluara ime ta dëgjojë dhimbjen time.

Bukuria, arti i Ramazanit janë iftaret.

Kënaqësia dhe ëmbëlsia e iftarit krahasohet me momentin kur besimtari e sheh Zotin!

Iftari është një vakt festiv, që bëhet çdo ditë të Ramazanit në fund të agjërimit, pasi të ketë perënduar dielli. Të gjithë agjëruerit pajtohen se enët e iftarit kanë një aromë të veçantë dhe një shije e ëmbëlsi unikalë.

Shumë prej nesh i përjetojnë iftaret veçanërisht në mënyrë sentimentale, sepse iftaret na kujtojnë ditët e shkuara të fëmijërisë, të cilat na sjellin ndër mend gjyshërit, nënat dhe baballarët tanë që u shpërngulën në Ahiret dhe ende jetojnë në kujtimet tona.

Çdo pazar dhe mëhallë ka zakonet e veta të veçanta të Ramazanit, gatimet dhe shtesat karakteristike të një recete të caktuar, për atë rajon dhe për ata njerëz.

Iftar - oh me çfarë admirimi dhe ndjeshmërie motrat dhe nënat tona i qasen përgatitjes së pjatave për iftar; aq shumë vëmendje, përqendrim dhe dashuri në

përgatitjen e këtyre gjellëve, mund të shihet vetëm gjatë Ramazanit.

Shumëllojshmëria e menysë dhe dimensionit i saj i moçëm, tetovar, është i papërshkrueshëm dhe unikat. Pite, dolma të ndryshme, qofte, paça, pilaf dhe ushqime të tjera, me kripë a të ëmbla, të cilat përgatiten posaçërisht vetëm gjatë muajit të Ramazanit, reflektojnë imazhin e xhenetit.

Iftaret edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të përgatiten nga nënat dhe motrat tona, por thuajse me një tjetër dashuri, me një tjetër buzëqeshje.

Tani, kur po i shkruaj këto rreshta, i jap vetes vrapin për të dalë nga shtëpia, për t'u rënë dyerve dhe zileve në shtëpitë e fqinjëve me të thirrura "Teravi! Teravi!"

Çdo natë Ramazani pres se mos, vallë, dikush do t'i bie zilet.

Sa të lumtur ishim se do të shkonim

në xhami që të falemi, që të luajmë si fëmijë, që të qeshim, "që të bëjmë probleme". Kulmi i gjithë kësaj ishte kur nervozoheshin më të vjetrit, ndërsa në nuk ndaleshim së qeshuri.

Ah, ajo periudha pas teravisë, deri në syfyri! Sa jetë na falte! Deri në syfyri i tërë qyteti ishte i mbushur me njerëz që qëndronin jashtë. Më të vjetrit, nëpër çajhane; ata të moshës së mesme, në qendër të qytetit hanin fara kungulli dhe bisedonin; më të vegjëlit qëndronin nëpër mëhallët e tyre dhe luanin lojëra të ndryshme si: futboll, basketboll, xhamia, kukafshehtas e shumë e shumë të tjera.

A thua, vallë, do kem fatin që të shoh edhe një herë fytyra të buzëqeshura dhe atmosferë Ramazani?! Me shpirt që nuk plaket.

(Autori është hoxhë me angazhim në Myftininë e BFI-Tetovë)



**KROJET E NEREZIT:** Haxhi Iseni nga Nerezi pranë këtij kroji, të përtëritur, ka mësuar Kuranin në kohën e Perandorisë Osmane. Librin e Allahut e ka mësuar përmendsh këtu e më gjerë dhe Hifzi i tij është pranuar nga Bashkësia Islame e kohës. Pas kësaj emërohet hoxhë në Nerez dhe është hoxha i parë në këtë vendbanim shqiptar të rrethinës shumë të afërt të Shkupit, rrëzë Malit të Krojeve (Vodno). Ezani i parë në këtë fshat është thirrur prej tij. Allahu me xhenet e shpërbleftë. AMIN. (Foto dhe teksti: KMZ)

# BAJRAMI, DITË E SHPRESËS SË MADHE

# TV IKRE, RAMAZANI 2022



**Nga Shaqir ef. Fetahu**

**D**itë Bajrami. Ditë e festës së madhe. Ditë e fitores së njerëzores dhe hyjnore gjatë Ramazanit të bekuar. Ditë e ngrohtësisë shpirtërore.

Gëzimi dhe kënaqësia le të mbulojnë familjet tona. Buzëqeshja le të jetë fytyra jonë me të afërmit dhe të tjerët. Lidhim zemrat dhe shtrëngojmë duart e besës dhe të fjalës.

Zoti do t'u japë dritën zemrave që iu përkushtuan Madhërisë së Tij. Engjëjt krenohen me sakrificën tonë për Zotin.

Andaj, falni njerëzit. Është rasti më i lehtë për këtë. Jepini paqen çdo sendit. Jepini krenarinë çdokujt. Jepini shpresën edhe atij që është duke e humbur. Mos ia lini të mallkuarit. Të gjithë kemi nevojë për përkrahje.

Lutuni për njerëzit e diskriminuar, për popujt e robëruar, për vendet e varfëruara, për familjet e plagosura. Për dëshmorët e lirisë. Lutuni për lirinë e të



gjithëve, sepse Zoti i krijoi të lirë.

E, Festa e Madhe e Bajramit është përkrahja më e madhe dhe drita e fuqishme e rrugëve të ardhmërisë së njerëzisë. /1.05.2022/

**(Autori është Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut)**

## URIME ME RASTIN E FITËR-BAJRAMIT

Me rastin e festës së madhe islame të Fitër-Bajramit, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ka pranuar një numër të madh telegramesh dhe urimesh nga personalitete të shquara si nga vendi, ashtu dhe nga shtetet fqinje e më gjerë.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka marrë urim nga Presidenti i RMV z. Stevo Pendarovski, nga Kryetari i Kuvendit z. Talat Xhaferi, nga Drejtori i Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare z. Darijan Sotirovski, nga Kryetari i Bashkësisë Islame të Turqisë (Diyanet) z. Ali Erbash, nga Arabia Saudite, nga Bashkësia Islame e Kosovës, nga Kryetari i Bashkësisë Islame të Sllovenisë mr. Nevzet Poriq, nga Bashkësia Islame e Bullgarisë, nga Liga Botërore Myslimane (Muslim World League), nga Bashkësia Islame e Serbisë etj. (1.05.2022)

dit z. Talat Xhaferi, nga Drejtori i Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare z. Darijan Sotirovski, nga Kryetari i Bashkësisë Islame të Turqisë (Diyanet) z. Ali Erbash, nga Arabia Saudite, nga Bashkësia Islame e Kosovës, nga Kryetari i Bashkësisë Islame të Sllovenisë mr. Nevzet Poriq, nga Bashkësia Islame e Bullgarisë, nga Liga Botërore Myslimane (Muslim World League), nga Bashkësia Islame e Serbisë etj. (1.05.2022)

## NJOFTIM PËR HAXHIN 1443/2022

Në bazë të Informatës së Ministrisë së Haxhit dhe të Umres të Mbretërisë së Arabisë Saudite lidhur me Haxhin 1443 H/2022, Shërbimi për Informim i BFI të RMV më 11 prill, 2022, njoftoi opinionin e vendit me sa vijon:

1. Haxhi i këtij viti përfshin grupmoshat deri në 65 vjeç, me kusht që të jenë të vaksinuar me dy vaksina kundër Covid-19, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

2. Haxhilerët prej jashtë Mbretërisë së Arabisë Saudite duhet të kenë edhe PCR-test negativ për Covid-19, i cili

duhet të mos jetë më i vjetër se 72 orë para hyrjes në Mbretërinë e Arabisë Saudite, thuhet në njoftimin e BFI të RMV.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (KMSH), ndërkaq, më 20 prill, 2022, ka njoftuar se mbi bazë të shkresës së Ministrisë së Haxhit dhe të Umres të Mbretërisë së Arabisë Saudite, këtë vit do të mund të kryejnë haxhin të gjithë besimtarët të cilët fillimisht duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme:

1. Mosha maksimale e lejuar është 65 vjeç.

2. Të interesuarit duhet të jenë të vaksinuar (me dy doza) kundër Covid-19, që janë të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë e Arabisë Saudite.

3. Testi PCR negativ, i bërë brenda 72 orëve para hyrjes në Mbretërinë e Arabisë Saudite, thuhet në njoftimin e KMSH.

Sipas kalendarit (takvim) paraprak, nisja për në Haxh në vitin 2022 do të jetë në datat 1-2 korrik, ndërsa kthimi në datat 22-23 korrik, ose sipas njoftimeve të përditësuara. Dita e parë e Kurban-Bajramit është më 9 korrik, 2022.

Ligjërues: hfz. Shaqir ef. Fetahu  
Moderator: Musanif Rufati  
Tema: Muaji i Ramazanit  
(1.04.2022)

**Ligjërues: Irsal Jakupi, Sekretar i Përgjithshëm i BFI**

**Tema: Vlera dhe rëndësia e muajit të Ramazanit**  
**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(2.04.2022)

TVM2, emisioni OPEN  
Intervistë e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu  
Moderatore: Zërijeta Hajro Jahjaga  
(2.04.2022)

**Ligjërues: prof. dr. Qani Nesimi**  
**Tema: Një dimension i hollë i imanit mbi vetëdijen e besimtarit**

**Moderator: Musanif Rufati**  
(3.04.2022)

Radio-Shkupi  
Intervistë e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu  
Moderatore: Valbona Zunçe  
(4.04.2022)

**Ligjërues: dr. Bejadin Ameti**  
**Tema: Begatitë e agjërimit**

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(4.04.2022)

Ligjërues: Ekrem Hasani  
Tema: Solidariteti si cilësi e besimtarit të devotshëm  
Moderator: Musanif Rufati  
(5.04.2022)

**Ligjërues: Daut Alili**  
**Tema: Agjërimi në shëriatin islam**

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(6.04.2022)

Ligjërues: dr. Selver Xhemali  
Tema: Objektivat dhe synimet e agjërimit  
Moderator: Musanif Rufati  
(7.04.2022)

**Ligjërues: mr. Lutfi Nexhipi**  
**Tema: Medreseja Isa Beu**  
**Moderator: Rexhep Ziberi**

(8.04.2022)

Ligjërues: dr. Ziber Lata  
Tema: Koncepti i gjynahut dhe i sevapit  
Moderator: Musanif Rufati  
(9.04.2022)

**Ligjërues: Kadrija Muriç**  
**Tema: Gabimi në Islam; pasojat nga gabimet**

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(10.04.2022)

Ligjërues: mr. Eljesa Asani  
Tema: Profetët në rrugëtimin tonë personal; shembulli i grave  
Moderator: Musanif Rufati  
(11.04.2022)

**Ligjërues: mr. Eljesa Asani**  
**Tema: Kishikselësimi dhe përgjegjësitë e kishikselësimin nën emrin**

**Moderator: Musanif Rufati**  
(11.04.2022)

Ligjërues: hfz. Irfan Abazi  
Tema: Kurani, reformator i çdo periudhe dhe gjenerate  
Moderator: Rexhep Ziberi  
(12.04.2022)

**Ligjërues: Amit Rasimi**  
**Tema: Cilësitë e robit të Allahut**

**Moderator: Musanif Rufati**  
(13.04.2022)

Ligjërues: mr. Lutfi Nexhipi  
Tema: Medreseja "Isa Beu"

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(14.04.2022)

**Ligjërues: prof. dr. Naser Ramadani**  
**Tema: Njeriu në këndvështrimin islam**

**Moderator: Musanif Rufati**  
(15.04.2022)

Ligjërues: mr. Qamil Rushiti  
Tema: Ballafaqimi me sprovat

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(16.04.2022)

**Ligjërues: hfz. Amir Asllani**  
**Tema: Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja**

**Moderator: Musanif Rufati**  
(17.04.2022)

Ligjërues: prof. Imer Alili  
Tema: Përgjegjësia në Islam  
Moderator: Rexhep Ziberi  
(18.04.2022)

**Tribunë fetare në Dibër**  
**Dita e Bedrit**

**(19.04.2022)**

Ligjërues: mr. Salim Sulejmani  
Tema: Besimtarit është optimist  
Moderator: Musanif Rufati  
(20.04.2022)

**Ligjërues: prof. Jusuf Zimeri**  
**Tema: Zeqati dhe dispozitat e tij**

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(21.04.2022)

Tryezë shkencore  
Tema: Zeqati, vlerë islame në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare  
(22.04.2022)

**Ligjërues: prof. Jusuf Zimeri**  
**Tema: Sadakatu-l-fitri**

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(23.04.2022)

Ligjërues: Abdusabur ef. Hasani  
Tema: Shpresa dhe lakmia

**Moderator: Musanif Rufati**  
(24.04.2022)

**Ligjërues: prof. Jusuf Zimeri**  
**Tema: Zeqati dhe dispozitat e tij**

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(25.04.2022)

Ligjërues: Muhamedxhemil Hoxha  
Tema: Vlera e njeriut në krahasim me krijesat tjera  
Moderator: Musanif Rufati  
(26.04.2022)

**Ligjërues: dr. Qenan Ismaili**  
**Tema: Nata e Kadrit**

**Moderator: Rexhep Ziberi**  
(27.04.2022)

## ZËRI I MEDRESESË, RAMAZANI 2022

Ligjëruese: nxënëse Altuna Dalipi  
Tema: Agjërimi, dritë e dijes dhe e edukimit  
(2.04.2022)

**Ligjërues: nxënëse Jusuf Asani**  
**Tema: Muaji i Ramazanit**

**(3.04.2022)**

Ligjërues: nxënëse Naim Fazliu  
Tema: Etika e agjërimit

**(4.04.2022)**

**Ligjërues: nxënëse Ismail Recep**  
**Tema: Ramazan ve Oruç**

**(5.04.2022)**

Ligjëruese: nxënëse Rumejsa Ismani  
Tema: Objektivat e agjërimit

**(6.04.2022)**

**Ligjërues: nxënëse Admir Jusufi**  
**Tema: Ramazani, mundësi për pajtim dhe falje**

**(7.04.2022)**

Ligjëruese: nxënëse Nejla Veseli  
Tema: Duaja dhe mrekullia e saj

**(8.04.2022)**

**Ligjëruese: nxënëse Ezana Osmani**  
**Tema: Përballja e besimtarit me sprovat**

**(9.04.2022)**

Ligjërues: nxënëse Ahmed Rexhepi  
Tema: Agjërimi, mundësi për të përkapur ihsanin

**(10.04.2022)**

**Ligjërues: nxënëse Amar Murati**  
**Tema: Vlera e Kuranit në Ramazan**

**(11.04.2022)**

Ligjëruese: nxënëse Semra Musliu  
Tema: Rëndësia e familjes në Islam

**(12.04.2022)**

**Ligjërues: nxënëse Shuajb Nexhipi**  
**Tema: Lufta e Bedrit**

**(18.04.2022)**

Kori i Medresesë:  
Kolazh

**(19.04.2022)**

**Ligjëruese: nxënëse Enisa Bilalli**  
**Tema: Respektimi i prindërve**

**(20.04.2022)**



Tryeza shkencore:  
Zeqati, vlerë islame në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e jetës fetare  
(20.04.2022)

**Ligjërues: nxënëse Ismail Ismaili**  
**Tema: Çlirimi i Mekës**

**(21.04.2022)**

# JEPNI PËR MEDRESENË!

Më 17 prill, 2022, Medreseja Isa Beu (Shkup) publikoi një thirrje në të cilën thuhet:

“Ne u bëjmë thirrje të gjithë pjesëtarëve të fesë islame që Zeqatin ta japin

dhe ta destinonjë për qëllimet arsimore të Medresesë Isa Beu, sepse me këtë akt jemi të bindur se do ta ndihmojnë jo vetëm nxënësin, profesorin, pedagogun që punon në Medrese, por me këtë ve-

prim do t’ia hapin dhe do t’ia zgjerojnë rrugën Islamit të vërtetë e të gjithëdoshëm për ne dhe për gjeneratat që vijnë pas nesh.”

## AFËR XHEMATEVE ÇDO DITË RAMAZANI

Aktivitetet e Medresesë Isa Beu - Paralelja e Vajzave në Tetovë nuk kanë munguar gjatë gjithë muajit të bekuar të Ramazanit: vajzat kanë qenë afër xhemateve të qytetit me rrethinë pothuajse çdo ditë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Grupet e nxënësve, të udhëhequra nga profesoret e tyre, vizituan edhe këto xhami: në Xhaminë e Vjetër të fshatit Bogovinë ishte një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Barije Shabani;

në xhaminë e fshatit Strimnicë, një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Imrane A. Shaqiri;

në Xhaminë e Re të fshatit Kamjan dhe në xhaminë e fshatit Pirok, një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Sadete

Luta; në Xhaminë e Dardanisë në Tetovë dhe në xhaminë e fshatit Sllatinë, një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Zejnepe Adili; në xhaminë e fshatit Çellopek i Ri dhe në Xhaminë e Rinisë në Tetovë, një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Sabija Abdurahmani; në xhaminë e fshatit Shipkovicë, një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Abide E. Memeti.

Edhe Paralelja e Vajzave në Gostivar ka vazhduar me aktivitetet e veta gjatë muajit të bekuar në xhamitë e qytetit të Gostivarit dhe në xhamitë e fshatrave Gradec, Senokos, Negotinë, Dobërdoll, Toplicë, Debresh, Forinë dhe Çegran, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, shpërndarë edhe nga BFI. (23/24.04.2022)

## TE “NËNA SHQIPTARE” NË ZAJAZ

SHMI “Medreseja Isa Beu” - Paralelja e Shtrirë në Gostivar me aktivitetet në këtë qytet dhe në Kërçovë: programi ka vazhduar në xhamitë e fshatrave Çajlë, Çegran, Forinë, Balindoll, Negotinë, në Xhaminë e Lajthisë të qytetit, thuhet në njoftimin e BFI.

Një grup nxënësesh, të udhëhequra nga prof. Ramije Asani, prof. Azra Selimi

Sheapi dhe prof. Sherije Xhaferri, qëndruan në vizitë në territorin e Myftinisë së Kërçovës.

Grupi i nxënësve u mirëprit nga administrata e Myftinisë dhe fillimisht vizitoi xhaminë "Sulltan Bejazit" në qendër të qytetit, ku u njoftuan me historikun e Xhamisë nga imami Imer ef. Jusufi. Më pas u vazhdua në Xhaminë Katër Kalifët

dhe në xhaminë e komunës së Pllasnicës.

Pas vizitave xhamive, bashkë me profesoreshat, nxënëset vizituan qendrën përkujtimore "Nëna Shqiptare" në Zajaz, ku u njohën me këtë pikë historike-reative, për të kuptuar vlerën e nënës dhe sakrificat e saj, thuhet në njoftimin e BFI. (18.04.2022)

## LIGJËRATA NË DIZHON DHE SHUTKË

Medreseja Isa Beu - Paralelja e Vajzave në Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit, organizoi një ligjëratë për gjininë femërore në Xhaminë e Dizhonit (Shkup), thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Programi filloi me një ashere nga nxënësja Isra Memedi. Udhëheqjen e programit e bëri nxënësja Hasna Ismaili. Nxënësja Hafsa Ajrullai bëri praktikën, me paraqitjen me titull “Mirësitë e Ramazanit”. Fjalën e rastit e mbajti prof. hfz. Nehal Ibrahim me temë: “Bëni mirë, që të shpëtoni”. Fjalë përshëndetëse pati përfaqësuesja pranë Myftinisë, Mubera Asani.

Një program u mbajt edhe në xhaminë „Haxhi Azem” të Shutkës (Shuto-Orizare), ku ashere lexoi nxënësja Nejla Rushiti, ndërsa praktikën e bënë nxënëset Sadije Ramani me temë “Pendimi” dhe Xhemile Rushiti me temë “Mbulesa”. Fjalën e rastit e mbajti prof. Hyrijete Gajni Kadri me temë “Lufta e Bedrit”.

Programi ishte pasuruar edhe me ilahi dhe poezi nga grupi i nxënësve, ndërsa me fjalë përshëndetëse u paraqit përfaqësuesja pranë Myftinisë, Arife Iseni. Pjesë nga Mevludi u këndua nga mualimja Arife Iseni, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu. (18.04.2022)

# PRAKTIKA SHQIP DHE MAQEDONISHT

Medreseja Isa Beu - Paralelja e Vajzave në Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit, organizoi ligjëratë për gjininë femërore në xhaminë e fshatit Gllumovë, ku programi filloi me një ashere nga nxënësja Hirgyl Hirda dhe me ilahi nga vetë nxënëset e shkollës, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Prezantimin e bëri nxënësja Amra Ismaili. Praktikën e bënë nxënëset Ajshe Memedi dhe Nejla Ramadani. Fjalë rasti

pati prof. Hyrijete Gajni-Kadri me temë “Shfrytëzimi i kohës në 10 netët e fundit”. Nga Myftinia e Shkupit, Departamenti i Gruas, fjalë përshëndetëse paraqiti Kryetarja Gjuhëre Ramani. Me fjalë falënderimi doli mualimja e Xhamisë, hfz. Nehale Osmani.

Program u mbajt edhe në Xhaminë Mehmed Efendi Sadik në Vizbeg dhe ai u çel me ashere kënduar nga nxënëset. Praktikën e bënë nxënësja Halime Bale në

gjuhën maqedonase me temë “Nata e Kadrit dhe vlera e saj” dhe nxënësja Fatime Ademi në gjuhën shqipe me temë “Kurani në këtë muaj të shenjtë”.

Fjalë rasti pati edhe nga prof. hfz. Arzije Muharremi me temë “Veprat që e rëmbajnë shpërblimin e agjëruesit”. Fjalën përshëndetëse e paraqiti përfaqësuesja e Myftinisë së Shkupit, Arife Iseni. Programi u mbyll me dua nga mualimja e kësaj xhamie, hfz. Semra Hasani. (24.04.2022)

## MIB GOSTIVAR, NË STRUGË

Medresante të Medresesë Isa Beu - Paralelja e Shtrirë e Vajzave në Gostivar qëndruan më 11 prill, 2022, në mesin e xhematit të Strugës, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Xhamia ku u realizua programi i pasur me ligjëratë, ashere, ilahije dhe recitime ishte xhamia qendrore “Mustafa Çelebiu”. Më pas programi vazhdoi edhe në xhaminë e fshatit Labunisht.

Falënderojmë të gjithë ata që na e mundësuan realizimin e

këtij programi, si dhe xhematin për mikpritjen, veçanërisht aktivitetet e Sektorit të Femrës Myslimane të Myftinisë së Strugës, në krye me Koordinatorën Azemije Sulejmani, bashkë me aktivitetet.

Kjo ditë u zbulua edhe me iftarin e përbashkët, të cilin na e ofroi Myftinia e Strugës.

I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që t’i shpërblejë me të mira të gjithë kontribuesit, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

## PRAKTIKA NË MË SHUMË XHAMI TË TETOVËS

Ka vazhduar kryerja e praktikës nga nxënëset e SHMI Medreseja Isa Beu – Paralelja e Shtrirë në Tetovë gjatë muajit të Ramazanit, thuhet në njoftimin e BFI.

Aktivitetet janë zhvilluar në bashkëpunim me Myftininë e Tetovës. Në ditë të ndryshme nxënëset para xhemateve janë prezantuar me programe të përgatitura, si: pjesë nga Kurani Famëllartë, ligjëratë, recitime, ilahi dhe lutje.

Xhamitë që u vizituan: Xhamia e Vjetër e fshatit Kamjan dhe xhamia e fshatit Logre (Rogle), me grupe nxënësesh të udhëhequra nga prof. Imrane A. Shaqiri; xhamia në fshatin Çellopek i Vjetër dhe xhamia në fshatin Nerasht, me grupet e nxënësve të udhëhequra nga prof. Abide E. Memeti;

xhamia e Çarshisë së Vjetër - Tetovë, me një grup nxënësesh të udhëhequra nga

prof. Zejnepe Adili; xhamia e fshatit Selcë, me një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Barije Shabani;

xhamia e fshatit Xhermë, me një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Sabija Abduramani;

Xhamia e Larme - Tetovë, me një grup nxënësesh të udhëhequra nga prof. Halime I. Shasivari, thuhet në njoftimin e BFI. (20.04.2022)

## VAJZAT ME AKTIVITET NË KOJNARE TË MESME

SHMI Medreseja Isa Beu, Paralelja e Vajzave - Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit organizuan ligjëratë për gjininë femërore në Xhaminë e Kojnare së Mesme, rrethina e Shkupit, thuhet në njoftimin e BFI.

Programi filloi me një ashere nga Mubera Kadriu dhe me ilahi nga grupi i Korit të Medresesë. Hyrjen e bëri nxënësja Amra Ismaili, praktikën e bëri nxënësja Halime Bale me temë: “Ramazani dhe Leljetul-Kadri”.

Fjalën përshëndetëse e pati Kryetarja e Departamentit të Gruas pranë Myftinisë, Gjuhëre Ramani. Fjalën e rastit e mbajti prof. Hyrijete Gajni Kadri me temë “Vlera e leximit të Kuranit”. Gjithashtu, mualimja Anife Musliovska ligjëroi në gjuhën boshnjake. Fjalë falënderimi pati nga mualimja e Xhamisë, Ajla Xhemali, ndërsa duanë e bëri teologe Gjuhëre Ramani, thuhet në njoftimin e BFI. (18.04.2022)

# PREZANTIME NË KONDOVË, RASHÇE DHE LLOKË

Medreseja Isa Beu - Paralelja e Vajzave në Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit, organizoi ligjëratë për gjininë femërore në Xhaminë Hixhrij të fshatit Kondovë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Programi filloi me një ashere nga nxënësja hفز. Azra Demiri, ndërsa ilahitë u kënduan dhe recitimet u bënë nga vetë nxënëset e shkollës. Prezantimin e bëri nxënësja Zehra Sherifi.

Praktikën e kreu nxënësja Zylfije Kadriu më temë "Namazi i natës dhe nafila".

Fjalën e rastit në Kondovë e mbajti prof. Naxhije Bakiu. "Ramazani, muaji i

bujarisë", titullohej tema e saj. Me fjalë përshëndetëse, ndërkaq, u paraqit përfaqësuesja e Myftinisë së Shkupit Mybera Asani.

Program u mbajt edhe në xhaminë e fshatit Rashçe, ku asheren e këndoi nxënësja Ajshe Memedi. Prezantimin e bëri nxënësja Emine Kovaçi. Në praktikë aty ishte nxënësja Hafsa Pajaziti, e cila foli për vlerën e Natës së Kadrit.

Me fjalë përshëndetëse para të pranishmeve doli mualimja e kësaj xhamie, Qëndresa Bakiu.

Fjala e rastit ishte e prof. Munevere Dauti dhe ajo titullohej "Përmirësimi i vetes në muajin e Ramazanit". Nga Myf-

tinia e Shkupit përshëndeti Arife Iseni.

Vazhdoi programi edhe në xhaminë e fshatit Llokë, me ashere nga nxënësja Hasna Ismaili. Prezantimin e bëri nxënësja Hansa Demiri, ndërsa praktikën nxënësja Dilaj Imeri. Tema e saj titullohej "Sinqeriteti".

Me fjalë rasti u paraqit prof. hفز. Nehal Ibrahimimi. Tema: "Shtatë gjërat e mira pasi të vijmë gjërat e vështira". Nga Departamenti i Gruas i Myftinisë së Shkupit përshëndeti Kryetarja Gjuhëre Ramani. Programi përfundoi me një dua nga hفز. Nehal Ibrahimimi, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, shpërndarë nga BFI. (22.04.2022)

# MEDRESANTET E SHKUPIT NË KUMANOVË DHE LIKOVË

SHMI "Medreseja Isa Beu" - Paralelja e Shtirirë e Vajzave në Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Kumanovës edhe këtë vit organizoi ligjëratë për gjininë femërore në xhamitë e Kumanovës dhe të Likovës, thuhet në njoftimin e BFI. Në çdo xhami që është vizituar janë

pritur nga mualimet e xhamive. Nxënëset kanë pasur mundësi të realizojnë praktikën e tyre të Ramazanit. Ky grup i medresanteve, i përbërë kryesisht nga Kumanova dhe Likova, udhëhoqej nga profesore hفز. Xhejlane Nexhipi, e cila ka mbajtur edhe ligjëratë me tema rreth Ra-

mazanit dhe mirësitë e tij. Nxënëset e Medresesë Isa Beu këto programe i zbuluan me këndimin e pjesëve nga Kurani Famëllartë dhe këndimi i disa ilahive, ndërsa pati dhe recitime, thuhet në njoftimin e BFI, përkatësisht të Medresesë Isa Beu.

## TEMA RAMAZANI NË 7 XHAMI

Shkolla e mesme islame "Medreseja Isa Beu" - Paralelja e Vajzave në Tetovë, në bashkëpunim me Myftininë e Tetovës, i vazhdoi aktivitetet e veta, duke vizituar gati të gjitha xhamitë e qytetit dhe rrethinës me grupet e nxënësve të udhëhequra nga profesoret e tyre, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Në xhaminë e fshatit Llërcë grupi i nxënësve u udhëhoq nga prof. Barije Shabani. Prof. Abide E. Memeti udhëhoqi grupet e nxënësve në xhaminë e fshatit Reçicë e Madhe dhe në Xhaminë Muaremçe të qytetit të Tetovës. Në xhaminë e Ja-

zhincës, ndërkaq, nxënëset i udhëhoqi prof. Sadete Luta. Në xhaminë e fshatit Dobrosht, me një grup nxënësesh, ishte prof. Sabija Abduramani. Në fshatrat Odri dhe Grupçin nxënëset janë udhëhequr nga prof. Imrane A. Shaqiri. Në xhaminë e fshatit Dëbërcë nxënësve u priu prof. Zejnepe Adili, ndërsa në xhaminë e fshatit Rakovec ishte prof. Halime I. Shasivari dhe grupi i nxënësve, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, shpërndarë nga BFI. (22.04.2022)

## XHAMIA E KOPANICËS HAP DYERT PËR VAJZAT

SHMI „Medreseja Isa Beu“ - Paralelja e Vajzave në Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit, organizoi një ligjëratë për gjininë femërore në Xhaminë e Kopanicës, thuhet në njoftimin e BFI.

Programi filloi me një ashere nga nxënësja Efrahi Ibrahimimi dhe me ilahi nga vetë nxënëset e shkollës. Fjalë përshëndetëse paraqiti mualimja e Xhamisë, Qëndresa Bakiu. Udhëheqjen e programit e bëri nxënësja Jasemin Ibrahimimi.

Në këtë tubim praktikën shkollërore e bënë nxënëset: Fatime

Ademi, më temë "Kurani në mesin tonë" dhe Mirvet Kurtishi, më temë "Ramazani në mesin tonë".

Fjalën e rastit e mbajti prof. hفز. Arzije Muharemi Nuhiu më temë "Bindja ndaj Allahut (xh. sh.) në muajin e Ramazanit". Fjalë përshëndetëse pati Kryetarja e Departamentit pranë Myftinisë, Gjuhëre Ramani. Në fund, duanë e bëri hفز. Arzije Muharemi Nuhiju, thuhet në njoftimin e BFI.

(20.04.2022)

## AKTIVITETE TË MYFTINISË SË KUMANOVËS

Më shumë aktivitete gjatë muajit të bekuar të Ramazanit ka shënuar Myftinia e Kumanovës, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Kumanovë.

Mualimet, nxënëset e Institutit të Hifzit në Shkup dhe të Kursit të Kuranit të Myftinisë së Kumanovës, në bashkëpunim me nxënëset e SHMI Medreseja Isa Beu, në krye me profesoren Xhejlane Nexhipi, më 16 prill, 2022, në Amfiteatrin e Myftinisë mbajtën një tribunë për femra.

Programi filloi me lexim të Kuranit nga mualimja e Hifzit dhe e Kursit të Kuranit hفز. Ajnure Ademi. Fjalën përshëndetëse e mbajti mualimja e Kursit të Kuranit Mubera Imeri, kurse fjalën e rastit në këtë program kushtuar gjinisë femërore e mbajti hفز. Xhejlane Nexhipi, profesore në Medresenë Isa Beu në Shkup.

Vlen të theksohet se kjo tribunë, e cila u organizua për herë të parë enkas për gji-

ninë femërore në Myftininë e Kumanovës, pati jehonë të madhe dhe u prit mirë nga pjesëmarrëset e shumta.

Programin e pasuruan në mënyrën e tyre nxënëset e Medresesë Isa Beu, nxënëset e Institutit të Hifzit dhe të Kursit të Kuranit të Myftinisë së Kumanovës. Ato u paraqitën me lexime të disa pjesëve nga Kurani Famëllartë, me recitime dhe ilahi jashtëzakonisht të bukura, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

## MBRËMJE KURANORE NË HASANBEG

Në kuadër të aktiviteteve të muajit Ramazan, më 24 prill, 2022, 23 Ramazan 1443 H, realizuam Mbrëmjen Kurano-re në Xhaminë e Dëshmorëve në Hasanbeg, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Programi u realizua në koordinim me Institutin e Hifzit "Hafëz Ismail Efendiu" në Shkup. Atë e begatuan hafëzllarët që me zërin e tyre të bukur u sollën freskinë shpirtërore të pranishmëve me leximin e

Fjalës së Allahut, Kurani famëllartë: hفز. Armend Beqiri nga Ferizaji (Kosovë), hفز. Fatih Derdiyok nga Ankaraja (Turqi) dhe hفز. Xhemal ef. Nuhiju nga Shkupi, përgjegjës i Institutit të Hifzit "Hafëz Ismail Efendiu".

Shpreh mirënjohje dhe falënderim në emrin tim personal dhe të Myftinisë së Shkupit, thuhet në njoftim, për hafëzllarët që pranuan ftesën që të jenë pjesë e programit tonë, të cilët na nderuan neve

dhe xhematin e Hasanbegut. Allahu i nderoft!

E ndej për obligim që të falënderoj edhe hatibin e Xhamisë, hafëz ef. Izairin, Këshillin e Xhamisë dhe xhematin e pranishëm për mikpritjen e tyre të përzmërt. Allah, bëje Kurani pranverë të zemrave tona dhe zbuluroji zemrat dhe shtëpitë tona me Kurani! - thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit.

## LIGJËRATA NË XHAMINË E DYQANXHUKUT

SHMI Medreseja Isa Beu, Paralelja e Vajzave në Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit organizuan ligjëratë për gjininë femërore në Xhaminë e Dyqanxhikut (Shkup), thuhet në njoftimin e BFI.

Moderatore e programit ishte nxënësja Tuba Rexhepi. Programi filloi me lexim të Kuranit dhe me ilahi, të interpretuara nga nxënëset e Medresesë.

Programi u çel me fjalimin përshëndetës nga përfaqësuesja

e Myftinisë së Shkupit, Mubera J. Asani.

Fjala e rastit në këtë program i takoi hفز. Selvije Dardhishta Shaqiri, profesore në Medresenë Isa Beu, e cila ligjëroi në temën "Frika ndaj Allahut (xh. sh.)".

Nxënësja e Medresesë, Mevlude Aliovska, mbajti ligjëratë, me të cilën realizoi praktikën e Ramazanit.

Në fund të programit duanë e rastit e bëri mualimja Fevzije Dardhishta Emruli. (18.04.2022)

# NË NEREZ, NË ARNAQI TË EPËRME...

Paralelja e Vajzave në Shkup (Medreseja Isa Beu), në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit, organizoi ligjëratë për gjininë femërore në Xhaminë e Nerezit, thuhet në njoftimin e Medresesë së Shkupit.

Programi filloi me një ashere nga nxënësja Fatime Tahiri. Nxënësët e shkollës kënduan ilahi në gjuhën shqipe, ndërsa me ilahi dhe poezi në gjuhën turke u paraqit nxënësja Sedamerva Baki.

Udhëheqjen e programit e bëri nxënësja Sara Tahiri. Praktika ishte e nxën-

ses Rumejsa Ismani, e cila referoi më temë "Realiteti i kësaj bote dhe vlera e botës tjetër (e Xhenetit)". Administratorja e Medresesë Isa Beu në Shkup, prof. Nurtene Shehu-Saqipi foli më temë "Punët e mira ta shtojnë besimin (imantin)". Nga Myftinia e Shkupit fjalën përshëndetëse e pati Arife Iseni. Fjala e falënderimit i takoi mualimes së Xhamisë, Semra Kurtishi.

Gjithashtu, Paralelja e Vajzave në Shkup organizoi ligjëratë për gjininë fe-

mërore edhe në Xhaminë e Arnaqisë së Epërme, ku programi filloi me një ashere dhe me ilahi nga vetë nxënësët e shkollës. Udhëheqja ishte e nxënësës Belkisa Alili. Nxënësja Anesa Ramadani aty kreu praktikën më temë "Mëshira".

Në Arnaqinë e Poshtme fjalën e rastit e mbajti prof. hfz. Munevera Lutfiu – Murtezi, tema e së cilës titullohej "Durimi". Me fjalë përshëndetëse doli përfaqësuesja e Myftinisë së Shkupit Mubera Jashari-Asani. (22.04.2022)

## NË "NUR" DHE "IKRE"

Paralelja e Vajzave në Shkup në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit organizoi ligjëratë për gjininë femërore në xhaminë „Nur” të fshatit Bukoviç, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Çelja e programit u bë me një ashere nga nxënësja Fatime Tahiri. Ilahi u kënduan nga vetë nxënësët e shkollës, ndërsa recitimet u bënë nga nxënësja Sedamerva Bakiu. Prezantimin e bëri nxënësja Sara Tahiri. Praktikën e bëri nxënësja Suela Abdullahu më temë "Zeqati e pastron pasurinë".

Fjalë rasti mbajti Administratorja e Shkollës, prof. Nurtene Shehu - Saqipi më temë "Mësojuani të mirën njerëzve". Nga Myftinia e Shkupit fjalën përshëndetëse e paraqiti përfaqësuesja Mybera Asani. Programi mbaroi me duanë nga

prof. Nurtene Shehu - Saqipi.

Program u mbajt edhe në xhaminë „Ikre” të Sarajit, ku ashere këndoi nxënësja Jasemin Ibrahim. Praktikën e bëri nxënësja Nuran Ramadani më temë "Vlera e duasë". Prof. Busejra Idrizi mbajti ligjëratën më temë "Vlera e 10 ditëshit të fundit" (të Ramazanit). Fjalë rasti pati edhe prof. Arzije Muharremi, e cila foli më temë "Kurani, pastrim i shpirtit tonë".

Nga Myftinia e Shkupit, Departamenti i Gruas, me fjalë përshëndetëse u paraqit Kryetarja Gjuhere Ramani, e cila e bëri edhe duanë e manifestimit në xhaminë "Ikre" të Sarajit, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu, shpërndarë nga BFI. (22.04.2022)

## PRAKTIKA NË PESË GRUPE NË TETOVË

SHMI "Medreseja Isa Beu" - Paralelja e Vajzave në Tetovë filloi praktikën e Ramazanit në bashkëpunim me Myftininë e Tetovës. Kështu, nxënësët do të jenë afër besimtarëve nëpër xhami të qytetit të Tetovës, si dhe të fshatrave përreth. Para të pranishmëve ato paraqiten me pjesë nga Kurani famëlartë, me ilahije, poezi, ligjëratë, lutje, si dhe, krejt në

fund, me fjalët përshëndetëse të profesoreve të Medresesë, thuhet në njoftim.

Grupi i parë i vajzave vizitoi Xhaminë e fshatit Miletinë, të udhëhequra nga prof. Barije Shabani. Grupi i dytë, Xhaminë në fshatin Zherovjan, të udhëhequra nga prof. Halime I. Shasivari. Grupi i tretë ishte në Reçicë të Madhe, në Xhaminë e Madhe. Udhëheqjen e grupit

të nxënësëve e kishte prof. Sabija Abduramani. Grupi i katërt i vajzave, ishte në Xhaminë Eski në Tetovë. Grupi udhëhoqej nga prof. Abide E. Memeti. Nxënësët e grupit të pestë ishin në Xhaminë e lagjes Drenovec, në udhëheqje të prof. Sadete Lutës, thuhet në njoftimin e MIB, shpërndarë nga BFI. (10.04.2022)

## GRATË E SHKUPIT MBLIDHEN NË DITËN E BEDRIT

Myftinia e Shkupit më 18 prill, 2022, 17 Ramazan 1443 H, për nder të Ditës së Bedrit, organizoi program fetar dhe iftar për Departamentin e Gruas, mualimet që veprojnë nëpër xhamitë tona, profesoret dhe nxënësët e dy vatrave arsimore: Fakulteti i Shkencave Islame dhe Medreseja Isa Beu, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit Qenan ef. Ismaili.

Pas iftarit pati një program fetar me ashere të lexuara nga Kurani Famëlartë, me ilahi e fjalime përshëndetëse, nën për-

kujdesjen e Departamentit të Gruas pranë Myftinisë.

Përveç fjalimeve përshëndetëse dhe ligjëratës, ky program u begatua edhe me ilahi të ndryshme të interpretuara nga Kori i Medresesë Isa Beu.

Shpreh mirënjohje dhe falënderim për të gjithë ata që e pranuan ftesën dhe e begatuan sofrën tonë të iftarit, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit Qenan ef. Ismaili.

# VAJZAT ME PROGRAM NË SARAJ DHE NË SHUTKË

Paralelja e Vajzave në mesin e xhematit të Shkupit: SHMI "Medreseja Isa Beu" - Paralelja e Vajzave Shkup, në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit organizuan ligjëratë për gjininë femërore në Xhaminë Husein Shah në Saraj, thuhet në njoftim.

Programi filloi me një asher nga nxënësja Rumejsa Ismani, ilahi nga grupi i korit të Medresesë dhe poezi. Hyrjen e bëri nxënësja Amra Ismaili, praktikën e bëri nxënësja Vildane Ajrullah, fjalën përshëndetëse e pati kryetarja e Departamentit të Gruas pranë Myftinisë, Gjyhere Ramani.

Fjalën e rastit, me temë "Vlera dhe roli i xhamisë", e mbajti prof. Hyriete Gajni Kadri, falënderimi u paraqit nga mualimja e Xhamisë Qefserë Abazi dhe në fund duanë e bëri teologja Hafsa Ramani.

Paralelja e Vajzave në Xhaminë Ebu Bekër Es-Siddiku të Shuto-Orizares. Programi filloi me ashere nga Kurani famëlartë. Më pas, fjalë përshëndetëse pati Arife Asani - anëtare e Departamentit të Gruas pranë Myftinisë së Shkupit.

Fjala e rastit në këtë program kushtuar gjinisë femërore i takoi prof. Naxhije Bakiut, profesoreshë në Medresenë Isa Beu,

e cila përcolli mesazhin e saj mbi rëndësinë e kryerjes së farzeve në Islam, duke shtuar se përpikëria dhe kujdesi ndaj obligimeve parësore fetare është shkak për afrim tek Allahu Fuqplotë.

Nxënësja Elma Tahiri paraqiti temën "Ramazani, muaj i Kuranit". Kori i SHMI "Medreseja Isa Beu" e zbukuroi këtë program me këndimin e pjesëve nga Kurani famëlartë dhe këndimin e disa ilahive, thuhet në njoftimin e MIB, shpërndarë nga BFI. (10.04.2022)

## NË MESIN E XHEMATIT TË SHKUPIT

Paralelja e Shtirirë e Vajzave në Shkup e SHMI "Medreseja Isa Beu" në bashkëpunim me Myftininë e Shkupit organizoi ligjëratë për gjininë femërore në Studenican, në Haraçinë dhe në Hasanbeg, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Programi në xhaminë "Hfz. Xhavit ef. Ibrahim" në Studenican filloi me ashere nga Kurani Famëlartë. Më pas, fjalë përshëndetëse pati Arife Asani, anëtare e Departamentit të Gruas pranë Myftinisë së Shkupit. Fjala e rastit i takoi prof. Busejra Idrizi, profesore në Medresenë Isa Beu. "Ramazani, muaj i Kuranit" – ishte tema që trajtoi nxënësja Sumeja Memedi. Nxënësët e Medresesë Isa Beu e zbukuruan këtë program me këndimin e pjesëve nga Kurani Famëlartë dhe me këndimin e disa ilahive.

Në xhaminë qendrore të Haraçinës fjalën përshëndetëse e paraqiti mualimja Mubera Hasani, ndërsa nxënësët ishin nën udhëheqjen e profesore Selvije Dardhishta Shaqiri, e cila ligjëroi temën "Pendimi". Nxënësja Tuba Rexhepi ligjëroi temën "Sadakaja". Nxënësët e zbukuruan këtë program me këndimin e pjesëve nga Kurani Famëlartë dhe me këndimin e disa ilahive.

Medresantet, të udhëhequra nga Muneve Lutfiu Murtezi, në xhaminë qendrore të Hasanbegut u pritën nga mualimja Mubera Kadriu. Aty programi u zbukurua po ashtu me këndimin e pjesëve nga Kurani Famëlartë dhe me këndimin e disa ilahive, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu. (12.04.2022)

## MANIFESTIMI QENDROR, NË XHAMINË E TABHANES

Manifestimi qendror i muajit të bekuar të Ramazanit u mbajt më 12 prill, 2022, në Xhaminë e Tabhanes në Tetovë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Organizimi i tij u bë nga Paralelja e Shtirirë e Vajzave në Tetovë, në bashkë-

punim me Myftininë e Tetovës.

Programi u realizua në Xhaminë e Tabhanes, me një program mjaft të pasur, ku i pranishëm ishte i gjithë stafi i Medresesë, nxënësët e kësaj shkolle, si dhe xhemati i lagjes e më gjerë.

Kishte pjesë nga Kurani Famëlartë, recitime, ilahi, si dhe ligjëratën më temë "Ramazani dhe Kurani" nga prof. Abide E. Memeti. Në fund, manifestimi u mbyll me një dua nga prof. Imrane A. Shaqiri, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

## NË MË SHUMË XHAMI PËR XHUMA

Më 22 prill, 2022, Myftinia e Tetovës ka vazhduar me vizitat e rregullta nëpër xhamitë e saj për namazin e xhumasë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Më tej në njoftim thuhet: Abdurrahim ef. Murati ishte në xhaminë e fshatit Llacë; mr. Xhemil ef. Memeti në xhaminë e fshatit Sellcë; Hasan ef. Asani në xhaminë e fshatit Novosellë

2; Idriz ef. Idrizi në xhaminë e fshatit Sellcë e Keqe; Abdylqerim ef. Osmani në xhaminë e fshatit Xhermë; hfz. Harun ef. Osmani në Burgun e Tetovës; Taxhudin ef. Hamidi në xhaminë e Kodrës së Diellit dhe Blendi ef. Imeri në xhaminë e fshatit Vicë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

# PROGRAME NGA NXËNËSET NË MË SHUMË XHAMI

Më 14 prill, 2022, grupe nxënësesh nga SHMI Medreseja Isa Beu - Paralelja e Vajzave në Tetovë, të udhëhequra nga profesoret e Medresesë, paraqitën para xhemateve të Tetovës programet e tyre të përgatitura për Ramazan, thuhet në njoftimin e BFI.

Në Xhaminë e Sahatit nxënëset udhëhiqeshin nga prof. Sadete Luta. Në xhaminë e fshatit Shemshovë udhëhiqeshin nga prof. Sabija Abduramani. Në xhaminë e fshatit Trebosh udhëhiqeshin nga prof. Halime I. Shasivari. Në xhaminë e fshatit Siniçan udhëhiqeshin nga prof.

Zejnebe Adili.

Programet ishin të pasura me pjesë nga Kurani Famëllartë, me recitime, me ilahi dhe dua. Pa harruar dhe ligjëratat nga profesoret e grupeve të nxënësve, thuhet në njoftimin e BFI.

## TRIBUNË PËR FEMRA NË KUMANOVË

Në vazhden e aktiviteteve të përbashkëta SHMI Medreseja Isa Beu - Myftinia e Kumanovës, më 16 prill, 2022, në sallën e Myftinisë së Kumanovës u mbajt një tribunë për femra, thuhet në njoftimin e BFI.

Programi filloi me ashere nga mualimja e Kursit të Kuranit pranë Myftinisë së Kumanovës, hfz. Ajnure Ademi. Para të pranishmëve fjalën përshëndetëse e mbajti mualimja e Kursit të Kuranit Mubera Imeri.

Fjala e rastit në këtë program kushtuar gjinisë femërore i takoi prof. hfz. Xhejlane Nexhipi, profesore në SHMI Medreseja Isa Beu, e cila ligjëroi në temën "Roli i femrës në kohën bashkëkohore".

Nxënëset e SHMI Medreseja Isa Beu dhe nxënëset e Kursit të Kuranit të Myftinisë e zbukuruan këtë program me këndimin e pjesëve nga Kurani Famëllartë dhe me këndimin e disa ilahive, ndërsa pati dhe recitime, thuhet në njoftimin e BFI.

## TETOVË: VAJZAT DISKUTOJNË PËR SOLIDARITETIN

Më 11 prill, 2022, Paralelja e Shtrirë e Vajzave në Tetovë, pjesë e SHMI Medreseja Isa Beu, në bashkëpunim me Myftininë e Tetovës organizoi një tribunë për gjininë femërore në Qendrën për Shërbime Fetare dhe Sociale në Tetovë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Tribuna më temë "Solidariteti" u

shtjellua në prizmin fetar nga prof. Barije Shabani dhe në prizmin e përgjithshëm shkencor nga prof. Ulifete Mediu.

Tema ishte mjaft e dobishme, meqenëse solidariteti - qoftë në aspektin material, qoftë në aspektin moral - luan një rol të rëndësishëm në të gjitha shoqëritë pa dallim feje.

I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që të jemi më solidarë me njëri-tjetrin në këtë muaj të bekuar të Ramazanit, por edhe gjatë tërë vitit, në këtë kohë të krizës ekonomike dhe të krizës sociale, kur njerëzit kanë nevojë më shumë se kurrë, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

## VAJZAT BËJNË PRAKTIKËN E RAMAZANIT

Paralelja e Shtrirë e Vajzave në Gostivar, pjesë e SHMI Medreseja Isa Beu, më 5 prill, 2022, realizoi praktikën e Ramazanit, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

Nxënëset, bashkë me profesoret, ishin në Xhaminë e Lajthisë në Gostivar, në xhaminë e fshatit Forinë dhe në xhaminë e fshatit Çegran.

Falënderojmë Allahun (xh. sh.) që na e mundësoi që edhe këtë vit ta përfundojmë realizimin e praktikës së muajit të bekuar të Ramazanit bashkë me nxënëset e Medresesë Isa Beu, Paralelja Gostivar, në krye me profesoret e kësaj vatre arsimore, thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu.

# NJË IFTAR TE KRYEMINISTRI KOVAÇEVSKI

Më 29 prill, 2022, Kryetari BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, iu përgjigjën ftesës së Kryeministrit të RMV z. Dimitar Kovaçevski dhe morën pjesë në iftarin e përgatitur për përfaqësuesit e besimit islam, thuhet në njoftimin e BFI.

Merrnin pjesë Zv/Kryeministra, ministra, rektorë universitetesh, kryetarë partish politike dhe shumë përfaqësues të tjerë.

Në fjalimin para të pranishmëve, Kryeministri foli për qëllimin e këtij iftari dhe tha se ai është shtruar për të respektuar bashkëpunëtorët e tij, duke shtuar se ky iftar i afron njerëzit dhe formon ambient paqeje dhe bashkëjetese.

Në fjalën e tij përshëndetëse Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi Kryeministrin për këtë gjest madhor, me çka tregoi respektin e tij ndaj BFI të RMV dhe pjesëtarëve të besimit islam. Në shenjë respekti, Kreu i BFI i dhuroi



Kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, z. Dimitar Kovaçevski, një kopje nga Kurani Famëllartë, përkthyer në gjuhën maqedonase, si dhe dy ekzemplarë botimesh

mbi kulturën islame. Iftari u shtrua në një ambient të këndshëm, ku u bisedua për shumë çështje, thuhet në njoftimin e BFI.

## RAMA: ISLAMI, NJË DHURATË PA KUSHTE PËR MBARË NJERËZIMIN

Nën kujdesin e Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama dhe të bashkëshortes së tij Linda Rama, është organizuar më 27 prill, 2022, në Tiranë, iftar me pjesëmarrjen e personaliteteve nga fusha të ndryshme, ka njoftuar AA, transmeton "Koha Islame" (<https://kohaislame.com/edi-rama-shtron-iftar>).

Në iftarin e organizuar në Pallatin e Kongreseve në Tiranë ishin të pranishëm ministra, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, ambasadorë, përfshi dhe Ambasadorin e Turqisë në Tiranë Murat Ahmet Yörük, si dhe zyrtarë të institucioneve të ndryshme dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

Në fjalën e tij, Kryeministri Rama tha se Islamin e kanë cilësuar fe e të barabartëve, duke shtuar se kjo tryezë e iftarit "është në vendin e saj, në kohën e saj, në të drejtën e saj të qytetarisë". "Jam i lumtur sot që pas dy vite ndarjesh dhe kufizimesh, pasojë e një sulmi të paprecedent pandemik, rigjendemi rreth tryezës së iftarit. Më ka munguar ky takim, sepse prej vitesh tryeza e iftarit ka lënë tek unë një shije të posaçme njerzillëku, duke ushqyer një ndjesi të mirëseardhur pa-



qeje", u shpreh Rama.

Kryeministri Rama tha se besimi dhe qytetërimi islam, përkundër gjithë dezinformimit sistematik mbështetur sa në thjeshtëzimin vulgar dhe deri vrshtar të fundamentalizmit lindor, aq edhe në falsifikimin propagandistik dhe deri dhe racist të fundamentalizmit perëndimor, "kanë gjalluar përmes një zbulese që lirisë së ndërgjegjes, të sovranitetit dhe të dijes, të zgjedhjes së lirë individuale, i janë bërë kurorë qysh në zanafillë".

"Thelbi i kësaj tryeze është Islami pa dyshim, por nga ana tjetër Islami është përveç se një fe e përqaftuar ethshëm nga

besimtarët myslimanë, edhe një dhuratë pa kushte për mbarë njerëzimin. Një dhuratë që është gjynah ta refuzosh, në mos si një burim besimi te Zoti, si një burim më shumë besimi te njeriu, te vetja, tek ai që jo thjesht duhet, por që mund të jesh", u shpreh Rama.

Rama shtoi më tej se "bukur dhe hijshëm më duket se po veprojmë edhe ne sot tek jemi së bashku rreth tryezës së iftarit, duke kryer një gjest miqësie dhe mirësie", ka njoftuar AA, transmeton "Koha Islame" (<https://kohaislame.com/edi-rama-shtron-iftar>).

# BFI NË IFTARIN TRADICIONAL TË OEMVP

Më 15 prill, 2022, Drejtori i Agjencisë për Standardin Hallall, h. Muhamer ef. Veseli, mori pjesë në iftarin tradicional të shtruar nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore, thuhet në njoftimin e BFI.

Efendi Veseli, përveç si Drejtor i Agjencisë për Standardin Hallall, në këtë iftar mori pjesë edhe si përfaqësues i BFI dhe i Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i ndodhur në udhëtim zyrtar.

Ai u përcolli falënderimet e sinqerta organizatorëve në emër të Reis'ul-Ulemasë së BFI, e veçanërisht Kryetarit të OEMVP z. Nebi Hoxha dhe Drejtorit Ekzekutiv të OEMVP-së z. Drilon Iseni.

Me hyrjen e kohës së iftarit, h. Muhamer ef. Veseli e thirri ezanin e akshamit, ndërsa në përfundim të iftarit e bëri duanë e iftarit si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën maqedonase.

Kryetari i OEMVP, z. Nebi Hoxha, në fjalën e tij në iftarin tradicional tha: "Ky muaj i solidaritetit është rifreskim i kujtesës se qëllimi ynë final është përmirësimi i standardit ekonomik të këtij vendi, gjë që është kulminacioni i kontributit për shoqërinë." Në pamundësi të realizohet



kjo ngjarje në dy vitet e fundit për shkak të pandemisë covid-19, të pranishme ishin figura eminente të politikës, të biznesit dhe të sektorit civil nga vendi dhe rajoni, duke i shtuar kështu peshën edhe

më tepër këtij evenimentit.

Vlen të theksohet se Agjencia për Standardin Hallall është anëtare e OEMVP-së që nga viti 2016, thuhet në njoftimin e BFI.

## REISI NË IFTARIN E "HALK-BANKËS"

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 19 prill, 2022, mori pjesë në iftarin e "Halk-Bank" (Shkup), organizuar nën patronazhin e drejtorit të përgjithshëm Bilal Sucubashi (Bilal Suxhubashë) dhe stafi i tij, thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte një ambient i bukur i një iftari të Ramazanit të bekuar. Me prezencë të personaliteteve të niveleve të larta të sferave

të ndryshme nga vendi dhe Turqia.

Prezent, ndër të tjerët, në këtë iftar ishin edhe z. Talat Xhaferi, Kryetar i Kuvendit të RMV; z. Osman Arslan, drejtor i përgjithshëm i "Halk-Bankës" në Turqi; z. Fatmir Bytyçi, Zv/Kryeministër i Qeverisë së RMV; z. Hasan M. Sekiskok, Ambasador i Turqisë në Shkup; z. Ajdoan Ademoski, Kryetar i MATTO (Dhoma Komerciale Maqedoni-Turqi, Macedonia

Turkey Chamber of Commerce); z. Bejxhan Iljas, Kryetar i TDP (Partia Demokratike Turke) e të tjerë.

U mbajtën fjalime të ndryshme, që dhanë porosi të rëndësishme dhe, më në fund, iftari u përmbyll me një dua nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Ishte një respekt i veçantë, thuhet në njoftimin e BFI.

## NJË RESPEKT I VEÇANTË NGA FAMILJA ARIFI

Një respekt i veçantë nga familja Arifi - vëllezërit haxhi Ridvani dhe z. Ramadani nga Shkupi. Së bashku me shumë të ftuar të tjerë, përjetuam një iftar të këndshëm të Ramazanit, që formoi një ambient të bukur, afrimin e njerëzve, biseda të bukura e konstruktive, ka njoftuar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në pjesëmarrje edhe të Myftiut dr. Qenan ef. Ismaili me bashkëpunëtorë, të Myftiut h. Sabahudin ef. Zendeli me ba-

shkëpunëtorë, të Kryetarit të Kuvendit h. Fejsal Kadriu, të hoxhë Ferit Selimi, të deputetit z. Izet Mexhiti, të Kryetari të Komunës Çair dr. Visar Ganiu, të Sekretarit të Qeverisë Muhamed Zeqiri, të prof. Sadri Hasanoviç, të Sekretarit të Medresesë dhe të funksionarëve të ndryshëm në BFI dhe Myftini, nga ulemaja islame, biznesmenë dhe shumë të tjerë.

Vëllezërit h. Ridvani, Ramadani dhe nipërit vazhdojnë amanetin e rahmetli

haxhi Ganisë - një njeri bujar dhe kontribues i madh i fesë dhe i kombit, që të vazhdohet tradita familjare, për të qenë së bashku dhe për të vazhduar respekti në mes miqve, dashamirëve dhe njerëzve në përgjithësi.

Ishte kënaqësi. Zoti i bekoftë me të mirat e Tij, ka njoftuar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (7.04.2022)

# IFTAR MASIV NË VENDLINDJEN E REISIT



Iftar i mrekullueshëm në vendlindjen time, në Çegran (Gostivar). Pjesëmarrje masive, thuhet në njoftimin e BFI më 25 prill, 2022.

Një natë impozante ia kushtova vendit tim. Pjesëmarrja e imamëve dhe e besimtarëve - vlerë e veçantë. Pjesëmarrja e mysafirëve nga Emiratet e Bashkuara Arabe, z. Abdulla Zer'uni, ishte një atraktivitet i veçantë, i cili disa ditë do të jetë në mesin tonë, në koordinim të z.

Ismet Ademi, Drejtor për Marrëdhënie me Botën Arabe. Pas iftarit prezantuar në Xhaminë e Sahatit në Gostivar, për të cilën pa masë jam falënderues.

Ligjërata e mbajtur në xhami më bëri përshtypje të veçantë, si dhe pritja në koordinim të Imamit h. Ibrahim ef. Abdurahimi me bashkëpunëtorë, që ishte e nivelit të lartë.

Falënderoj të gjithë, në veçanti Bashkësinë Lokale në krye me z. Fadil Bi-

lalli për organizimin e këtij iftari që bashkoi zemrat e të gjithëve.

Në mosprezencë të Myftiut h. Sabahudin Zendeli, i cili është jashtë vendit, programin e udhëhoqi hfz. Jusuf ef. Xheladini, Referent i Myftinisë së Gostivarit.

Faleminderit Çegran dhe çegranas. Zoti ju bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI. Dy postime për këtë ka bërë edhe vetë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Facebook.

## KOMISIONI I LARTË NË MYFTININË E GOSTIVARIT

Një delegacion i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, i udhëhequr nga Kryetari i BFI të RMV h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, myftinjtë e Myftinive të BFI, përfaqësues të SHMI Medreseja Isa Beu, të Fakultetit të Shkencave Islame dhe shumë mysafirë të tjerë, të xhumanë, më 8 prill, 2022, qëndroi në vizitë zyrtare në Myftininë e BFI në Gostivar, ka njoftuar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Kjo vizitë u bë në kuadër të Komisio-

nit të Rijasetit që gjatë muajit të Ramazanit të vizitohet çdo Myftini e BFI. Fjalë rasti mbajti Reis'ul-Ulemaja, kurse Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli u shpreh mirëseardhje të gjithëve.

Iftari ishte i përbashkët me imamë, mualimë, myderrizë, hatibë, myezinë, Këshillat e Xhamive të Gostivarit, ku ishin të gjithë prezent. Gostivari si çdoherë ishte në nivelin e tij organizativ dhe mikpritës, ku drejtpërdrejt këtë gjë e

shprehu vetë Reis'ul-Ulema i BFI të RMV h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Edhe Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli shprehu kënaqësinë e tij të posaçme që sonte e nderojnë Gostivarin me prezencën e tyre, e në veçanti Myftininë tonë, na nderojnë neve dhe të gjithë besimtarët e këtij vendi, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (9.04.2022)

## IFTAR SOLEMN TË FAMILJAS SULEJMANI - GOSTIVAR

Pritje vëllazërore nga kryefamiljari h. Satki Sulejmani dhe i biri i tij Orhani (Gostivar) në një iftar impozant, ku morën pjesë Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, gati të gjithë Myftinjtë e Myftinive, Sekretari i Përgjithshëm i BFI, Shefi i Kabinetit, drejtorët e Sektorëve të BFI, Dekani i FSHI, Drejtori i Medresesë me stafin e tij, referentë dhe shumë mysafirë nga të gjitha vendet, si: haxhi Ruzhdiu nga Vrapçishti, haxhi Etemi nga Saraji, djemtë e rahmetli haxhi Ganiut nga Shkupi - h. Ridvani dhe z. Ramadani, si

dhe mulla Feriti me mysafirë nga Turqia, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 30 prill, 2022.

Myftiu i Gostivarit përshëndeti të pranishmit, si dhe falënderoi kryefamiljarin për këtë organizim të këtij iftari. Në fjalën time përshëndeta të pranishmit për prezencë dhe falënderova Myftinjtë dhe Drejtorët për angazhimin e madh që kanë pasur gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, me qëllim të përjetimit sa më të mirë të këtij muaji, duke e lutur Allahun e Plotfuqishëm që t'i pra-

nojë të gjitha ibadetet tona. Njëherësh, urova edhe Festën e Madhe të Fitër-Bajramit.

Vërtet kemi kaluar një Ramazan të qetë, por me aktivitete të panumërta, gjatë të cilit depertuam në çdo pore të jetës së besimtarëve për të kuptuar vlerën e agjërimit dhe të ibadeteve të tjera. Falënderim për prezencë të gjithë anëtarëve të Rijasetit të BFI dhe anëtarëve tjerë të administratës së Bashkësisë Fetare Islame të RMV. Zoti i bekoftë me të mira për mundin që dhanë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

# IFTAR ME VËLLEZËRIT E KOMUNITETIT ROM NË GOSTIVAR

Më 13 prill, 2022, Myftinia e Gostivarit shtroi iftar për vëllezërit e komunitetit rom, në kuadër të muajit të bekuar të Ramazanit 1443 H, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Gostivar.

Në iftarin e shtruar mori pjesë Myftiu i Myftinisë së BFI-Gostivar, h. Sabahudin ef. Zendeli, i shoqëruar nga h. Mallzim ef. Zendeli dhe në të ishin të pranishme

personalitete të ndryshme, si: z. Shaban Saliu, Kryetar i FDR; z. Firdeus Ajdari, Këshilltar Komunal në Gostivar; z. Kashmir Saliu, Administrator në Qeverinë e RMV; z. Shukri Toçi, h. Memedaliu, h. Emin Xheladini –anëtarë të EZRG-Gostivar dhe shumë mysafirë të tjerë.

Me këtë rast, Myftiu h. Sabahudin ef. Zendeli mbajti një fjalë përshëndetëse, me

ç’rast falënderoi të pranishmit që i ishin përgjigjur ftesës, u uroi Ramazanin dhe kujtoi Ditën Ndërkombëtare të Romëve – 8 Prillin, si një ditë urimi dhe përgëzimi për të gjithë.

Në shenjë mirënjohjeje, Bashkësia Rome Myftiut i ndau një pllaketë falënderimi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

# MYFTINIA E SHKUPIT PRET DELEGACIONIN E RIJASETIT

Më 15 prill, 2022, 14 Ramazan 1443 H, për namazin e xhumasë, delegacioni i Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut vizitoi xhamitë e Myftinisë së Shkupit, thuhet në njoftimin e BFI.

Delegacioni i Rijasetit të BFI vizitoi këto xheme: h. Irsal ef. Jakupi vizitoi xhematin e xhamisë “Mustafa Pasha” - Shkup; prof. dr. Shaban ef. Sulejmani vizitoi xhematin e xhamisë “Husein Shah” - Saraj; prof. dr. Faredin ef. Ebibi vizitoi xhematin e xhamisë “Miraxh” -

Haraçinë; prof. dr. Naser ef. Ramadani vizitoi xhematin e xhamisë “Allaxha”; prof. dr. Muhamed ef. Mustafa vizitoi xhematin e Xhamisë me Dy Minare - Saraj; prof. dr. Muaz ef. Agushi vizitoi xhematin e xhamisë së fshatit Inxhikovë; Musanif ef. Rufati vizitoi xhematin e xhamisë “Haxhi Azem” - Shkup; prof. Fatmir ef. Kurtishi vizitoi xhematin e xhamisë së fshatit Gllumovë; Fadil ef. Ramadani vizitoi xhematin e xhamisë “Karshiaka” - Batincë; prof. Sulejman ef. Idrizi vizitoi xhematin e

Xhamisë së Vjetër të Kondovës; prof. Lutfi ef. Nexhipi vizitoi xhematin e xhamisë “Neda” - Haraçinë; prof. Mevlud ef. Aliu vizitoi xhematin e xhamisë “Haxhi Jonuz”; prof. Shafi ef. Osmani vizitoi xhematin e xhamisë së fshatit Gërçec; prof. Hamza ef. Asani vizitoi xhematin e xhamisë së fshatit Moranë; prof. Zekirija ef. Metushi vizitoi xhematin e xhamisë së fshatit Llaskarcë; prof. Hasan Xhillo vizitoi xhematin e Xhamisë së Vjetër të fshatit Lubin, thuhet në njoftimin e BFI.

# NË IFTARIN E MYFTINISË SË SHKUPIT

Edhe një mbrëmje e këndshme iftari më 9 prill, 2022, organizuar nga Myftinia e Shkupit, në krye me Myftiun dr. Qenan ef. Ismaili.

Të ftuar, personalitete të njohura të sferës politike, kulturore, afariste etj. Pra, deputetë, ministra, zëvendësministra, kryetarë komunash, afaristë, teologë e mysafirë nga territori i Myftinisë së Shkupit.

Ishte kënaqësi – ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Më 11 prill, 2022 (10 Ramazan 1443

H), pata nderin dhe kënaqësinë që ‘sofrën e iftarit’, momentet më të veçanta, çastet e pranimit të lutjeve tona, t’i përndaj me personat me nevoja të veçanta, të cilët janë pjesë e pandashme dhe shumë e rëndësishme e shoqërisë sonë, thuhet në njoftimin publik të Myftiut të Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Ky iftar tradicional, i shtruar nga Myftinia e Shkupit, u realizua falë bashkëpunimit me shoqatat “Shpresa”, “Mirësia” dhe “SOS-vita” nga Shkupi.

E ndjej për obligim që të falënderoj

përzemërsisht stafin udhëheqës të shoqatave pjesëmarrëse dhe të gjithë ata miq tanë që e pranuan ftesën dhe e begatuan Sofrën tonë të iftarit.

Njëmend, vlera e vërtetë e njeriut tek Allahu i Madhërisëm matet sipas besimit, sipas devotshmërisë dhe dëlirësisë shpirtërore. Pikërisht për këtë Muhamedi (a. s.) ka thënë: “Vërtet, Allahu nuk shikon në trupat e as në fizionomitë tuaja, por shikon në zemrat dhe në veprat tuaja.” (Muslimi)

Allahu e pranofhtë! - thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit.

# KOMISIONI I RIJASETIT NË MYFTININË E TETOVËS

Më 23 prill, 2022, Komisioni i Ramazanit i Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame vizitoi Myftininë e BFI-Tetovë nën udhëheqjen e Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetarin e BFI të RMV e shoqëronin mr. Salim ef. Sulejmani, Nasir Rexhepi, prof. Jusuf Zimeri, prof. dr. Naser Ramadani, Prof. dr. Faredin Ebibi, h. Muamer ef. Veseli, prof. dr. Mevlud Aliu, dr. Abdylqerim Iseni, mr. Mustafë Dauti, prof. Shafi Osmani, prof. Lutfi Nexhipi e

të tjerë.

Komisioni u prit ngrohtë dhe në mënyrë vëllazërore në Xhaminë e Larme nga Myftiu prof. dr. Qani ef. Nesimi me bashkëpunëtorë. Myftiu i Tetovës pasi përshëndeti xhematinjtë, shprehu mirëseardhje për Reis’ul-Ulemanë së bashku me anëtarët e tjerë të delegacionit.

Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në fjalën e tij të rastit përshëndeti xhematin e Xhamisë së Larme, duke i falënderuar për kontributin e madh që japin në mirëmbajtjen e institucioneve fetare

dhe më gjerë. Po ashtu, falënderoi Myftiun prof. dr. Qani ef. Nesimi dhe shoqëruarit e tij, h. Idriz ef. Idrizi dhe h. Xhemil ef. Sadiku, si dhe Imamin e Xhamisë, hfz. Abdylbaki Kasami dhe myteveliun e Xhamisë.

Pas iftarit tradicional të Myftinisë së Tetovës, të gjithë anëtarët e Komisionit të Ramazanit u ndanë nëpër xhamitë e Myftinisë së Tetovës dhe vizituan xhematet e tyre, duke ndarë çaste të këndshme të një nate të bukur ramazani, thuhet në njoftimin e BFI.

# RAMAZANI, MUAJ I MIRËSISË

Myftinia e Bashkësisë Fetare Islame e Kumanovës më 15 prill, 2022, për hir të muajit të bekuar të Ramazanit organizoi një iftar, ku ishin të ftuar të gjithë imamët e punësuar dhe të pensionuar të Myftinisë së Kumanovës, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

Iftari ishte donacion nga Sabahudin Selmani dhe u shtrua në Restorant Panorama-Likovë.

Të gjithë imamët iu përgjigjën ftesës së Myftinisë dhe ishin të pranishëm në këtë iftar.

Në fund, të pranishmit i përshëndeti Myftiu i Myftinisë së Kumanovës, h.

Abedin ef. Imeri, i cili Ramazanin e vlerësoi si muaj të mirësisë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

Më 24 prill, 2022, Kryetari i Komunës së Likovës, z. Erkan Arifi, shtroi një iftar në Restorant Freskia në fshatin Likovë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

Pas iftarit përshëndeti Kryetari i Komunës së Likovës, z. Erkan Arifi. Në vazhdim përshëndeti Myftiu i Kumanovës, Abedin ef. Imeri, i cili tha: “I nderuar Kryetar i Komunës së Likovës, z. Erkan Arifi, më lejoni që në emër të Myftinisë së Kumanovës dhe në emër të të gjithë

imamëve që gjenden në këtë iftar, të cilin ju e keni organizuar, t’ju falënderoj dhe njëherësh i bëj lutje Allahut të Madhërisëm që ta pranohet këtë ibadet, të cilit i jemi kah fundi. I nderuar Kryetar, po ashtu i bëj lutje Allahut të Madhërisëm që të vazhdoni në punët tuaja për të mirën e banorëve të kësaj komune dhe - ju priftë e mbara.”

Allahu na pranofhtë agjërimin dhe të gjitha veprat tona që i bëjmë gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Kumanovës, nënshkruar nga Myftiu Abedin ef. Imeri.

# IFTAR PËR MË TË DASHURIT E ALLAHUT NË KUMANOVË

Më 21 prill, 2022, kisha nderin dhe kënaqësinë më të madhe që në muajin e bekuar të Ramazanit të jem pjesë e iftarit me peshë të madhe, të organizuar nga miku i shtëpisë dhe afaristi i mirënjohur kumanovar z. Nexhdet Ramadani, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Kumanovës Abedin ef. Imeri.

Iftari u shtrua enkas për personat me aftësi të kufizuara, bashkërisht me famil-

jet e tyre. Vlen të theksohet se Allahu fuqipotë e vlerëson lart punën, kujdesin dhe angazhimin e të gjithë atyre që e shtrijnë dorën e humanizmit dhe të kujdesit ndaj kësaj kategorie, që sadopak të fut gëzimin, dashurinë dhe barabarësinë në zemrat e tyre, të cilët janë edhe kategoria më e dashur tek Allahu i madhërisëm.

Pejgamberi (a. s.) thotë: "Allahu nuk i shikon njerëzit në fytyrat tuaja e as në

trupat tuaj, por shikon në zemrat dhe veprat tuaja." Gjithashtu, Pejgamberi (a. s.) thotë: "Kush përkujdeset për një jetim në mesin e myslimanëve dhe e afron të hajë dhe të pijë me të, Allahu do ta vulosë hyrjen e tij në Xhenet."

Personat me aftësi të kufizuara, jetimët, skamnorët janë amaneti ynë; mundohu që t’i ndihmohet, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Kumanovës.

# NË 7 XHAMI TË KUMANOVËS

Më 22 prill, 2022, Komisioni i Rijasetit i BFI të RMV, i autorizuar nga Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, qëndroi në Myftininë e Kumanovës. Komisioni u udhëhoq nga prof. Jusuf ef. Zimeri, Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor të Rijasetit të BFI.

Komisioni vizitoi këto xhami: “Tatar Sinan Pasha” (dr. Mevlud ef.

Aliu); Xhamia e Re (dr. Abdylqerim ef. Iseni, Shef i Kabinetit të Reis’ul-Ulemasë); “Haxhi Shefket” (dr. Naser ef. Ramadani, profesor në FSHI, Shkup); fshati Çerkez (prof. Hamza ef. Hasani, Medreseja Isa Beu, Shkup); fshati Ropalcë (prof. Jasir ef. Osmani, Medreseja Isa Beu, Shkup); “Haxhi Hesat” në Llojan (prof. Jusuf ef. Zimeri); “Mulla

Sadik” në Sllupçan (dr. Faredin ef. Ebibi, profesor në FSHI).

Myftinia e BFI-Kumanovë falënderoi Komisionin e Rijasetit për vizitën e bërë, me lutje që Allahu i Madhërisëm t’i shpërblejë me të mirat e Tij të pafund, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës, nënshkruar nga Myftiu Abedin ef. Imeri dhe të shpërndarë nga BFI.

# NË KËRÇOVË, NË NAMAZIN E TERAVISË

Më 14 prill, 2022, delegacioni i Rijasetit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut vizitoi Myftininë e Kërçovës në namazin e teravisë, thuhet në njoftimin e Zyrës për Informim të Myftinisë së Kërçovës.

Delegacioni udhëhoq nga Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi dhe në të ishin edhe: Prodekani i FSHI prof. dr. Muaz Agushi, prof. dr. Shinazi Memedi,

prof. dr. Abdylxhemil Nesimi, prof. dr. Muhamed Mustafa, mr. Lutfi Nexhipi, dr. Mevlud Aliu, prof. Jasir Osmani, prof. Shaban Ahmeti.

Pasi u mirëpritën nga Myftiu i Kërçovës Qamil ef. Rushiti, bashkë me administratën e Myftinisë, të gjithë u shpërndanë në disa xhami të territorit të Myftinisë së Kërçovës, për të falënderuar xhematin kërçovar për përkrahjen e insti-

tucioneve edukativo-arsimore të Bashkësisë Fetare Islame.

Ata u shpërndanë në këto xhami: Sul-tan Bejazit, Katër Kalifët, Bella Kulla, Sheh Selim Teqe, f. Drogomisht i Madh, f. Trapçindoll, Halveti Hajati Teqe, f. Lisiçan, f. Jagoll dhe f. Preglllovë.

Allahu i shpërbleftë për vizitën dhe mundin, thuhet në njoftimin e Zyrës për Informim të Myftinisë së Kërçovës.

# MYFTINIA E PRILEPIT SHTRON IFTAR

Më 14 prill, 2022, Komisioni i Ramazanit i Bashkësisë Fetare Islame, i kryesuar nga Drejtori i Agjencisë për Standardin Hallall h. Muhamer ef. Veseli, vizitoi Myftininë e Prilepit, ku u prit me zemërgjerësi dhe me një organizim të mirëfilltë fetar nga Myftiu i Myftinisë së Prilepit h. Shefqet ef. Imeri dhe operativa dhe imamët e kësaj Myftinie, thuhet në njoftimin e BFI.

Në çelje të iftarit Kryesuesi i Delega-

cionit të Ramazanit, h. Muhamer ef. Veseli, në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, përshëndeti të gjithë imamët dhe këshillat e xhamive, duke u uruar agjërim dhe lutje të pranuar nga Allahu i Plotfuqishëm. Njëherësh, shprehu respektin dhe konsideratën ndaj tyre për punën bujare dhe fisnike, të cilën e kryejnë me dinjitet në shërbim të xhemateve tona. Gjithashtu, ef. Veseli shprehu falënderimet e tij dhe respektin

ndaj Myftiut h. Shefqet ef. Imeri për organizimin dhe udhëheqjen e mirëfilltë të detyrës së Myftiut të Prilepit.

H. Muhamer ef. Veseli, në emër të Komisionit të Rijasetit të BFI të RMV dhe të Myftiut h. Shefqet ef. Imeri falënderoi përzemërsisht edhe donatorin e iftarit, z. Esko Hasanoviç, xhamatë i dalluar i kësaj ane, duke i uruar atij dhe familjes së tij shëndet, gëzime, lumturi dhe jetë të gjatë, thuhet në njoftimin e BFI.

## VIZITOHET MYFTINIA E RESNJËS

Të enjten Më 14 prill, 2022, Komisioni i Ramazanit i Bashkësisë Fetare Islame, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, ku ishin dhe Prodekani i FSHI doc. dr. Muaz ef. Agushi, prof. dr. Abdylxhemil Nesimi dhe prof. dr. Muhamed Mustafa, vizitoi Myftininë e BFI-Resnjë, ku u pritën me zemërgjerësi nga Myftiu i Myftinisë së

Resnjës h. Xhunejd ef. Jashar, bashkë me imamët dhe xhematet e kësaj myftinie, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjatë iftarit të shtruar enkas për Komisionin dhe imamët e kësaj myftinie, kryesuesi i delegacionit të Ramazanit, h. Irsal ef. Jakupi, i përshëndeti të pranishmit në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe u dëshiroi ag-

jërim të lehtë dhe lutje të pranuar nga Allahu i Plotfuqishëm. Ai e vlerësoi lart angazhimin e Myftiut dhe të imamëve të kësaj Myftinie dhe shprehu falënderime dhe konsiderata për punën e tyre të palodhshme. Më pas, të gjithë anëtarët e delegacionit u shpërndanë nëpër xhamitë e kësaj Myftinie dhe vizituan xhematet e kësaj ane, thuhet në njoftimin e BFI.

## IFTAR NGA KRYETARI I KAVADARIT

Më 28 prill, 2022, Kryetari i Kavadarit, z. Mitko Jançev, shtroi iftar, ku mori pjesë edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Më parë, gjatë ditës, u vu në funksion shtëpia e përgatitjes së kufomave (mortorja), me sallonin e pritjeve për ngushëllim pranë varrezave myslimane të qytetit të Kavadarit.

Reis'ul-Ulemaja u shoqërua nga Se-

kretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Myftiu i Velesit h. Nijazi ef. Murati dhe Sekretari i Myftinisë z. Erdal Tefikov.

I gjithë ndërtimi u udhëhoq nga Haxhi Ahmeti, një aktivist i mirënjohur, i përkrahur nga Kryetari i Kavadarit z. Mitko Jançev, i cili i priti mysafirët nga BFI në mënyrën më të mirë dhe i cili ka kontribuar me të gjitha mundësitë nga ato administrative, deri në ato materiale.

Në fjalimin e tij, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu përshëndeti aktivi-

tetet e besimtarëve myslimanë në Kavadar, mundin e tyre që e japin brenda mundësive të tyre. Njëherësh, falënderoi Kryetarin e Komunës për shërbimin që iu bënë myslimanëve të rrethit, me qëllim që ata të ndihen të barabartë.

Kryetari Jançev u falënderua për vizitën dhe uroi të gjithë besimtarët myslimanë për sjelljen e tyre, duke i vlerësuar si qytetarë që kontribuojnë shumë në të gjitha sferat e jetës, thuhet në njoftimin e BFI.

## BANJICA MERR LEJEN PËR XHAMI

Elhamdulillah, edhe kjo punë u krye: me izën e Zotit, sot morëm lajmin e shumëpritur për nxjerrjen e lejes për ndërtimin e xhamisë në fshatin Banjicë,

komuna e Çashkës. Allahu na ndihmoftë në ndërtimin e saj sa më shpejt. Amin! – ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Velesit, Nejaz ef. Murati, në faqen e vet në Face-

book më 27 prill, 2022. Në të njëjtën kohë, ai ka publikuar edhe faksimilen e lejes së akorduar për ndërtimin e xhamisë në Banjicë të Çashkës.

## NË MESIN E BESIMTARËVE TË VELESIT

Një natë Ramazani - në mesin e besimtarëve të Myftinisë së Velesit: Një ambient i një nate të bukur të Ramazanit në xhematet e Myftinisë së Velesit nga vizita e Komisionit të Rijasetit të BFI të RMV, ka njoftuar Reis'ul-Ulema h. hfz.

Shaqir ef. Fetahu. Me propozim të Myftiut Nijazi ef. Murati, vizitova fshatin më të madh - Orizaren e Epërme. Përjetim i veçantë, me të gjitha vlerat, në organizim të hoxhës Elvis, të Kryetarit Zenuni, të z. Enverit dhe të besimtarëve.

Vizitua vendin për xhami të re, mbajtëm ligjëratat e teravive dhe shumë aktivitete të tjera. Faleminderit shumë. Zoti ju bekoftë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 12 prill, 2022.



Takim rasti me Veli pelivanin e Buzallkovës - veteranin e mirënjohur të mundjes në trevat tona. Mbetet i paharruar - ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në Facebook. (12.04.2022)



Të nderuar në iftarin e pronarit të restorant "Bushi" (Shkup), ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook. (28.04.2022)



Më 29 prill, 2022, Kryetari i Bashkisë së Londrës, Sadiq Khan, ka shtruar iftar në sheshin kryesor të kryeqytetit britanik Trafalgar Square. Në faqen e vet në Facebook ai ka shkruar: "Kanë marrë pjesë me mijëra londinezë nga të gjitha sferat e jetës, të cilët u bënë bashkë në zemër të qytetit tonë për një iftar Ramazani. Dhe, a nuk duket bukur Sheshi Trafalgar! Këtu në Londër - ne e përqafojmë dhe e festojmë diversitetin tonë."

# SEMRA LOKU, HAFËZJA MË E RE NË SHKUP

Më 30 mars, 2022, në prag të muajit të bekuar të Ramazanit, në Xhaminë e Re të Çairit u bë ceremonia e duasë së hifzimit të hafëzës më të re në Shkup, Semra Loku, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë solemnitet morën pjesë: Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni etj. Merrnin pjesë mysafirë, hoxhallarë dhe xhematlinj të lagjes së Çairit.

Semra Loku hifzin e filloi më 1.12.2018 dhe e mbaroi më 29.11.2020, tek muhafizja e saj, hfz. Neal Ibrahim. Provimin e hifzimit e ka mbrojtur 5 ditë radhazi, me metodën e re të aplikuar të dëgjimit të tërë Kuranit para Komisionit për Vlerësim të Myftinisë së Shkupit: hfz. Munevera Murtezi, Kryetare e Komisionit; hfz. Selviqe Dardhishta Shaqiri, anëtare e Komisionit;

hfz. Neal Ibrahim, anëtare e Komisionit; Xheuhere Ramani, përfaqësuese e Myftinisë së Shkupit.

Në fund, Reis'ul-Ulemaja dhe Myftiu i Shkupit hafëzës i dorëzuan diplomën e Hifzimit dhe i dhuruan edhe dhurata simbolike, thuhet në njoftimin e BFI.

“Në ceremoninë e duasë së hifzimit të hafëzës Semra Loku fola për rëndësinë e madhe që ka mësimi i Kuranit famëlartë, për rëndësinë e madhe që ka edukimi familjar. Jo më kot është thënë se brenga dhe frika më e madhe e një prindi është udha që do të ndjekë fëmija i tij, prandaj një prind që fëmijës së vet ia jep Kuranin dhe hafëzin (a hafëzen) e shndërron në mbrojtës të Fjalës së Allahut, ai fiton shumë begati në këtë dynja dhe në dynjanë tjetër”, ka njoftuar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook të njëjtën ditë.

Me njoftim nga duaja e hifzimit kanë dalë edhe Myftinia e Shkupit, edhe Medreseja Isa Beu në Shkup. Në njoftimin e shkollës së mesme islame thuhet:



“Medreseja Isa Beu, vater e kultivimit të hifzimit të Kuranit të madhërishtëm. Nga Paralelja e Shtrirë e Vajzave në Shkup hifzin e Kuranit famëlartë e ka përfunduar nxënësjja Semra Loku nga Shkupi, e lindur më 22.05.2003.

Në këtë solemnitet të veçantë dhe madhështor iu dha fjala Administratores së Medresesë, mr. Nurten Shehu Saqipi, e cila në emër të Drejtorit të Medresesë, prof. Ibrahim ef. Idrizi, në emër të stafit edukativo-arsimor, përshëndeti prindërit e nxënësës dhe të pranishmit, muhafizen dhe Komisionin e hifzimit, përfaqësuesit e Myftinisë së Shkupit dhe në veçanti hafëzen e re, së cilës i dëshiroi sukses në punën e mëtejme. Ajo po ashtu mbajti ligjëratë më temë ‘Vlera dhe rëndësia e të mësuarit përmendsh të Kuranit qerim’. Programi filloi me ashere nga nxënësit e Medresesë, u kënduan ilahi nga kori i vajzave i shkollës dhe në fund u bë dua ja e Hifzimit.

Nuk ka dyshim se ky manifestim është një shembull konkret edhe për nxënëset tjera se si duhet të jenë shembull i misionit të shenjtë islam, ashtu si na ka porositur Muhamedi (a. s.), thuhet në njoftimin e Medresesë Isa Beu në Shkup.

## PRITJE PËR HAFËZIN 13-VJEÇAR



Më 16 prill, 2022, 15 Ramazan 1443 H, Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, priti në Myftini në mënyrë solemne hafëzin e ri 13-vjeçar, hfz. Ebrar Ademi, nga fshati Forinë i Gostivarit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Gostivar.

## HATME NË GRUPÇIN, PËR 41 NXËNËS

Pas angazhimit prej një viti e gjysmë, më 27 mars, 2022, Mejtepi i Xhamisë së Grupçinit ka bërë hatmen për 41 nxënës, thuhet në njoftimin e hoxhës së fshatit, mualim Bajram ef. Ferati.

Nga gjenerata e pestë, diplomat i kanë marrë 11 djem dhe 30 vajza. Shkallën e parë e kanë kryer 29 nxënës, të dytën 11 dhe të katërtën – 1 nxënës. Suksesi i nxënësve nga ana e Komisionit të Myftinisë

së Tetovës është vlerësuar me “mirë”. Në vlerësim kanë marrë pjesë referentët për arsim Beqir ef. Memeti dhe Idriz ef. Idrizi.

Vërtet nuk di si ta përshkruaj këtë moment, se është një gëzim shumë i veçantë dhe me shumë emocione, thotë Bajram ef. Ferati dhe vazhdon: Ceremonia e hatmes ishte me shumë pjesëmarrës: morën pjesë ish-Myftiu hfz. Imer Kamberi, pastaj profesorë nga Medreseja Isa Beu në Shkup e

Tetovë, Sekretari i Fakultetit të Shkencave Islame Zekerija Metushi dhe diku 40 hoxhallarë, të ardhur nga vende të ndryshme.

Nxënësit që përfunduan Kuranin, përveç diplomës, kanë marrë dhe nga një libër.

Falënderimi i goftë Zotit Lavdiplotë! Zoti i bekoftë të gjithë. Amin! – thuhet në njoftimin e Bajram ef. Feratit nga Xhamia e fshatit Grupçin, komuna e Zhelinës (Tetovë).

## XHAMIA E SAHATIT SHËNOI 83-VJETORIN E HATMES DITORE

Myftinia e Tetovës, me rastin e 83-vjetorit të hatmes ditore të leximit të Kuranit Famëlartë më 28 prill, 2022, pas namazit të iqindisë organizoi manifestim fetar-kulturor në Xhaminë e Sahatit, thuhet në njoftimin e Myftiut të Tetovës Qani ef. Nesimi.

Prezantues i manifestimit ishte mr. Xhemil ef. Sadiku dhe në të morën pjesë Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi; Myftiu i mëparshëm Alifekri ef. Esati; Imami i mëparshëm i Xhamisë, prof. dr. Metin ef. Izeti; Imami aktual, hfz. Havzi ef. Ramadani; lexuesit e respektuar të hatmes ditore, Këshilli organizativ i hatmes me Këshillin e Xhamisë, hoxhallarë të Tetovës dhe të rrethinës, si dhe një numër i madh i xhematit, i përbërë nga të dy gjinitë.

Para xhematit u paraqit një program fetar-kulturor nga disa hoxhallarë dhe



nxënës të Medresesë Isa Beu, Shkup.

Programi filloi me lexim të Kuranit Famëlartë nga Referenti për arsim fetar pranë Myftinisë, mr. Xhemil ef. Mehmeti dhe vazhdoi me ilahi dhe kaside. Para fjalimit të Myftiut, Referenti për kulturë pranë Myftinisë së Tetovës, dr. Husein ef. Rizai, lexoi historikun e hatmes ditore në dy gjuhë: shqip dhe turqisht.

Myftiu i Tetovës, Qani ef. Nesimi,

mbajti fjalën e rastit, ku foli mbi vlerën e kësaj pune shumë madhështore dhe uroi që kjo traditë të vazhdojë deri në kiamet.

Në fund të manifestimit u lexuan suret e shkurtra nga hfz. Idriz ef. Osmani dhe myezini i Xhamisë, Ali ef. Abdullahi.

Duanë e hatmes e bëri Myftiu i mëparshëm i Tetovës, Alifekri ef. Esati, thuhet në njoftimin e Myftiut të Tetovës Qani ef. Nesimi.

## 14 NXËNËS KRYEJNË MEJTEPIN NË FSHATIN GRUSHINË

Më 25 mars, 2022, në xhaminë e fshatit, para namazit të xhumasë, u realizua ceremonia e duasë së hatmes me rastin e mbarimit të mësimbesimit islam nga 14 nxënës të fshatit Grushinë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shkup.

Para fillimit të programit, me fjalë përshëndetëse të pranishmëve iu drejtua prof. dr. Taxhedin ef. Bislimi, hatib dhe mualim i Xhamisë, i cili falënderoi të pranishmit që kanë ndarë kohë për të prezantuar në këtë ceremoni në emër të familjarëve të nxënësve.

Hytben e xhumasë e realizoi h. Fejsall ef. Kadriu, i cili mes tjerash tha: “Pas këtij suksesi, përfituesit më të mëdhenj, krahas mualimit, i cili ka dhënë kontri-

butin e tij në përcjelljen e njohurive bazë të Islamit të nxënësit, si dhe të prindërve, që fitojnë shpërblime të mëdha për udhëzimin e fëmijëve të tyre, pa dyshim se janë edhe këta nxënës, për të cilët realizohet ky manifestim. Në këtë ditë të bekuar të xhumasë, i bëj lutje Allahut fuqiplotë që t’ua jetësojë këtë dije të hairit në jetën e tyre të mëtejshme.”

Ndarjen e diplomave e bëri Fejsall ef. Kadriu, i cili uroi nxënësit për këtë sukses, ndërsa mualimit të nxënësve i ndau mirënjohje në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në mbarëvajtjen e mësimbesimit islam pranë mejtepit të xhamisë së fshatit Grushinë.

Ashere lexoi mr. Nexhmi ef. Ferati,

ndërsa duanë e hatmes e bëri prof. dr. Faradin ef. Ebibi, profesor në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup. Xhematin në faljen e namazit të xhumasë e udhëhoqi hfz. Irfan ef. Sulejmani, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Në profilin e vet në Facebook, përveç tjerash, Myftiu Qenan ef. Ismaili të njëjtën ditë ka shkruar: “Prof. dr. Taxhedin ef. Bislimin Allahu e shpërbleftë për kontributin e tij, për punën e tij të çmuar në edukimin e brezave, i cili krahas angazhimeve e detyrave të shumta që mbart mbi supe, po ndan kohë që nga mejtepi i fshatit Grushinë të nxjerrë nxënës që e mësojnë fjalën e Allahut fuqiplotë.”

## PESË NXËNËS DIPLOMOJNË NË KREUZLINGEN

Më 27 mars, 2022, në xhaminë "Hëna e Re" në Kreuzlingen (Zvicër) u zhvillua ceremonia e duasë së hatmes për pesë nxënës e nxënës, për herë të dytë, thuhet në njoftimin e Xhamisë në Kreuzlingen.


Hatme kanë bërë: Bledion (Nexhmedin) Haziri, Enes (Mensur) Sulejmani, Ernes (Mensur) Sulejmani, Evel (Valdet) Sulejmani dhe Linhana (Selman) Dehari.

Me këtë rast janë kënduar disa pjesë nga Kurani, ilahije dhe vjersha. Pastaj është bërë dua ja e hatmes. Nga ana e ima-

mit, mualimit, nxënësit morën nga një diplomë dhe nga një libër për problemet e të rinjve.

Kjo është gjenerata e 15-të dhe me këtë mbyllet me 130 numri i të gjithë nxënësve që kanë kryer hatme në xhaminë “Hëna e Re” prej vitit 2006 e këndeje, thuhet në njoftimin e xhamisë “Hëna e Re” në Kreuzlingen.

Të njëjtën ditë lajmi është shpërndarë në rrjetet sociale edhe nga Imami i Xhamisë, Rejhan ef. Neziri.



# SLLATINA ME XHAMI TË RE

Më 26 mars, 2022, në prag të Ramazanit, Myftinia e Tetovës hapi xhaminë e re në fshatin Sllatinë, komuna e Tearcës, thuhet në njoftimin e BFI.

Në ceremoninë e hapjes së xhamisë ishte Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Myftiu i Tetovës - si nikoqir - prof. dr. Qani ef. Nesimi me bashkëpunëtorët, myftilerët e BFI h. Sabahudin ef. Zendeli, mr. Nasir ef. Rexhepi dhe mr. Salim ef. Sulejmani, Zv/Drejtori i Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze Mexhit ef. Emruli, Prodekani i FSHI doc. dr. Muadh Agushi, Myftiu i mëparshëm i Tetovës Alifekri ef. Esati, drejtorët e sektorëve të Rijasetit: prof. Jusuf ef. Zimeri, h. Muhamer ef. Veseli, mr. Mustafa Dauti, h. Rexhep Ziberi, z. Musanif ef. Rufati, Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, imamë, Kryetari i Komunës së Tearcës z. Nuhi Neziri etj.

Fillimisht, në emër të Këshillit të xhamisë së re të pranishmit i përshëndeti prof. Zulqufli Sulejmani, pastaj ish-imami i Sllatinës h. Harbin ef. Jonuzi, imami i ri z. Nehat Aliji, Kryetari i Komunës së Tearcës dhe Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, i cili shprehu dhe mirënjohje



për aktivistët dhe donatorët.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu falënderoi Myftiun dhe Këshillin iniciativ për ftesën dhe shpjegoi rolin e xhamisë në ngritjen e vetëdijes fetare e kombëtare, duke uruar dhe Këshillin iniciativ për punën e bërë.

Duanë e bëri myftiu i mëparshëm i Tetovës, h. Alifekri ef. Esati, ndërsa në namazin e drekës priu Myftiu i Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli. Programin e moderoi z. Xhemil Sadiku, me falënderime të posaçme për të gjithë organizatorët, për punën e tyre të madhe, në krye me Kryetarin e Këshillit iniciativ haxhi Shemsedin Idrizin, thuhet në njoftimin e BFI.

Në fund, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës, Kryetari i BFI dhe Myftiu i Tetovës imamit të xhamisë ia dorëzuan Dekretin e ushtrimit të detyrës si Imam, më pas nga ana e Këshillit Iniciativ të Xhamisë, përkatësisht nga haxhi Shemsedin Idrizi, iu dorëzuan çelësat e xhamisë Reisis dhe Kryetarit të Këshillit të Xhamisë. Para duasë së hapjes u lexuan edhe disa pjesë të Kuranit famëlartë nga imami i xhamisë së fshatit Përshëfcë, Shaban ef. Asani.

Solemniteti i përirimit të xhamisë së re në Sllatinë ishte transmetuar drejtpërdrejt, në kohë reale, përmes platformave elektronike të BFI të RMV.

# GËRÇECI NDËRTON XHAMI TË RE

Më 1 prill, 2022 (29 Shaban 1443H, e xhuma), në prag të Ramazanit, në fshatin Gërçec të komunës së Sarajit u vu guri themeltar i xhamisë së re. Koordinimin e punëve e kanë bërë Myftinia e Shkupit, e udhëhequr nga Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili, dhe Këshilli inicues i këtij vendbanimi të Shkupit, thuhet në njoftimin e BFI.

Në ceremoninë e gurthemelit morën pjesë: Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Sekretari i Komunës së Sarajit z. Sefi Shabani, Kryetari i OH 'Hilal' mr. Fadil ef. Ramadani, Kryetari i Shoqatës së Ulemave Rexhep ef. Ziberi, Drejtori për Marrëdhënie me Jashtë mr. Mustafa ef. Dauti, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni, hoxhallarë të rajonit dhe të ftuar të tjerë.

Allahu (xh. sh.) na e mundësoftë që ta përjetojmë edhe gëzimin e hapjes së këtij Bejtullahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në rrjetet sociale ka shkruar: "Është kënaqësi të përmendet se vendin për xhami e ka falur haxhi Ramiz Ademi, ndërsa xhaminë e ndërton haxhi Garip Demiri, respektivisht djali i tij, biznesmeni i mirënjohur z. Enver Demiri nga fshati Gërçec."



"Sot, në këtë ditë gëzimi, në koordinim me Këshillin inicues, vumë gurin themeltar të xhamisë së re në fshatin Gërçec. Në nisjen e xhamisë na nderuan Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me delegacionin nga Rijaseti, përfaqësues të Komunës së Sarajit etj.", ka shkruar në faqen e vet në Facebook Myftiu i Myftinisë së Shkupit.

Në platformat elektronike të BFI të RMV, në kohë reale, ka pasur transmetim të drejtpërdrejtë nga ngjarja e nisjes së xhamisë së re në Gërçec.

## "FALËM XHUMANË NË XHAMINË E MEREMTUAR"

Sot, në namazin e xhumasë, bashkë me Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe delegacionin e lartë të BFI-së, vizituum xhematin e xhamisë së Gërçecit me rastin e përfundimit të meremetimit të plotë të saj, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

U nderuam nga mikpritja e hatibit të xhamisë, hfz. Ramadan ef. Aziri, imamit hfz. Gazmend ef. Tahiri, Këshillit të

Xhamisë dhe të xhematit të pranishëm.

Reis'ul-Ulemaja në fjalim e tij uroi xhematin me rastin e fillimit të muajit të bekuar të Ramazanit, si dhe shprehu mirënjohje për kontributin e besimtarëve të kësaj ane në rinimin e tërësisht të Xhamisë.

Hytben e xhumasë e realizoi Kryetari i Shoqatës Ilmije, h. Rexhep ef. Ziberi, banor i Gërçecit.

Pata nderin dhe kënaqësinë që t'i

prij xhematit në faljen e namazit të xhumasë.

Vërtet, të gjithë ata kontribues që kanë sakrifikuar nga pasuria e tyre për t'ia dhënë këtë hijeshi dhe freski Xhamisë së Gërçecit, bartin shpërblim të madh, për faktin se janë bërë hisedarë në rinovimin e shtëpisë së Allahut (xh. sh.). Allahu Fuqplotë goftë i kënaqur me punën e tyre! – ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit. (1.04.2022)

## NJË VEPËR E MADHE PËR RAMAZAN

*Nga Taxhudin Hamidi*

Muhamedi (alejhis-selam) ka thënë: "Xhamia është shtëpia e çdo njeriu të devotshëm." Pa dyshim se edhe fshati Sllatinë po e krijon një histori të re me objektin e ndërtuar për mrekulli.

Xhamia e parë në Sllatinë, ndërkaq, është ndërtuar në vitin 1738.

Xhamia e vitit 1997 sot e kësaj dite dallon ndër xhamitë e Tetovës dhe është hiperaktive në aktivitetin e saj. Ajo funksionon me të gjitha elementet e saj administrative në kuadër të BFI-Myftinia e Tetovës.

Pas njëzet viteve lindi nevoja për një xhami të dytë dhe kjo sot u bë realitet për banorët dhe xhematin e fshatit Sllatinë, që shtrihet në anën e majtë të magjistrales Tetovë-Jazhincë, rreth

10 km larg Tetovës. Fshati ka mbi 1.250 shtëpi, me afër 7.000 banorë.

Në Sllatinë ekziston Kalaja ilire, e cila e vërteton lashtësinë e këtij fshati, me një zinxhir demografik të gjatë dhe të zhvilluar sipas rrethanave dhe standardeve moderne deri më sot.

Mes për mes tij kalon një lumë i vogël, me burim nga "Tri Ujërat".

Xhamia e re është një dhuratë dhe vepër e madhe në prag të muajit të Ramazanit.

Të gjithë pjesëmarrësit në solemnitet shprehën fjalë miradije dhe uruan për menaxhimin dhe organizimin e kësaj godine brilante në këto kohë krizash. Dëshira dhe vullneti për të pasur Sllatina edhe një xhami të re u realizua falë dashmirëve të vakëfit, si agregat dhe akcelerator i shumë punëve të hairit.

Kjo xhami karakterizohet me një donacion të veçantë të tokës (P.K. 642, 2.023 m2) nga një familje bujare dhe me vetëdije të lartë fetare të Sllatinës. Dhurimi

dhe solemnizimi i kësaj toke ka ndodhur më 8.05.2018, 09:30 h. Dedikimi i dhuruesit është zbatuar sipas procedurave zyrtare dhe normave të dispozitave të sheriatit islam.

Xhamia e re në fshatin Sllatinë premtion një defokusim të mendimeve radikale dhe të kuptimit të situatave të reja me plot marrëveshje dhe dialog në çdo segment të jetës sonë. Ky tempull islam shpresojmë të shërbejë për brezin e ri, që do të rritet dhe do të edukohet në frymën fetare dhe kombëtare, duke ruajtur të gjitha tiparet kulturore, shkencore, intelektuale dhe ekonomike të vakëfit shqiptar në Sllatinë dhe në vendbanimet përreth.

Sllatina sot, me hapjen e xhamisë së re, e determinon ardhmërinë e saj.

Ta gëzojnë të gjithë sa është jeta në këtë botë!

*(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e BFI-Tetovë)*

# PRILEP: VIHEN THEMELET E XHAMISË SË DEBRESHTIT



Më 29 mars, 2022, në vigjilje të Ramazanit të bekuar, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në ceremoninë e hedhjes së gurit themeltar të xhamisë së re në fshatin Debresht, komuna e Dollnenit, pjesë e Myftinisë së Prilepit, thuhet në njoftimin e BFI.

Myftinia e Prilepit, e udhëhequr nga Myftiu h. Shefket ef. Imeri, kishte organizuar një ceremoni rasti mjaft domethënëse. Programin e udhëhoqi Sekretari i Myftinisë së Prilepit, z. Muhamed ef. Gaziu. Nisja e xhamisë së re ishte gëzim i madh për banorët e këtij fshati dhe kjo vërehej te të gjithë të pranishmit.

Reis'ul-Ulemanë e shoqëronin Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Sekretarit i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Kryetari i Kuvendit të BFI h. Fejsal ef. Kadriu, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni, imamë dhe hoxhallarë. Në mesin e mysafirëve ishin edhe Kryetari i Komunës së Dollnenit, z. Urim Ibeski, dhe Atasheu për Çështje Fetare i Ambasadës së Turqisë në Shkup, z. Mustafa ef. Me-

sten etj.

Fillimisht, të pranishmit i përshëndeti Myftiu h. Shefket Imeri, i cili para të pranishmëve tregoi për iniciativën, si dhe për rezultatet tjera të Myftinisë.

Në fjalën e tij të rastit, Reis'ul-Ulema përsëritte iniciativën, si dhe aktin e hedhjes së gurthemelit. Ai uroi iniciatorët dhe mbështetësit dhe foli për rolin e xhamisë në jetën e besimtarëve e më gjerë.

Duanë e bëri Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, thuhet në njoftimin e BFI.

“Me kënaqësi iu përgjigja ftesës së nikoqirit të ceremonisë, Myftiut të Prilepit h. Shefket ef. Imeri, ku pata nderin që të bëj duanë me rastin e nisjes së Xhamisë. I lutem Allahut të Madhërishtëm që dyert e kësaj xhamie të re të hapen shumë shpejt dhe të jetë në shërbim të besimtarëve të kësaj ane”, ka shkruar në faqen e vet në Facebook, të njëjtën ditë, Myftiu i Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Pas nisjes së xhamisë së re në De-

bresht, një njoftim publik ka bërë edhe hoxha Bashkim ef. Aliu, me punë dhe qëndrim në Zvicër. Është ndjenjë e veçantë kur sheh se ngrihen fortësia të kërtilla të mbrojtjes së identitetit të popullatës myslimane në këto anë, larg territoreve ku shqiptarët dhe myslimanët janë shumicë në Maqedoninë e Veriut. Reis'ul-Ulema Shaqir ef. Fetahu dhe Myftiu i Prilepit, Shefket Imeri, më përshëndetën në veçanti edhe mua si imam nga diaspora, me çka treguan respekt për diasporën. Në këtë eveniment më shoqëroi dr. Afrim Osmani, profesor në Universitetin e Tetovës, me të cilin kemi koordinuar ndërtimin e tri shtëpive për nevojtarë në fshatin Cërnilisht dhe Debresht, rrethina e Prilepit, ka theksuar hoxhë Bashkim ef. Aliu me shërbim në Zvicër.

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut në platformat e saj elektronike në kohë reale ka bërë transmetim të drejtpërdrejtë të ceremonisë së nisjes së xhamisë së re në Debresht.

## “TATAR SINAN PASHA” ME DRITA

Muaji i Ramazanit është reflektimi më i mirë për të kuptuar mungesat dhe sfidat që sjell jeta. Ai është i njohur për solidaritetin dhe për pastërtinë e tij njerëzore dhe ne duhet të jemi edhe më pranë njërit-tjetrit me vepra të mira, ka shkruar Myftinia e BFI-Kumanovë më 1 prill, 2022.

Duke e pasur parasysh xhaminë e Ku-

manovës “Tatar Sinan Pasha”, si një xhami me status: Monument Historik i Kulturës Islame, Myftinia e Kumanovës ka kërkuar nga Komuna e Kumanovës që të bëhet ndriçimi i saj, për të treguar edhe më tepër bukurinë që ka. Komuna e Kumanovës iu përgjigj kërkesës sonë dhe, me fillimin e muajit të Ramazanit, janë vendosur reflektorë përreth Xhamisë.

Prandaj, në emër të Myftinisë së Kumanovës dhe në emrin tim personal, e falënderoj Komunën e Kumanovës për këtë hap shumë të qëlluar, ka deklaruar Myftiu Abedin ef. Imeri.

Le të na shoqërojë të gjithëve mëshira e Allahut dhe falja e Tij! Ves-selamualejkum! – thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

# PËRKUJTIM PËR ULEMATË E TETOVËS

Një aktivitet i përbashkët Myftini - Komunë e Tetovës ishte dhe Akademia solemne në sallën e Këshillit Komunal, që u mbajt më 17 prill, 2022, me rastin e përkujtimit të ulemave të Tetovës, thuhet në njoftimin e Myftiut prof. dr. Qani ef. Nesimi.

Programi i këtij manifestimi filloi me leximin e pjesëve nga Kurani fisnik, të deklamuara nga Referenti për arsim fetar pranë Myftinisë së Tetovës hfz. Abdurahim ef. Murati.

Të pranishëm në këtë akademi ishin: Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Kryetari i Komunës së Tetovës prof. dr. Bilall Kasami, myftinjë e mëparshëm: h. Alifekri ef. Esati dhe mr. hfz. Nexhadi ef. Limani, filantropi i madh shqiptar me përmasa globale haxhi Lazim Destani, Kryetari i Këshillit Komunal z. Besar Durmishi, përfaqësuesi i Universitetit të Tetovës prof. dr. Ibish Ka-

driu, hoxhallarë, profesore e profesorë, afaristë, anëtarë të Myftinisë, kolegë të Myftinisë, përfaqësues të Komunës, si dhe familjarë të hoxhallarëve.

Në këtë manifestim, të cilin e moderoi Shefi i Kabinetit të Myftiut, mr. Xhemil ef. Sadiki, fjalë përshëndetëse kishin Kryetari i Komunës së Tetovës dhe Myftiu. Myftiu i Tetovës e vlerësoi lart bashkëpunimin ndërmjet Myftinisë së Tetovës dhe Komunës së Tetovës, bashkëpunim ky që tanimë ka shkuar në tetë vite të plota. Në fund të fjalimit Myftiu falënderoi Komunën, familjarët e hoxhallarëve dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në organizimin e kësaj ngjarje.

Pikë e veçantë e kësaj akademie ishte edhe leximi i biografive të personalitetve fetare dhe kombëtare të trojeve tona nga ana e studentëve të FSHI-së. Biografia e Alifekri ef. Esatit u lexua nga moderatori, ndërsa në vazhdim studentit

Nafi Asani lexoi biografite e hoxhallarëve: hfz. Afet ef. Limani, Haki ef. Agushi, Abdylhamit ef. Abdullahu, Zeqirja ef. Jakupi.

Studenti Rahim Adili lexoi biografite e hoxhallarëve: hfz. Setki ef. Selmani, Nuredin ef. Ahmed, Naim ef. Ferati, hfz. Elmaz ef. Qamili, hfz. Hamdi ef. Mehdiu. Studenti hfz. Muhamed Memeti lexoi biografite e hoxhallarëve: hfz. Ibrahim ef. Sherifi, Nafi ef. Nesimi, hfz. Xhemil ef. Xhemili, hfz. Ejup ef. Osmani, Bari ef. Shaqiri. Studenti Enes Hasani lexoi biografite e hoxhallarëve: Hamdi ef. Hoxha, hfz. Naxhi ef. Izairi, Mesud ef. Baftijari, hfz. Idris ef. Useini, Taxhedin ef. Zendeli.

Më pas, nga ana e Myftiut dhe nga ana e Kryetarit të Komunës u bë dorëzimi i mirënjohjeve, të cilat i morën familjarët e hoxhallarëve të nderuar, thuhet në njoftimin e Myftiut prof. dr. Qani ef. Nesimi.

## PËRFUNDOI KUIZI “MENDO DHE FITO”

Më 29 prill, 2022, 28 Ramazan 1443 H, pas namazit të teravisë, në Sallën e Objektivit për Shërbime Fetare dhe Sociale u mbajt finalja e kuizit “Mendo dhe fito”, organizuar nga Myftinia e Tetovës, thuhet në njoftimin e Myftiut të Tetovës Qani ef. Nesimi.

Pjesëmarrës të kuizit ishin nxënëse e nxënës që e ndjekin mësimbesimin fetar në mejtepet e xhamive të Tetovës me rrethinë.

Prej 21 prillit, në katër net, pas shtatë rubrikave, fituese e Kuizit u shpall nxënësjja Shefkinaz Halimi (Xhamia e Pashës) me 64 pikë. Vendi i dytë i takoi nxënëses Sumeja Asani (fshati Debërcë) dhe nxënësit Agon Kamberi (Xhamia Kadi Çeshme) me nga 61 pikë. Në vendin e katërt u radhit nxënësjja Lindihana Azizi (fshati Siniçan) me 54 pikë.

Për finalistët-fitues pati edhe shpërblime, të cilat i ndau Referenti për kulturë pranë Myftinisë së Tetovës, dr. Hysein ef. Rizai. Për pjesëmarrësit në finale po ashtu u ndanë disa dhurata dhe mirënjohje nga ana e Drejtorit për Diasporë në BFI dr. Selver ef. Xhemili, nga Prodekani i FSHI dr. Muaz ef. Agushi dhe nga Drejtori për Kulturë në BFI Musanif ef. Rufati.

Në natën finale të pranishëm ishin hoxhallarë, profesorë, profesoresha, xhe-



matë, si dhe Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi.

Komisioni i natës finale përbëhej nga: hfz. Bekim ef. Demiri, Imam në Xhaminë e Dardanisë dhe mësues i lëndës Etika e Religjioneve; Xhelal ef. Xhemili, Imam në fshatin Sellarcë; Basri ef. Iljazi, Imam në Xhaminë Qendrore të fshatit Pallçisht; dhe Suad Demiri, mësues i lëndës Etika e Religjioneve. Moderator i Kuizit ishte Nafi Asani, student i Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup.

Finalen e kuizit “Mendo dhe fito” e shpalli të hapur Myftiu i Myftinisë së Te-

tovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, i cili kishte dhe fjalën përshëndetëse.

Në natën finale pati lexim Kurani nga nxënësi i Medresesë Isa Beu, Shkup, Nazif Sinani, këndim ilahish dhe lexim poezish në interpretim të nxënësve të mejtepeve të Xhamisë së Rinisë, të Xhamisë së Çarshisë së Epërme, të xhamisë së fshatit Llërcë, të xhamisë së fshatit Strimnicë dhe të xhamisë së fshatit Grupçin.

Kuizi u ndoq me interesim të madh nga qindra besimtarë dhe besimtare nga Tetova me rrethinë, thuhet në njoftimin e Myftiut të Tetovës Qani ef. Nesimi.

# “MBRËMJE KURANORE-26” NË LABËNISHT



Më 25 prill, 2022, në fshatin Labënisht (Labunisht) të Strugës u mbajt "Mbrëmja Kuranore e Ramazanit", thuhet në njoftimin e BFI.

Manifestimi u organizua nën patronazhin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, udhëhequr nga Myftinia e Strugës në krye me Myftiun mr. Salim ef. Sulejmani, në bashkëpunim me imamët dhe këshillat e xhamive të fshatit Labënisht.

Ishin të pranishëm Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Ohrit Samet ef. Ajdari, Myftiu i Korçës Ledian ef. Cikalessi, Prodekani i FSHI prof. dr. Muaz Agushi, drejtorë të sektorëve të ndryshëm të Rijasetit, përfaqësues të organizimit të jetës fetare, si dhe anëtarë të Komisionit të Ramazanit, të udhëhequr nga Drejtori i Sektorit Fetar-

Arsimor prof. Jusuf ef. Zimeri.

Të pranishmit i përshëndeti Myftiu i Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani. Më pas fjalën e mori Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili përshëndeti të pranishmit dhe uroi Myftininë dhe këshillat e xhamive të fshatit Labënisht për vazhdimësinë e Mbrëmjeve Kuranore, të cilat qe 26 vjet me radhë po mbahen në këtë fshat.

Më pas programi vazhdoi me lexuesit e Kuranit, të cilët freskuan zemrat me zërat e tyre të ëmbël.

Vlen të potencohet se leximi i Kuranit nisi me mysafirin special nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Shejh Abdullah Abdulkerim Ez-Zer'unin.

Këshilli i xhamive të fshatit Labënisht ndau mirënjohje për Reisin, për Myftininë dhe për lexuesit e Kuranit, për kontributin e tyre në organizimin e kësaj

mbrëmje madhështore.

Në fund u shtrua edhe iftari tradicional për mysafirët e pranishëm. Në namazin e teravisë Komisioni i Ramazanit u shpërnda nëpër xhamitë e vendit, ku falën namazin dhe mbajtën ligjëratat, thuhet në njoftimin e BFI.

"Prezencë masive e besimtarëve në xhamitë e Labënishtit", ka shkruar të njëjtën ditë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

"Mbrëmja Kuranore e Ramazanit" u organizua pas iqindisë në Sallën Sportive të Labënishtit, ka njoftuar Myftiu i Myftinisë së Strugës Salim ef. Sulejmani në rrjetet sociale.

Gjatë ditës, në kohë reale, BFI e RMV në platformat e saj elektronike bëri transmetim të drejtpërdrejtë nga ky manifestim i Ramazanit.

## STRUGA ME TRI VAKËFE TË REJA

Më 25 prill, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në ceremoninë e lëshimit në përdorim të tri vakëfeve të reja në Myftininë e Strugës, thuhet në njoftimin e BFI.

Vakëfet janë në Strugë, në Dollogozhdë dhe në Labënisht (Labunisht).

Në këtë ngjarje historike të pranishëm ishin shumë mysafirë nga vendi dhe jashtë, të cilët u pritën krahëhapur nga Myftiu i Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani, me bashkëpunëtorë.

Pas hapjes së vakëfit të parë në Strugë nga Reis'ul-Ulemaja, nga Myftiu Salim Sulejmani dhe nga Kryetari i Komunës së Strugës z. Ramiz Merko, Delegacioni shkoi në Dollogozhdë dhe bëri hapjen e

vakëfit të ri edhe në këtë fshat.

Në fjalimet e tyre Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani falënderuan të gjithë ata që kontribuan në ndërtimin e këtyre ndërtesave të vlefshme, të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve, përkatësisht të besimtarëve. Kreu i BFI potencoi se vakëfet janë e ardhmja ekonomike e organizimit të jetës fetare, andaj duhet dhënë rëndësi të veçantë traditës së vakëfit.

Myftiu i Strugës në emër të BFI e falënderoi Kryetarin e Komunës së Strugës, z. Ramiz Merko, për përkrahjen e madhe që i jep Myftinisë së Strugës.

Zoti i shpërbleftë me të mirat e Tij të gjithë ata që kontribuan dhe që kontri-

buojnë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e vakëfeve, thuhet në njoftimin e BFI.

"Një ditë e veçantë për Strugën me hapjen zyrtare të tri vakëfeve. Gjatë ditës së sotme, 25 prill, 2022, Myftinia e Strugës bëri hapjen zyrtare të tri objekteve-vakëf në qytetin e Strugës, në fshatin Dollogozhdë dhe në fshatin Labënisht. Vërtet një ditë e veçantë për besimtarët e Strugës dhe të fshatrave të përmendur. Myftinia e Strugës falënderon tejmase të gjithë ata që kontribuan në ndërtimin e këtyre objekteve, të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve të Strugës. Zoti i shpërbleftë me të mirat e pakufishme të Tij", ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Strugës, Salim ef. Sulejmani, në Facebook.

# “U BINDA SE JEMI NJË POPULL I VYESHËM”

**Mbresa nga vizita zyrtare në Slloveni dhe në Itali**

Para disa ditësh u kthëm nga vizita zyrtare në Slloveni dhe në Itali. Përjetuam disa ditë bashkë me bashkatdhetarët tanë atje. Ishte kënaqësi të jesh në mesin e tyre.

Me gjithë përmallimin për vendlindjen, ata gjejnë forcë të tregojnë se janë të lumtur dhe të japin buzëqeshjen. Hetova se nuk e kanë problem dhe janë kalitur të punojnë atje larg, sepse ata janë të aftë dhe të moralshëm për t'i tejkaluar të gjitha sfidat e një shoqërie të huaj për ta.

Por, përsëri, e duan vatanin e tyre; shpresojnë se një ditë do të formohen kushte për të dhënë gjithçka për t'u kthyer tek ai.

U binda se jemi një popull i vyeshëm. Tashmë janë të kyçur në pozicione të ndryshme, si menaxher në sfera të profesioneve të shumta, tashmë kanë formuar imazhin e një populli të moralshëm e të zgjuar, të aftë të udhëheqin veprimtari të mëdha, të marrin lëvdata, mirënjohje, dekorata, çmime të larta dhe të jenë popull serioz.

Vizita e jonë u dha një disponim të veçantë, sikur morën një përkrahje të fuqishme, sikur kuptuan se dikush qëndron prapa tyre, për të qenë në shërbim të tyre. Sa të lumtur ishin në prezencë me ne. Pyesin për gjithçka, interesohen për besimin e tyre, për kombin dhe vatanin e tyre. Pyesin për zhvillimin e vendit tonë dhe a ka shpresë për një rikthim në vendlindje. 'Asgjë s'është e pamundur' - iu them. 'Duhet të besojmë në ardhmëri më të mirë.'

Biseduam për jetën e tyre, për të arri-



turat dhe sukseset e tyre në sfera të ndryshme. 'Po të kemi pak më tepër kushte, edhe te ne mund të arrijmë shumë' - na thoshin.

Kjo më jep edhe më tepër të besoj se duhet të bëjmë shumë për vendlindjen në të gjitha sferat, në veçanti në atë ekonomike. Mund të bëjmë. Si kanë mundur të bëjnë kombet tjera. Edhe ata janë njerëz. Tani kemi universitete me fakultete të sferave të ndryshme. Hapësirë të madhe për dije, për shkencë dhe profesionalizim. Bashkëpunimi me botën e zhvilluar është i mundshëm dhe mund të japë rezultate. Nuk kemi të drejtë mos të besojmë tek ardhmëria, nuk kemi të drejtë mos të kemi guxim; nuk kemi të drejtë mos të kemi kontinuitet në zhvillimin tonë; nuk kemi të drejtë të mos kemi ide etj.

Humbja e shpresës është vesi më i shëmtuar që mund të na prekë. Nuk duhet lejuar këtë.

Për këtë shkak, pranuan ftesat për t'i vizituar ata. Sa të lumtur mbetën që ne të

jemi përkrah tyre. Ne iu premtuam se do të jemi me ta në çdo moment, sepse ua kemi borxh, si faktor jo vetëm i jetës fetare në diasporë, por edhe në vendlindje. Me pritjen që na e bënë, edhe një herë treguan dhe dëshmuar respektin ndaj BFI të RMV, ndaj vendlindjes dhe ndaj vatanit të tyre.

Në fund, në emër të delegacionit që udhëhoqa, i shoqëruar nga dr. Selver ef. Xhemaili, Drejtor për Diasporë dhe mr. Salim ef. Sulejmani, Myftiu i Myftinisë së Strugës, njëherësh edhe anëtarë të Rijasetit të BFI të RMV, iu shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë jo vetëm për pritjen madhështore dhe vëllazërore, por edhe për gjithçka që bëjnë në vendet ku punojnë, si dhe për kontributin që e japin në vendlindje në sfera të ndryshme.

Zoti i bekoftë.

**Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu**  
(27.03.2022)

## ALKIG, ME NDIHMA PËR BAJRAM

Në prag të festës së madhe të Fitër-Bajramit, më 1 maj, 2022, u zhvillua aksioni humanitar "Shporta e Ramazanit 2022" - donacion nga fondacioni bamirës pranë ALKIG (Komuniteti Mysliman Shqiptar në Austri), në bashkëpunim me organizatën humanitare 'Hilal', e cila vepron në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Vlen të theksohet se programi humanitar "Shporta e Ramazanit 2022" parasheh shpërndarjen e produkteve të ndryshme, të nevojshme për familjet e skamnorëve dhe atyre në nevojë, me qëllim që mos të kenë mungesë ushqimesh gjatë këtyre ditëve festive të Fitër-Bajramit. Me këtë rast, falënderim i veçantë shkon për të gjithë donatorët, dhe posaçërisht për Kryesinë e ALKIG në krye me Kryetarin Vahidin ef. Beluli. Komuniteti Mysliman Shqiptar në Austri, si gjithmonë, edhe këtë vit dëshmoi zemërgjerësinë e vet, thuhet në njoftimin e BFI.



# REZULTATET E REGJISTRIMIT TË POPULLSISË 2021

Enti Shtetëror i Statistikës i Republikës së Maqedonisë së Veriut më 30 mars, 2022, ka shpallur rezultatet e Regjistrimit të popullsisë të vitit 2021. Sipas njoftimit që ka publikuar në ueb-faqen e vet Enti Shtetëror i Statistikës, më 5 shtator 2021 numri i përgjithshëm i popullsisë rezidente në RMV ka qenë 1.836.713 banorë. Prej tyre 50.4% janë gra dhe 49.6% burra.

Sipas deklarimit të përkatësisë etnike, 58.44% të popullsisë janë deklaruar si maqedonas, 24.30% si shqiptarë, 3.86% si turq, 2.53% si romë, 0.47% si vllleh, 1.30% si serbë dhe 0.87% si boshnjakë etj.

Sipas përkatësisë fetare, 46.14% janë deklaruar si ortodokosë (православни), 32.17% si myslimanë (Islam), 0.37% si katolikë, ndërsa në këtë Regjistrim janë paraqitur edhe bashkësi të tjera religjioze, të cilat nuk kanë qenë në regjistrimet e mëparshme dhe ato janë: të krishterë evangjelistë-protestantë, agnostikë, budistë etj.

Për nga gjuha, 61.38% janë deklaruar se gjuhë amtare e kanë gjuhën maqedonase, 24.34% gjuhën shqipe, 3.41% gjuhën turke, 1.73% gjuhën rome, 0.17% gjuhën vllahe, 0.61% gjuhën serbe dhe 0.85% gjuhën boshnjake.

Numri i amvisërive është 598.632,



ndërsa mesatarja e numrit të anëtarëve në një amvisëri (bashkësi familjare) është 3.06.

Në kuadër të Regjistrimit 2021 ishte mundësuar që qytetarët e RMV që jetojnë dhe qëndrojnë jashtë vendit më shumë se një vit të veteregjistrohen përmes ueb-aplikacionit, që ka qenë me qasje në ueb-faqen e Regjistrimit. Këtë mundësi e kanë shfrytëzuar 258.932 bashkatdhetarë tanë, prej të cilëve 24.55% janë deklaruar si maqedonas, 66.42% si shqiptarë, 4.78% si turq etj. Kjo kategori e qyteta-

rëve nuk hyn në numrin e përgjithshëm të popullsisë rezidente të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Drejtor i Entit Shtetëror të Statistikës është Apostoll Simovski (1961). Zëvendësudrejtor: Ilmi Selami (1972).

Burimi: [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)

Vështrim: Përqindja e deklarimit fetar shkon deri në 78,68%. Thua, ato që quhen bashkësi të reja religjioze (fetare) të marrin njëherësh 21,32%! Pak si e çuditshme. Më saktë, një temë për analiza të mëtejshme. (n. z.)

## BFI, KUNDËR DUKURIVE NEGATIVE NË SHOQËRI

Organizata Porta e Hapur për Veprim kundër Dhunës dhe Trafikimit me Qenie Njerëzore realizoi më 29 mars, 2022, një takim me Drejtorin e Punëve të Jashtme të BFI, mr. Mustafa Dauti, thuhet në njoftimin e BFI.

Projekti i organizatës Porta e Hapur është hulumtues dhe është me temë "Eksplorimi i kontekstit socio-ekonomik të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm".

Bashkësia Fetare Islame e RMV, si gjithmonë, ka treguar gatishmërinë, ka marrë pjesë aktive dhe ka ofruar ndihmën e saj kundër çdo dukurie negative që ka të bëjë me shoqërinë në përgjithësi.

Në këtë takim prezent ishin prof. dr. Nenad Taneski, hetues kryesor në pro-



jektin "Eksplorimi i kontekstit socio-ekonomik të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm" dhe prof. dr.

Metodija Dojčinovski, asistent-studiuues në të njëjtin projekt, thuhet në njoftimin e BFI.

## TAKIM ME MINISTRIN E ARSIMIT JETON SHAQIRI

Më 31 mars, 2022, vizituam Ministrin i Arsimit dhe të Shkencës në Qeverinë e RMV, z. Jeton Shaqiri, ku patëm një pritje të ngrohtë dhe në nivel të lartë, ka shkruar Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook.

I shoqëruar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Irsal Jakupi dhe nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Islame prof. dr. Shaban Sulejmani, së pari i uruam detyrën e re si Ministër i Arsimit dhe biseduam për shumë çështje që kanë të bëjnë me kërkesat e BFI të RMV. Dekani i FSHI bisedoi në lidhje me Fakultetin dhe për sfidat me të cilat ballafaqohen.

Ministri z. Jeton Shaqiri premtoi se



do të bëjë çmos që të jetë në shërbim të zhvillimeve dhe të kërkesave të reja dhe për një bashkëpunim të ndërsjellë. I fa-

lënderuam shumë për pritjen e bërë, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (2.04.2022)

## BURHAN SHABAN NË BFI



Më 25 mars, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, realizoi një takim me personalitetin e

mirënjohur të vlerave fetare kulturore islame, hafëzin Burhan Shaban, i cili është nga Shkupit, por me aktivitete qëndron më tepër në Bosnjë dhe në Turqi, si konsulent i korporatave të ndryshme prodhuese në nivel ndërkombëtar, pasi që zotëron 9 gjuhë të huaja. Është kuadër nga vendi ynë, hafëzi i Kuranit famëlartë, doajen i ilahive në të gjitha gjuhët e Ballkanit e më gjerë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në Maqedoninë e Veriut me zërin e tij të bukur ka lënë gjurmë të pashlyera në krijimin e ilahive të bukura dhe shumë të njohura, ndërsa në Bosnjë ka krijuar një numër të madh ilahish të cilat i kanë dhënë ngjyrë dhe shije kulturës ballkanike islame, me çka ne në Maqedoni të Veriut jemi të nderuar.

Burhan Shaban është një ekspert i njohur i manifestimeve kulturore, andaj me të Reis'ul-Ulemaja bisedoi për një bashkëpunim në këtë sferë. Njëkohësisht, në emër të BFI të RMV i dorëzoi një mirënjohje, duke e falënderuar për respektin. Zoti e bekoftë – thuhet në njoftimin e BFI.

## CERTIFIKATË NGA 'SHARJAH' PËR ELJESA HASANIN

Një lajm i bukur për Bashkësinë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë muajit të bekuar të Ramazanit: nga Akademia e Kuranit Fisnik të Universitetit Sharjah (Emiratet e Bashkuara Arabe) hafëzi i njohur nga Gostivarit dhe udhëheq me Institutin e Hifzit dhe të Bukurleximit të Kuranit "Hfz. Hasan ef. Zendeli" në Gostivar. Aty ai u jep leksione gjeneratave të reja për mësim dhe bukurlexim të Kuranit, sepse leximi i Kuranit është prej adhurimeve të

Hfz. Eljesa Hasani është ndër hafëzat më të njohur në bukurlexim të Kuranit Fisnik në vendin tonë. Ai punon si imam në Bashkësinë Fetare Islame - Myftinia e Gostivarit dhe udhëheq me Institutin e Hifzit dhe të Bukurleximit të Kuranit "Hfz. Hasan ef. Zendeli" në Gostivar. Aty ai u jep leksione gjeneratave të reja për mësim dhe bukurlexim të Kuranit, sepse leximi i Kuranit është prej adhurimeve të

mëdha dhe ai që e lexon atë, ka vlerë të madhe tek Allahu Fuqiptotë.

Efendi Hasani me zërin e tij të bukur ka qenë pjesëmarrës dhe fitues në shumë gara kombëtare dhe ndërkombëtare në bukurlexim të Kuranit Fisnik. Ai po ashtu është aktiv dhe udhëheq me Korin e Bashkësisë Fetare Islame, thuhet në njoftimin e BFI.

# IMER EF. ALILI, IMAM NË EFFRETIKON

Teologu i mirënjohur Imer ef. Alili vazhdon misionin e tij në Zvicër: më 29 prill, 2022, ai u prit në Rijaset nga Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Imer ef. Halili është nga Debreshi (Gostivar), Imam dhe ligjërues i gjertanishëm në Xhaminë e Rinisë në Gostivar dhe njëri ndër themeluesit, si anëtar, i Korit të Myftinisë së Gostivarit.

Tani e tutje ai është caktuar imam i rregullt në Effretikon (Kanton Zürich,

Zvicër), ku do të jetë në shërbim të bashkatdhetarëve tanë. Gjata kohës së Reis'ul-Ulemasë si Myfti në Gostivar, h. Imeri ka qenë njëri ndër bartësit kryesorë në zhvillimin dhe reformat e Myftinisë, ligjërues dhe orator i njohur, anëtar i Kryesisë së Myftinisë, si dhe përfaqësues i Myftinisë në shumë vende. Ka qenë arsimtar i lëndës fetare në shkollën fillore "Bashkimi" në Gostivar dhe njëherësh është i diplomuar edhe në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë.

Për BFI-në do të jetë një zbrazëti e

madhe, por edhe në Zvicër do të jetë një shpjegues i mirëfilltë i Islamit. Me këtë rast, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e falënderoi shumë për kontributin e tij të palodhshëm si kuadër i BFI-së dhe i uroi punë të mbarë.

Në fund, në shenjë respekti për punën e madhe që ka bërë në shpjegimin e Islamit dhe në organizimin e jetës fetare islame në vendin tonë, Reis'ul-Ulemaja e dekoroi me një mirënjohje, si përkrahje edhe për angazhimin e tij në Zvicër, thuhet në njoftimin e BFI.

## ELVIRA HALIMI MERR CERTIFIKATËN E HIVZIT

Edhe një lajm i mirë për Bashkësinë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë muajit të bekuar të Ramazanit nga Akademia e Kuranit Fisnik e Universitetit Sharjah (Emiratet e Bashkuara Arabe): hafëzja Elvira Halimi nga Tetova ka marrë Certifikatën e HIVzit, që na bën krenarë të gjithëve, thuhet në njoftimin e BFI.

Certifikata (diploma, ixhazeja) është marrë më 18 prill, 2022, pas ndjekjes online të mësimëve në këtë akademi. Ixhazeja është marrë për Kiraetin Hafz an Asim (Hifz).

Hafëzja Elvira Halimi është ish-medresante e Medresësë Isa Beu dhe aktualisht studente në Universitetin Al-Qasimia në Sharjah, EBA. (19.04.2022)

## URIME PËR DITËN E ROMËVE

"Me rastin e 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve, kam nderin e veçantë që në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, si dhe në emrin tim personal, të gjithë pjesëtarëve të komunitetit rom të vendit tonë t'ua uroj këtë festë, me dëshirë që ky komunitet, si të gjithë komunitetet tjera, t'i gëzojë të gjitha të drejtat dhe vlerat që i takojnë një shoqërie bashkëkohore – thuhet në urimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Urimi është shkruar në gjuhën rome, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase. (8.04.2022)



## KREU I BFI-së URON "SHKUPIN"

"FC Shkupi - kampion i Maqedonisë e Veriut në futboll. Një gëzim i madh për këtë të arritur, edhe atë mu në muajin e bekuar të Ramazanit. Inspirim i vërtetë dhe i gjallë se me një punë me përkushtim dhe strategji, arrihen rezultate në çdo sferë të jetës. Urime Shkupi. Urime të gjithëve.

Qofshit të bekuar dhe suksese në arenën ndërkombëtare", thuhet në urimin e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, drejtuar FC Shkupit pas marrjes së titullit: Kampion i Republikës së Maqedonisë së Veriut në futboll. (24.04.2022)

# KONKLuzionet e Mbledhjes së Rijasetit

Rijaseti i BFI të RMV në mbledhjen e vet të mbajtur më 23.03.2022, duke debatuar mbi Programin për përgatitjet për muajin e Ramazanit, nxori këto konkluzione:

1. Muaji i Ramazanit fillon më 2.04.2022, që do të thotë se dita e shtunë do të jetë dita e parë e agjërimit të muajit të Ramazanit;

2. Rijaseti i BFI të formojë komisione për vizita në vend dhe jashtë, ndërsa Myftinitë me programet e tyre të mbulojnë gjithë territorin e tyre;

3. Të organizohen tribuna shkencore në nivel të Rijasetit dhe të Myftinive të BFI të RMV;

4. Të realizohen emisione në TV qendrore dhe lokale;

5. Realizim i vizitave nga Komisioni republikan në të gjitha Myftinitë, ku do të flitet apostafat për jetën fetare në nivel të Myftinive dhe të Rijasetit të BFI të RMV;

6. Angazhimi i studentëve dhe i nxënësve nëpër xhami si ndihmës apo me detyra sipas nevojës;

7. Organizimi i manifestimeve të ne-tëve të vlefshme gjatë muajit të Ramazanit;

8. Sadekatul-Fitri është i obligueshëm të jepet ekskluzivisht në fondin e medreseve dhe në këtë vit, me qëllim të transparencës, të dhënat do të publikohen në faqen e BFI të RMV;

9. Sasia e Sadekatul-Fitrit, kategoritë e tij, mbeten të njëjta si viteve të kaluara: më e ulëta 150 denarë, pastaj 200 denarë,

në vijim 300 denarë, duke e shtuar dhe kategorinë e parë - 400 denarë;

10. Nisabi i Zeqatit do të jetë 91.6, që në mjete financiare është: 5.141.- euro;

11. Objektet fetare, xhamitë dhe vendet tjera, të përgatiten me të gjitha kushtet normale, si: pastërtia dhe siguria, që ritet fetare të kryhen në mënyrë sa më të qetë dhe komode.

12. Rijaseti i BFI të RMV ua uron të gjithë besimtarëve muajin e bekuar të Ramazanit, duke lutur Allahun Fuqiptotë që t'ju japë shëndet të plotë, iman të paluhatshëm dhe agjërimit të këndshëm e të pranuar.

Zoti ju bekoftë.

Rijaseti i BFI të RMV  
(25.03.2022)

## REISI: NJË VIT I SUKSESSHËM

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 24 mars, 2022, në faqen e vet në Facebook ka shkruar:

"Një vit i suksesshëm. Rijaseti i BFI-së e vlerësoi lart punën dhe kontributin e Myftinive në vitin 2021 dhe unanimisht i miratoi raportet dhe planet e paraqitura. Puna e të gjithë organizmave të BFI-së u vlerësua si mjaft e suksesshme dhe volu-

minoze.

Po ashtu, u debatua dhe u shqyrtua Pasqyra financiare për vitin 2021 dhe Plani financiar i Rijasetit për vitin 2022. Sipas Pasqyrës financiare për vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak, puna financiare e Rijasetit të BFI-së ka një rritje prej 63%, fakt që e tregon punën serioze dhe menaxhimin e suksesshëm me mjetet fi-

nanciare të BFI-së. Sipas Raportit për vitin 2021, numri i planifikuar i kurbanëve u tejkalua për 3.000, si rezultat i një gasjeje më serioze dhe të një pune të përgatitur me kohë.

Pas diskutimeve, unanimisht u miratuan aktet e Mbledhjes dhe të njëjtat, në përputhje me Kushtetutën e BFI-së, i dërgohen Kuvendit të BFI-së për miratim."

## FADIL RAMADANI MERR TITULL SHKENCOR NË FSHI

Më 30 mars, 2022, në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup z. Fadil Ramadani mbrojti temën e specializimit para Komisionit: prof. dr. Shaban Sulejmani, Dekan, mentor i kandidatit; prof. dr. Muhamed Mustafa, Kryetar dhe prof. dr. Ismet Osmani, anëtar, thuhet në njoftimin e BFI.

Fadil ef. Ramadani aktualisht kryen detyrën e Kryetarit të organizatës humanitare "Hilal" të BFI të RMV.

"Arsimi fetar në shkollat publike - kontribues për marrëdhënie ndërkulturore dhe ndërfetare në RMV", titullohet tema e specializimit. Fadil Ramadani me sukses mbrojti temën dhe mori titullin shkencor "Specialist i metodikës së mësimbesimit islam". Ishte një organizim i nivelit të lartë, si dhe prezantim dhe elaborim i mirëfilltë nga kandidati.

Gjatë ceremonisë së specializimit mori pjesë edhe Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqë-



ruar nga bashkëpunëtorët e afërt: Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Kryetari i Kuvendit të BFI h. Fejsal ef. Kadriu, Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim Iseni etj.

Në fjalën e tij përshëndetëse Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu uroi Komisionin për punën organizative dhe

kandidatin për mbrojtjen e shkëlqyer të temës, duke i dëshiruar suksese në jetë, thuhet në njoftimin e BFI.

"Ishte një organizim i nivelit të lartë, si dhe prezantim dhe elaborim i mirëfilltë nga kandidati", ka shkruar të njëjtën ditë në faqen e vet në Facebook Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

# SEMINAR PËR IMAMËT E ZVICRËS



Më 28 mars, 2022, në hapësirat e Qendrës për Konferenca Lilienberg, në Ermtingen të kantonit Thurgau, buzë liqenit të Bodenit, u zhvillua seminari i radhës me imamët e Zvicrës, të organizuar nga Qendra Zvicerane për Islam dhe Shoqëri (SZIG) nga Friburgu, Federata e Organizatave Islame në Zvicër (FIDS), si dhe organizatat tjera etnike, në mesin e të cilave ishte edhe Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër.

Në seminar morën pjesë 22 imamë shqiptarë, turq e boshnjakë, të cilët qe një kohë të gjatë jetojnë dhe veprojnë në Zvicër. Seminari u zhvillua në gjuhën gjermane.

Në fillim të pranishmit i përshëndeti drejtori i SZIG-ut z. Hansjörg Schmid. Pas tij fjalë përshëndetëse pati edhe kryetari i FIDS-it, dr. Montassar BenMrad, si dhe Ministria kantonale nga Thurgau znj. Carmen Haag.

Ligjëratën e parë e mbajti z. Hansjörg Schmid, me titullin «Imamët midis prit-

shmërive shoqërore dhe ndryshimit të rrethit». Fillimisht ai foli për debatin politik dhe mediatic që zhvillohet në Zvicër rreth imamëve. Më pas ai foli për ndryshimin e rolit të imamëve dhe shkarkimin e tyre nga rolet e shumta që ai i ka marrë, ose që i janë vënë përsipër, si pasojë e pritshmërive të ndryshme nga vetë komuniteti mysliman, por edhe nga shoqëria mbarë. Këto role tjetërkund trajtohen si profesione të ndryshme dhe ushtrohen nga persona të tjerë profesionistë. Ai e përfundoi ligjëratën e tij me sfidat që e presin imamin në të ardhmen, duke vënë theks të veçantë në diferencimin e detyrave, si dhe në standardizimin e arsimit të tyre.

Pas një pauze të paradites, në foltore u paraqitën imamët Yusuf Gürgün dhe Sakib Halilović, si dhe Hakan Gören - një i punësuar në Departamentin për Integrim pranë Basel-Landschaftit. Këta folën për përvojat dhe sfidat e tyre si imamë në xhamitë e tyre, ndërsa i treti - për kontaktet e tij me imamët dhe drejtuesit e xhamive

atje.

Në sesionin e pasdites ligjëroi mr. Rejhan Neziri më temë «Predikimi, ligjërimi dhe komunikimi në bashkësi». Ai fillimisht foli për komunikimin nga këndvështrimi psikologjik, për modelet e komunikimit, për elementet parësore të komunikimit, si dhe për pengesat që mund të paraqiten gjatë komunikimit. Më pas ai foli edhe për komunikimin fetar islam, për llojet e predikimit, për mënyrën e përgatitjes pedagogjike të një predikimi, ligjërate ose mësimi fetar në xhami dhe jashtë saj.

Ligjëruesi i fundit ishte dr. Montassar BenMrad, i cili foli për temën «Sfidat e imamëve dhe përfytyrimi i detyrave të tij».

Kjo ishte dita e parë e këtij seminari, ndërsa takimi i dytë do të zhvillohet në shtator 2022.

*Përgatiti: Rejhan Neziri (Shënim: Teksti është shpërndarë edhe nga Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër, DAIGS)*

## SEMINAR ME SHKOLLËN E POLICISË NË “EL-HIDAJE”

Më 30 dhe 31 mars, 2022, në xhaminë “El-Hidaje” në St. Gallen u mbajt seminari dyditor i radhës me aspirantët e Shkollës së Policisë nga qyteti Amrizwil, që përfshin disa kantone të pjesës lindore të Zvicrës, thuhet në njoftimin e xhamisë “El-Hidaje”, St. Gallen.

Qëllimi i seminarit ishte që kandidatët potencialë për policë të njihen me Islamin, me rolin e xhamisë në shoqëri, t’i shikojnë hapësirat e saj dhe të njihen drejtpërdrejt

me disa rrethësi praktike që ndërlihen me punën e tyre në raport me komunitetin e besimit islam.

Në seminar morën pjesë 100 aspirantë, në katër klasa, me 25 pjesëmarrës secila.

Mysafirët i pritën Imami i Xhamisë, h.fz. Mehas Alija, Kryetari i Xhamisë Ejup Emini dhe anëtarët e Kryesisë së Xhamisë. Ata u pritën edhe nga Reha Özkarakash, studiues dhe zyrtar politik për shkollim në rrethinë e qytetit të Cyrihut,

përkatësisht në Pfäffikon.

Në fund, secila klasë kishte përgatitur edhe pyetjet e tyre, në të cilat u përgjigjën Mehas Alija dhe Reha Özkarakash.

Këtë seminar e nderuan edhe policë dhe zyrtarë të tjerë nga Shkolla e Policisë, me në krye drejtorin Marcus Kradolfer.

Prej vitit 2013 deri më sot Seminarin e kanë ndjekur rreth 900 policë, thuhet në njoftimin e xhamisë “El-Hidaje”, St. Gallen.

# KERA HAP TRIBUNËN E SHKUPIT



Më 10 prill, 2022, 9 Ramazan 1443 H, patëm nderin dhe kënaqësinë e veçantë që ta kemi në Shkup, në mesin tonë, teologun e spikator nga Tirana, Hoxhë Vladimir Kera, thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Tribunë që do të mbahet mend. Atmosferë e rrallë në Xhaminë e Re të Çairit (Shkup), atmosferë Ramazani, atmosferë

shpirtërore, që solli freski në zemrat e besimtarëve shkupjanë.

E ndej për obligim që ta falënderoj publikisht z. Vladimir Kera që mori rrugën nga Tirana për në Shkup. Ai na nderoi me pranimin e ftesës për të qenë ligjëruesi i parë i tribunës që organizoi Myftinia e Shkupit në vazhden e aktiviteteve të Ramazanit kushtuar besimtarëve.

Allahu e shpërbleftë me mirësitë e Tij të pakufishme! - thuhet në njoftimin e Myftiut të Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili.

Ishte nder dhe kënaqësi e veçantë për ne të mirëpresim në Shkup teologun e mirënjohur nga Tirana Vladimir Kera, ka shkruar të njëjtën ditë në Facebook z. Bujar Muça nga Myftinia e Shkupit.

## PRITJE PËR GAZETARIN AHMET MEHMETI

Sot pata nderin që në Kabinetin tim të kem gazetarin e famshëm nga Shkupi, z. Ahmet Mehmeti, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 26 prill, 2022.

Ahmet Mehmeti tërë jetën ia kushtoi gazetarisë televizive në TMV2 – Redaksia në gjuhën shqipe. Filloi në kohën më të vështirë, kur shumë pak kishte hapësirë për programe në gjuhën shqipe. Por, z. Ahmet Mehmeti me përkushtim të madh dhe paluhatsëm vendosi baza të fuqishme, që hapi rrugët e hapësirës së

madhe.

Atë që mbaj mend - i pari është që mori guxim që Fjala e Zotit, e Islamit, të jetë pjesë e vlerave të kësaj shtëpie të madhe informative.

Unë si Drejtor i asaj kohe i Sektorit për Shkencë dhe Kulturë, pastaj edhe si Drejtor i Sektorit për Arsim Fetar pranë BFI të RMV, pata një bashkëpunim të fortë dhe më hapi rrugën në paraqitjen time me tema të ndryshme, që më solli përvojën time në media.

Në shenjë respekti dhe mirënjohjeje

për punën e madhe që ka bërë në sferën e kultivimit të vlerave mediale në gjuhën shqipe për të qenë në shërbim të Zotit, të kombit dhe të vatanit, i lutem Allahut Fuqipotë që t’i japë shëndet dhe jetë të gjatë.

Zotëri Ahmet Mehmeti me bindjen e tij të thellë mbi Zotin kreu edhe Haxhin dhe mori titullin Haxhi.

BFI nuk i harron kurrë ata që ditën të kontribuojnë për vlerat institucionale dhe ato islame e kombëtare. Zoti e bekoftë, thuhet në njoftimin e Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

## BFI E ITALISË VIZITON AMBASADORIN MEMEDI

Një delegacion i lartë i Bashkësisë Fetare Islame të Italisë ka vizituar më 26 mars, 2022, Ambasadorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Romë prof. dr. Vesel Memedin, thuhet në njoftim.

Në delegacionin e BFI të Italisë ishin: Kryetari dr. Reshat Ibishi, Nën-kryetari Zudi ef. Fejzuli, Sekretari

Mirsadin Aliji, anëtarët e Kryesisë së xhamisë “Nur-Drita” në Casaloldo (selisë qendrore të BFI të Italisë) - Berat Selimi, Imredin Mehmedi, Kadri Nuredini dhe Suad Jakupi.

Takimi ishte i këndshëm dhe mbresëlënës. Falënderojmë publikisht për mikpritjen dhe modestinë. Ambasadorit

i urojmë suksese në misionin e tij diplomatik dhe jemi të bindur në aftësitë dhe përgatitjet e tij në realizimin e objektivave që ka përpara, thuhet në njoftimin e

Kryesisë së BFI të Italisë. Këtë njoftim e ka shpërndarë në faqen e vet në Facebook Reshat Ibishi.

# AMBASADORI I KATARIT VIZITOI BFI-në

Më 31 mars, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu priti në Rijaset ushtruesin e detyrës Ambasador i Shtetit të Katarit në vendin tonë, Shkëlqesinë e Tij Sheikh Jassim Bin Hamad Al-Thani, i shoqëruar nga Sekretari i Ambasadës, mr. Jassim Bin AbdulKhalik A-Ghamdi, thuhet në njoftimin e BFI.

Fillimisht, Reis'ul-Ulemaja mysafirëve nga Katari u dëshiroi mirëseardhje në BFI, ndërsa më pas i njoftoi me funksionimin e Bashkësisë Fetare Islame dhe të organeve të saj. I njoftoi, po ashtu, edhe me rolin që luajnë Rijaseti, Myftinitë, Kuvendi i BFI dhe institucionet edukativo-arsimore, pastaj me organizimin e jetës fetare islame në vend etj.

Po ashtu, u diskutua edhe për bashkëjetesën, për shumëfishin e vendit, për multietnicitetin, si dhe për respektimin e

demokracisë dhe të lirisë fetare.

Theks i veçantë u vu në rëndësinë e bashkëpunimit institucional mes BFI dhe Ministrisë së Vakëfit të Katarit, me ç'rast Reis'ul-Ulemaja theksoi rëndësinë që ka ky vend dhe rolin e tij në Ballkan, në ngritjen e frymës së tolerancës dhe të paqes në botë.

Shkëlqesia e Tij Sheikh Jassim Bin Hamad Al-Thani falënderoi Kreun e BFI për pritjen e ngrohtë dhe vëllazërore, si dhe vlerësoi lart punën që po bën Bashkësia Fetare Islame dhe bashkëpunimin mes BFI dhe Ministrisë së Vakëfit të Katarit.

Në shenjë mirëseardhjeje në BFI dhe si mirënjohje për bashkëpunimin e mrekullueshëm mes institucionit të BFI-së dhe Ambasadës së Katarit, në prezencën e medias Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef.

Fetahu i dhuroi një pllakat-mirënjohje me Kuran të artë Shkëlqesisë së Tij Sheikh Jassim Bin Hamad Al-Thani.

Në këtë takim Reis'ul-Ulemanë e shoqëronin bashkëpunëtorët e tij të ngushtë – Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi, Drejtori i Sektorit për Bashkëpunim me Botën Arabe h. Ismet ef. Ademi dhe Shefi i Kabinetit dr. Abdylqerim ef. Iseni, thuhet në njoftimin e BFI.

Falënderuam Sheikh Jassim Bin Hamad Al-Thani për vizitën dhe bisedat e zhvilluara, ka shkruar në faqen e vet në Facebook, të njëjtën ditë, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në platformën elektronike të BFI-së është emetuar edhe regjistrimi audioviziv i TV Globit (Gostivar) nga kjo ngjarje.

## SHEJH EZ-ZER'UNI NË VIZITË DISADITORE NË RMV

Më 26 prill, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset Shejh Abdullah Abdulkerim Ez-Zer'unin nga Abu Dhabi (Emiratet e Bashkuara Arabe), i cili qe disa ditë po qëndron në vendin tonë, thuhet në njoftimin e BFI.

Shejh Ez-Zer'uni është një personalitet i mirënjohur, ekspert i leximit të Kuranit famëlartë dhe imam në Xhaminë Qendrore të Abu Dhabit.

Kreu i BFI dhe mysafiri i lartë, të shoqëruar dhe nga Drejtori për Marrëdhënie me Botën Arabe h. Ismet ef. Ademi, biseduan për përshtypjet e mysafirit për vendin tonë dhe për shumë çështje të tjera. Në këtë takim Reis'ul-Ulemaja i dëshiroi mirëseardhje Shejh Ez-Zer'unit dhe qëndrim të këndshëm në ditët e Ramazanit në mesin tonë.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i dhuroi Shejh Abdullah Abdulkerim Ez-Zer'unit pllakatën e artë të Kuranit - simbolin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV.

Vlen të theksohet se prezenca e tij në mesin e besimtarëve ka sjellë një frymë të re. Zoti e bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

“Mysafiri nga Abu Dhabi, Shejh Abdullah Abdulkerim Ez-Zer'uni, do të qëndrojë disa ditë në vendin tonë. Zoti e bekoftë”, ka shkruar në faqen e vet në Facebook Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef.



Fetahu më 26 prill.

Hafëz Abdullah Abdulkerim Ismail Ibrahim Ez-Zer'uni më 26 prill ka qenë mysafir edhe i Myftinisë së Shkupit. I ka prirë xhematit në faljen e teravisë në Xhaminë e Re të Çairit.

“Në emrin tim personal dhe në emër të Myftinisë së Shkupit e falënderoj për zemërsisht për vizitën e tij, për nderin dhe respektin”, ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në faqen e vet në Facebook.

Një xhuma me mysafirin nga Emiratet e Bashkuara: Më 29 prill, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV priti edhe një herë mysafirin e BFI të RMV Shejh Abdullah Abdulkerim Ez-Zer'unin, për t'i shprehur mirënjohje dhe

rrugë të mbarë për në vendin e tij, thuhet në njoftimin e BFI.

Në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulemaja i ndau një dekoratë në gjuhën arabe Shejh Abdullah Abdulkerim Ez-Zer'unit.

Në shenjë respekti, ata së bashku me gjithë drejtorët e sektorëve të Rijasetit të BFI falën namazin e xhumasë në Xhaminë Isa Beu në Shkup, ku patën një pritje të ngrohtë nga imami Hoxhë Muharrem ef. Ismaili dhe nga Këshilli i xhamisë, ku edhe pjesëmarrja masive e besimtarëve nuk mungonte. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI. Një njoftim të njëjtë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu ka publikuar të njëjtën ditë edhe në faqen e vet në Facebook.

TREGIM

# NATA E ZEZË



Një beduin, që jetonte në shkretëtirë, u martua dhe Zoti i dha nëntë djem si drita, me të cilët edhe krenohej.

Nuk shkoi gjatë dhe gruaja mbeti sërisht me barrë dhe në një natë të errët i erdhën dhimbjet e lindjes. Beduini me padurim priste lindjen e djalit të tij të dhjetë, sa që edhe pushkën dhe odën i kishte përgatitur për të festuar.

Sa e dëgjoi zërin e vajit të fëmijës, e kapi armën dhe, duke e shkrepur në shenjë gëzimi, dëgjoi se ajo ishte vajzë dhe, nga pikëllimi, i ra pushka nga dora.

Filloi të bërtiste: *O Nata ime e Zezë! O Nata ime e Zezë!*

Gruan, ndërkaq, pas gjithë ato vuajtje e dhimbje për ta sjellë në këtë botë një vajzë të bukur si hëna, as që donte ta shihte dhe të fliste me të, thuaj se ajo ishte fajtoreshë për gjithë këtë.

E vajzës, edhe pse shndriste si një yll

në errësirën e natës, vendosi t'i vinte emrin Nata e Zezë.

Kur vajza e arriti moshën e martesës, e martoi menjëherë dhe as edhe një herë të vetme nuk shkoi për ta parë.

Djemtë u martuan njëri pas tjetrit dhe secili mori rrugën e jetës së vet. Gruaja i ndërroi jetë dhe beduini mbeti i vetëm. Çdo ditë e më shumë dobësohej nga pleqëria, sa që një ditë edhe u verbua.

Me të dëgjuar vajza e tij se çfarë i kishte ndodhur babait të saj, me vrap shkoi tek ai. Donte ta përqafoste, por e dinte qëndrimin e babait ndaj saj, kështu që pa bërë zë e rregulloi shtëpinë, e kapi për krahu atë dhe e pastroi, ia përgatiti një ushqim të shijshëm dhe pasi hëngrën, plaku iu drejtua: "Po kush je, moj bijë, që u kujdesesh kaq bukur për mua?" Vajza me lot në sy i tha: "Unë jam Nata e Zezë, bija jote, o baba."

Me të dëgjuar plaku këtë, shpërtheu në vaj dhe i kapi duart e vajzës së vet, duke i puthur dhe duke kërkuar falje për marrëzinë e tij që kishte bërë dhe filloi t'i thoshte këto vargje:

*Ah, sikur të gjitha netët të zeza t'i kisha, Se në netët e zeza begatia fshihet. Sikur edhe një herë jetën nga fillimi ta riktheja,*

*Do të doja si kjo vajzë të parin, të dytin dhe të gjithë t'i kisha.*

*Askush përveç saj nuk më vizitoi dhe ndoshta për ta as që ekzistoj.*

*Nëntë burra prindin e tyre e harruan, Kurse një vajzë e vetme me dhembshuri m'u afrua.*

*Si munda që Nëntë net të Zeza aq shumë t'i doja,*

*E Natën time të Bardhë ta urreja?!*

*E solli në shqip: Rijad Imeri*

## TRIBUNË NË IZVOR

“Në emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit.” Më 25 prill, 2022, pas namazit të teravisë kemi organizuar një tribunë në Xhaminë e Re të fshatit Izvor, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Kumanovës.

Tribuna ishte me titull “Edukimi i njeriut dhe roli i tij në shoqëri nga këndvështrimi islam”.

Ligjërues ishte prof. dr. Naser Ramadani, ligjërues në FSHI-Shkup.

Xhamia ishte e vogël për t'i zënë të gjithë xhematlinjtë, të cilët kishin ardhur nga i gjithë terreni e më larg.

Programi u moderua nga Isa ef. Beqiri, ndërsa ilahi kënduan hfz. Sabahudin Nuhiu dhe Abdullah Shaqiri.

Myftiu i Myftinisë së Kumanovës, h. Abedin ef. Imeri, i përshëndeti të pra-



nishmit, duke lutur Allahun e Madhërishtëm që të na e pranojë agjërimin dhe i dëshiroi punë të mbarë tribunës.

Prof. dr. Naser Ramadani dha sqarime të hollësishme rreth edukimit të njeriut, të rolit të edukimit në shoqëri nga këndvështrimi islam, me ç'rast të

gjithë të pranishmit ishin të kënaqur.

Tribuna u mbyll me leximin e disa ajeteve kuranore nga hfz. Sabahudin ef. Nuhiu nga Shkupi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Kumanovës, nënshkruar nga Myftiu Abedin ef. Imeri.



# KARAKTERISTIKAT METODOLOGJIKE DHE TEMATIKE TË AJETEVE MEKASE E MEDINASE



**Nuk ka asnjë tekst të shariatit, as nga Kurani e as nga Sunneti, që përshkruan ngjyrën e mbulesës, përpos disa kushteve, rregullave e gjërave të përgjithshme, të cilat i kanë përcaktuar fukahatë dhe ulematë për hixhabin sipas shariatit: të mos jetë mbulesa e tejdukshme, atraktive, e ngushtë dhe as e hollë. Shejh Abdullah bin Bazi: "Mbulesa e gruas lindore dallon nga mbulesa e gruas perëndimore."**



**Shkruan: Prof. dr. Hajredin Hoxha**

Në vazhdim do të përqendrohemi në disa degë të shkencës së ajeteve mekase e medinase, dhe jo në të gjitha çështjet e ndërlidhura me këtë problematikë; pastaj do të sqarojmë funksionalizimin pozitiv të këtyre degëve shkencore me shkencën e ajeteve të tilla. Pra, do të shqyrtojmë karakteristikat dhe veçoritë metodologjike, pastaj do t'i krahasojmë me fakte e argumente nga jeta jonë aktuale në da'vet e arsim. Me këtë synojmë që këtë pjesë të shkencës mekase dhe medinase ta bëjmë peshore ose

dëshmi qendror për t'u kthyer te Kurani fisnik në të gjitha çështjet tona të da'vetit e të arsimit.

S'e kemi ndër mend të zgjerohemi shumë në këtë çështje, përpos asaj që është e domosdoshme, që të jetë vetëm si postulat për të ardhmen në shkencë. As që e kemi ndër mend të merremi me dyshimet dhe thumbimet e orientalistëve, laikëve, modernistëve, të atyre të infiltuar dhe të atyre që janë të helmuar me mendimin perëndimor - orientalizmi laik modernist iluminist arab e joarab - përkatësisht me polemikat e tyre rreth tekstit kuranor e historisë së çështjes së ajeteve

kuranore mekase e medinase, sepse kjo është një çështje tjetër, me të cilën janë marrë disa dijetarë të respektuar dhe mund t'i lexoni punimet e tyre nëse dëshironi të përfitonit diçka rreth kësaj problematike<sup>1</sup>

## MBËSHTETJE TE DIJETARËT E DALLUAR TË SHKENCAVE TË KURANIT

S'ka dyshim se nëse dëshirojmë hollësisht të njohim një shkencë, duhet të shfletojmë literaturën burimore të shkencës së tillë, sepse, në të kundërtën, nuk do

të ketë dobi shkencore në të cilën fle zemra e qetësohet truri. Pra, në këtë çështje duhet mbështetur te dijetarët e dalluar të shkencave të Kuranit, për të cilët ummeti është unanim tek udhëheqja dhe lidhshipi i tyre në shkencat kuranore, dhe këtu konkretisht po flas për Imam Zerkeshiun dhe Imam Sujutiun (Zoti i mëshiroftë), sepse secili që vjen pas tyre është mbështetur në punimet e tyre. Edhe pse disa të mëvonshëm janë dalluar në shqyrtimin, parashtrimin dhe analizimin e shkencave të paraardhësve të tyre, përsëri fama u ngel atyre të parëve, pa marrë parasysh kreativitetin e të mëvonshmeve.

Për sa i përket kësaj çështje, Imam Zerkeshiu në librin e tij "El-Burhan fi ulumil-Kur'an", i ka theksuar të gjitha gjërat që kanë të bëjnë me shkencën mekase e medinase.<sup>ii</sup> Edhe Imam Sujuti e ka përcjellë metodën e paraardhësve të tij në librin "El-Itkan fi ulumil-Kur'an" në mënyrë të hollësishme, përpos faktit se duhet rregulluar dhe radhitur çështjet që i ka theksuar rreth rregullave, cilësive dhe tipareve të ajeteve mekase e medinase.<sup>iii</sup>

Studimi i Shejh dr. Muhamed Abduladhim Zerkanit "Menahilul-urfani fi ulumil-Kur'an", sipas meje ka një radhitje më të mirë të çështjeve që kanë të bëjnë me ajetet mekase e medinase dhe mendoj se do të ishte e dobishme nga aspekti shkencor që t'i theksoj karakteristikat metodologjike dhe tematike të kësaj çështje në formë të rezymesë. Në këtë kontekst ai thotë: "Nga karakteristikat e pjesës mekase theksojmë se më së shumti vërehen këto gjëra:

Aty sulmohet ashpër idhujtaria e totemizmi, ashtu siç kritikohen ashpër edhe gënjeshtret e banorët e Mekës që ngulnin këmbë në idhujtari e totemizëm.

Kur mbështeteshin dhe argumentonin me qëndrimet e baballarëve të tyre, ai u flet për respektin e njeriut që e cenonjë me këta guralecë e idhuj, si dhe i qorton ëndërra e tyre dhe e baballarëve të tyre, të cilët e kanë anashkalluar shikimin në vete dhe në ajetet e Zotit në horizonte.

Ai ua ka hapur sytë për t'i parë dëshmitë e të vërtetës në veten e tyre e në gjithësi, duke ua theksuar argumentet e llojllojshme e të ndryshme, dhe në bazë të të cilave do të binden në monoteizmin e Zotit, në hyjninë dhe në besimin në ringjallje, në përgjegjësi, dhe në shpërbllimin e drejtë e të saktë.

Aty flet për traditat e tyre të këqija, si p.sh., vrasja, derdhja e gjakut, mbytja e vajzave, prekja në nder dhe ngrënia e pasurisë së jetimëve.

Aty sqarohen parimet e moralit dhe të drejtat e shoqërisë në mënyrë të çudit-

shme, ua qorton kufrin, mëkatin, gjynahun, kaosin e injorancës, natyrën e thatë, zemrën e keqe, ashpërsinë në fjalë, duke i nxitur që ta duan besimin, nënshtrimin, sistemin, diturinë, dashurinë, mëshirën, sinqeritetin, respektin ndaj të tjerëve, mirësinë ndaj prindërve, respektimin e fqinjëve, pastërtinë e zemrës, pastërtinë e gjuhës etj.

Aty rrëfohen ngjarjet që u kanë ndodhur pejgamberëve e të dërguarve të mëparshëm me këshilla të bukura, me leksione të dobishme, si dhe konfirmojnë se nga ligjet hyjnore kozmologjike është shkatërrimi i idhujtarëve, jobsimtarëve dhe se besimtarët dhe mirësia do të ngadhënjëjnë pa marrë parasysh se sa do të vonohen, përderisa e kanë ndihmën e të vërtetës dhe të besimit.

Në mënyrë të thukët u drejtohet banorëve të Mekës përmes sureve mekase, që janë të shkurtra e që kanë po ashtu edhe ajete të shkurtra, sepse ata ishin elokuentë, të zotët e gjuhës dhe ekspertë në shprehje. Forma e tillë e thukët në fjalë përputhet me natyrën e tyre gjuhësore.

Ligji i urtësisë së lartë hyjnore caktoi që të shkohej në mënyrë graduale në edukimin e individëve, duke u dhënë përparësi gjërave më të rëndësishme. Nuk ka dyshim se besimi, morali dhe traditat janë forma të adhurimit dhe të marrëdhënieve precize".<sup>i</sup>

Për sa u përket karakteristikave të ajeteve medinase, ai thekson:

Aty bisedohet për saktësinë e ligjeve, për detajet e parimeve dhe llojet e ligjeve qytetare, penale, luftarake, shoqërore, shtetërore, civile dhe llojet e ndryshme të ibadeteve e relacioneve dhe nëse dëshiron, shih suret Bekare, Nisa, Maide, Enfal, Kital...

Aty ftohen ithtarët e librit, përkatësisht çifutët dhe të krishterët në Islam, zhvillohet polemikë rreth besimeve të tyre të kota, u sqaron bastardimin e tyre të së vërtetës dhe falsifikimin e Librit të Zotit, si dhe kërkon prej tyre që të mbështeten në tru e në histori. Nëse dëshiron, shih suret Bekare, Ali Imran, Maide, Fet'h etj.

Më duket se kjo që u tha në këtë pjesë rreth karakteristikave dhe veçorive të ajeteve mekase e medinase, është e mjaftueshme për t'i krahasuar me disa aplikime bashkëkohore të da'vetit dhe për të parë se sa mund të aplikohet shkencë e tillë.

## APLIKIME PRAKTIKE TË SHKENCËS SË AJETEVE

Për sa i përket mënyrës së funksionalizimit të kësaj shkencë në jetën tonë të

da'vetit, mund të them se obligohemi që të analizojmë atë që e dëgjojmë dhe që e shohim në mendimet e ndryshme informative për t'i krahasuar metodat dhe temat e ligjëratave e të vazëve të tilla me metodologjinë kuranore. Secili që largohet nga metoda kuranore në da'vetin në Zot, do të dështojë. Jam shumë i bindur se situata e shoqërive tona bashkëkohore në Lindje e në Perëndim nuk dallohet shumë nga situata e shoqërisë mekase dhe medinase kur u shpall Kurani fisnik në mesin e tyre, me qëllim që ta përmirësojë jetën e tyre në besim, moral e shoqëri. Duhet përqendruar gjatë thirrjes në Islam në përdorimin e argumenteve shkencore dhe kozmologjike mbi ekzistimin e Zotit të Madhërisëm, që është i vetëm dhe që nuk ka lindur. Ne duhet përqendruar në estetikën e Islamit dhe në bukurinë e Krijuesit, Kreatorit, Formuesit dhe të Mençurit, që është i pastër nga të metat. Nuk mund të shihet kjo bukuri hyjnore, përpos vështrimit dhe përsiatjes rreth krijesave të cilat i ka krijuar Zoti i Madhërisëm rreth nesh dhe, në këtë mënyrë, të shtohet besimi i tyre.

Para se të përforcohet ideja dhe ëmbëlsia e besimit në zemrën e njeriut, nuk duhet që në asnjë mënyrë të dalim në ndonjë tematikë tjetër, dhe nëse veprojmë kështu, atëherë do të ndodhë sikur me e vjelë frytin para se t'i vijë koha e të piqet. Si duket, hadithi i transmetuar nga Muadh ibn Xhebeli, sahab i njohur, kur e dërgoi Pejgamberi (a. s.) në Jemen dhe ia tregoi mënyrat e da'vetit që duhet t'i aplikojë me ithtarët e Librit në Jemen, është argument më i mirë rreth kësaj çështje. Biseda rreth parimeve të shariatit para përforcimit të besimit në zemër, është vetëm humbje e kohës, punë e kotë dhe e kundërshton metodën kuranore dhe udhëzimin pejgamberik në da'vetin në Zot. Nëse ndokush pyet për urtësinë e da'vetit islam në fillim të periudhës mekase, për ta përforcuar besimin e vërtetë në imanin në Zot dhe në Pejgamberin e Tij, e jo edhe në tema të tjera përmirësuese, atëherë mund të themi se përgjigje më e mirë e një analize të tillë do të ishte fjala e prof. Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë) në tefsirin e tij "Fi dhilalil-Kur'an", posaçërisht në hyrjen e sures En'am, ku gjejmë përgjigjen e mjaftueshme e bindëse: "Ithtarët e Da'vetit në fenë e Zotit dhe në formimin e sistemit ku aplikohet kjo fe në jetën reale, duhet të qëndrojnë gjatë para kësaj dukurie të madhe, përkatësisht në dukurinë e sfidimit të Kuranit mekas gjatë trembëdhjetë viteve, për të përforcuar këtë besim pa u ndalur në imtësira dhe në ligje të këtij sistemi, të cilat

do të aplikohen në shoqërinë islame. Ur-tësia e Zotit ishte ajo që caktoi çështjen e besimit si temë boshte që nga fillimi i mesazhit dhe të fillojë Pejgamberi (a. s.) në fillim të hapave të para të da'vetit me ftesën e njerëzve që të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, t'ua mësojë njerëzve Zotin e tyre të vërtetë dhe të adhurojnë Atë e jo ndonjë tjetër...”<sup>v</sup>

Them se ne duhet t'i risjellim këto të vërteta që mungojnë në ligjëratat tona, në shkrimet tona, në panelet tona, në simpoziumet tona, në derset tona dhe në diskutimet tona me të tjerët. Ne sot vërejmë rrethana dhe situata të njerëzve njësoj si ato që ishin në të kaluarën, në periudhën mekase, dhe në vazhdim do t'i theksoj disa përvoja që i kam parë e që janë në kundërshtim me atë që na urdhëron e që na udhëzon Sunneti i Pejgamberit (a. s.).

Kam parë shumë thirrës në Zot në vendet arabe, evropiane dhe te ne në Gadishullin Ballkanik, përkatësisht në Kosovë, në Bosnjë e Hercegovinë, në Mal të Zi, në Maqedoni të Veriut, Shqipëri e Serbi që e kanë anashkaluar këtë të vërtetë të madhe në da'vetin në Zotin e Madhërishtëm, madje të njëjtën gjë e kam hasur edhe në shtetet tjera të botës.

Kam vërejtur se shumica prej tyre harrojnë ose qëllimisht bëhen se harrojnë, e lënë anash me qëllim ose pa qëllim të kuptuarit e natyrës dhe të karakteristikave të Kuranit mekas.

Gjatë takimeve të mia dhe gjatë programeve të tyre në video, të emetuarë në rrjetin e internetit, kam vërejtur se shumica prej tyre flasin për gjëra anësore rreth Islamit, duke qëndruar larg çështjeve prioritare dhe të vërtetave të mëdha, në të cilat përqendroheshin Kurani fisnik dhe Pejgamberi (a. s.) në periudhën mekase, përkatësisht larg asaj që e kemi parë gjatë studimit të periudhës mekase e medinase (karakteristikave dhe tematikave të dy periudhave).

Kam vërejtur se disa prej tyre kërkojnë aplikimin e ligjeve të sheriatit në sistemet e qeverive laike e që janë në përgjithësi e në veçanti kundër Islamit, fshehurazi dhe haptazi, në individ e në shoqëri, në institucione e qeveri; a janë në fillim të rrugës së gjatë, të vështirë e të mbuluar plot pengesa e ferra e jo me lule e karafila.

I shoh se kërkojnë prej myslimanëve që kanë besim të dobët e që bëjnë mëkate të mëdha e të vogla, që janë zhytur thellë në zina, kamatë e në dëmtimin e prindërve, punojnë me ryshfet, bëjnë tregti me lavire, bëjnë tregti me lëndë narkotike, nuk punojnë dhe merren me amoralitet. Pra, vërej se të tillët kërkojnë



prej njerëzve të tillë që të lëshojnë mjekrën, të ndryshojnë pamjen e jashtme, të vishen ndryshe nga ajo që vishen në vendet e tyre, të aplikojnë këtë metodologji të dukshme, të përhapin këtë kulturë nëpër institucione, shkolla e kompani në të cilat punojnë, qoftë edhe nëse i dëbojnë nga puna apo shkolla në shtetet e tilla laike! Pra, në vend që të thirrin në teube të sinqertë, në përforsimin e besimit me punë të mirë, në prezantimin e tyre në mexhlise shkencore, në mirësjellje ndaj prindërve e fqinjëve e të përmirësohen gradualisht lart e më lart, ata të mjerët i thirrin në përmirësimin e të dukshmes, duke braktisur përmirësimin e të padukshmes!

I kam parë duke i këshilluar njerëzit që t'i shkurtojnë teshat dhe pantallonat, me pretekst se veshjet tona janë veshje të perëndimorëve jobesimtarë. Pra, sipas tyre, dalja nga situata është veshja pakistaneze, afgane, ose arabe?! Sipas tyre, kjo veshje është veshje islame, që theksohet në Kuran e në Sunnet!

Njerëzit e tillë urdhërojnë ndryshimin e medhhebit juridik sunnit, të cilit i takojnë dhe të cilin e kanë trashëguar nga gjyshërit e stërgjyshërit e tyre, për të pranuar një medhheb tjetër të importuar! Ata argumentojnë se medhhebi hanefit është

formuar në bazë të disa haditheve iluzore, nuk është i mirë dhe se nuk duhet punuar sipas rregullave të këtij medhhebi!

Një njeri të cilit i besoj, më ka treguar se i ka parë disa të rinj të tillë ekstremistë duke u kacafytur me xhematin sunnit hanefit brenda xhamisë në një qytet kosovar, duke i akuzuar si jobesimtarë, të pafe dhe se namazi i tyre është i kotë dhe i papranuar!

#### MBULESA NË ISLAM, SIPAS TRADITËS VENDORE

I kam parë dhe dëgjuar duke kërkuar prej femrave që të veshin mbulesën dhe të mbulojnë tërë trupin dhe fytyrën (me shami në kokë ose nikab), sepse sipas tyre mbulesa e nënave të tyre, përveç duarve dhe fytyrës, është mbulesë jo sipas sheriatit, dhe se ngjyra e vetme e mbulesës duhet të jetë e zezë, duke haruar se sheriatu islam, si mëshirë ndaj njerëzve, nuk ka folur për çështje të tilla, duke i lënë të lirë njerëzit që të veprojnë sipas traditës së tyre në vendet ku jetojnë. Nuk ka asnjë tekst të sheriatit, as nga Kurani e as nga Sunneti, që përshkruan ngjyrën e mbulesës, përpos disa kushteve, rregullave e gjërave të përgjithshme, të cilat i kanë përcaktuar

fukahatë dhe ulematë për hixhabin sipas sheriatit: të mos jetë mbulesa e tejdukshme, atraktive, e ngushtë dhe as e hollë. Zoti e mëshiroftë Imamin dhe dijetarin e njohur Shejh Abdullah bin Bazin, i cili në një program “Nurun aled-derbi” në Radio Kurani Kerim në Arabinë Saudite, kur flet për dimensionin kulturor dhe tradicional, nga thellësia e zemrës thotë: “Mbulesa e gruas lindore dallon nga mbulesa e gruas perëndimore.” (Dhe, mund të krahasoj këtë fetva ose këtë parim të sheriatit me të gjitha llojet e mbulesave në botë, qoftë në Turqi, Malajzi, Britani,<sup>v</sup> Amerikë, Australi ose Gjermani)

Kam vërejtur se shumica prej tyre mbjellin fitne dhe urrejtje në mes grupeve të shoqërisë islame, duke importuar disa fetva nga disa vende arabe, të cilat bien ndesh me traditat aktuale, si p.sh. moslejimi i gruas për të drejtuar automjetin në vendet evropiane, ose moslejimi i pjesëmarrjes së saj në jetën e përgjithshme, e cila gjë lejohet sipas Islamit.<sup>vii</sup>

I kam parë duke i nxitur të rinjtë që të përdorin dhunën, duke i thyer e shkatërruar gurët e varrezave të myslimanëve e të jomyslimanëve, gjë që kërkoi intervenimin e menjëhershëm të forcave të rendit publik, për të qetësuar zjarrin që e

ndiznin të rinjtë e tillë të edukuar, energjikë e të denjë dhe për t'i vendosur të rinjtë nëpër burgje e në lista të zeza.

Kam vërejtur se shumica prej tyre i thumbojnë personalitetet e njohura zyrtare historike, nacionale, politike e diplomatike të vendeve tona, gjë që krijoi reagim të ashpër nga qarqet qeveritare dhe hapje të proceseve e hetimeve në institucionet dhe simbolet zyrtare fetare në vend.

Kam parë se si disa prej tyre kanë trilluar një formë të re të dhunës me njerëzit: të jenë të ashpër, të dhunshëm e agresivë me myslimanët në vendet evropiane dhe në Gadishullin Ballkanik.

I kam parë duke diskutuar në minbere çështje të sihirit, magjisë dhe pritjes së sihirit dhe ç'bën magjistari me të sëmurin.

Ka edhe shumë e shumë situata të tilla të çuditshme e të dyshimta, për të cilat s'ka vend të theksohen këtu hollësisht dhe mendoj se mjafton vetëm kjo që përmenda deri këtu.

Them se ata shpejtuan në pritjen e rezultateve të da'vetit të tyre dhe, për fat të keq, rezultatet nuk ishin shpresëdhënëse, për shkak se ata i mohonin këto të vërteta të da'vetit me njerëzit që janë njësoj sikur myslimanët e rinj të periudhës së Mekës.

Kjo ishte, nga njëra ana, ndërsa nga ana tjetër, ata kundërshtonin dhe kritikonin dijetarët dhe thirrësit në fe, të mëparshmit e më të vjetrit në vendet e tilla, si dhe binin ndesh me traditat e zakonet e vendeve ku jetonin, dhe kështu çështja e tyre ishte paraprakisht e dënuar me disfatë, pa marrë parasysh se ata mendonin se gjoja bënëin vepër të mirë.

*(Autori aktualisht ligjëron në disa universitete në Katar në gjuhën arabe dhe angleze. Tekstin për “Hënën e Re” e sjell prof. dr. Muhamed Mustafa, ligjërues i Gjuhës Arabe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup)*

<sup>i</sup> Si shembull konkret theksoj studimin e Shejh dr. Muhamed Abduladhim Zerkani: “Menahilul-urfani fi ulumil-Kur'an”, posaçërisht kapitullin mbi ajetet mekase e medinase, vëll. I, fq. 168; Studimin e Shejh dr. Muhamed Ahmed Fadil: “El-Itixhahul-ilmanij el-me'asir fi ulumil-Kur'an”, studim dhe kritikë, fq. 276-307; Studimin e dr. Ahmed Idrisit me titull: “El-Ilmanijun vel-Kur'anul-Kerim”, historiku i tekstit, kapitulli mbi ajetet mekase e medinase nga koncepti bashkëkohor, fq. 530-589; Studimin e profesorshës Munna Muhamed Muhjuddin me titull: “Et-Tejjarul-ilmani el-hadith ve meukifuhu min tefsiril-Kur'anil-Kerim”, fq. 212-302.

<sup>ii</sup> Zerkeshi, Bedruddin Muhamed ibn Abdullah ibn Behadir (794 hixhri), El-Burhan fi ulumil-Kur'an, tahkik Muhamed Ebu El-Fadël Ibrahim, bot. IV, 1428 hixhri, Daru ihajail-kutubil-arabijeti, Kajro, vëll. I, fq. 187; Ez-Ziajide vel-ihsan fi ulumil-Kur'an (1150 hixhri), vëll. 1, fq. 216.

<sup>iii</sup> El-Itkan fi ulumil-Kur'an, vëll. 1, fq. 167.

<sup>iv</sup> Zerkani, Muhamed Abduladhim, Menahilul-urfani fi ulumil-Kur'an, vëll. 1, fq. 193-203.

<sup>v</sup> Po aty.

<sup>vi</sup> Më ka pyetur një motër (Zoti e mëshiroftë) për qëndrimin e Islamit ndaj votimit të femrës myslimane në kushtet e politikanëve jomyslimanë në vendet perëndimore, dhe ajo banon në Londër dhe ka shtetësi të Britanisë, dhe unë i jam përgjigjur asaj në mënyrë të shkurtër e të qartë se çdo vend i ka karakteristikat e veta kulturore, tradicionale, politike e ligjore, dhe se myslimaneja duhet të ketë kujdes nga kulturat, traditat dhe ligjet që i kundërshtojnë parimet islame, dhe se nuk ka të keqe nëse i pranon ato që nuk e kundërshtojnë sheriatin (Kurandin ose Sunnetin). Ne obligohemi të pranojmë kulturat e mira dhe t'i hedhim ato të këqijat, sepse kështu mendojnë ulemaja. I kam thënë asaj: “Oj motra ime e vogël dhe e respektuar, mos harro se Londra nuk mund të shndërrohet në Mekë e as Meka në Londër! Të dyja qendrat kanë karakteristika të posaçme kulturore, tradicionale, mjedisore e fetare, dhe se duhet respektuar parimin se ajo që s'mundet në Mekë, lejohet në Londër dhe e kundërta. Ti je ambasadore e Islamit në ato vende, ke hyrë atje me pëlqimin tënd dhe të atyre, ke pranuar shtetësinë e tyre me pëlqim dhe kështu ke përgjegjësi ashtu siç kanë vendasit tjerë të Londrës dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet të veprosh kundër ligjeve kushtetuese të atij shteti, me arsyetimin se ti je myslimane dhe mbrojtëse e fesë tënde, sepse në të kundërtën ti do të ishe mëkatore. Besoj se libri i mendimitarit mysliman dr. Tarik Ramadan me titull “En tekune muslimen urubijjen” është shumë i dobishëm për sqarimin e çështjeve të tilla.

<sup>vii</sup> Ebu Shekka, Abdulhalim, Tahrirul-mer'eti fi asir-risaleti, bot. 5, 1999, Darul-Kalem, Kuvajt, vëll. 1, fq. 69-102.

# KALON NË AHIRET EDHE HAFËZ HUZRI EF. IDRIZI

Më 28 prill, 2022, ka ndërruar jetë hafëz Huzri ef. Idrizi nga fshati Bukaviç i Shkupit, kanë njoftuar familjarët.

Siç bëhet e ditur nga Selajdin Ramadani, më parë, tash shpejt, nga kjo botë është larguar edhe babai i tij, hafëz Bexhet ef. Idrizi. Të dy, babë e bir, ka shkruar ai, tërë jetën ia kanë kushtuar mësim, besimit dhe dinit të Allahut.

Lamtumirë nga kjo botë e përkohshme, hafëzi i zemrës sime; Allahu na takoftë në xhenetet e Tij, ka shkruar Burim ef. Hamdiu në faqen e vet në Facebook dhe ka shtuar: "Kisha nderin të jem hafëzi i parë që nxore ti. Tash nuk je në mesin tonë që të krenohesh për arritjet e mia, mirëpo çdoherë kur të më pyet dikush se ku e kam mësuar Hifzin, unë me krenari do


të përgjigjem se e kam mësuar te hfz. Huzri Idrizi."

Përcillet me nderime për në ahiret hfz. Huzri ef. Idrizi, ka shkruar më 29 prill Myftiu i Myftinisë së Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili. Në vazhdim të njoftimit të tij thuhet: Sot pata nderin që të prezantoj në ceremoninë e varrimit të rahmetli hfz. Huzri ef. Idrizi. Ai sot, në ditën e 28-të të muajit të bekuar të Ramazanit, u përcoll për në banesën e fundit nga një xhemat i madh, me pjesëmarrje të gjerë hoxhallarësh të anës së Dervenit e më gjerë, duke e lutur Allahun e Madhërishëm që ta fal, ta mëshirojë dhe t'ia bëjë varrin e tij bahçe xheneti. Allahu e shpërbleftë me xhenet! – ka thënë Myftiu i Myftinisë së Shkupit.



Një vizitë ngushëllimi te familja Sadiku, me rastin e ndërrimit jetë të Taxhudin Sadikut, baba i z. Ardit Sadiku, si dhe kushëri i parë i dr. Ferit Sadiku, z. Talat Sadiku, Referent pranë Myftinisë së Gostivarit dhe prof. Refet Sadiku, mësimdhënës në Paralelen e Vajzave në Gostivar. I shoqëruar nga Myftiu Sabahudin Zendeli dhe stafi i tij, shprehëm ngushëllimet tona të përzemërta, duke iu lutur Allahut Fuqiptotë që t'u japë durim të paluhatshtëm, ndërsa rahmetiut t'i fal xhenetin. Në të njëjtën ditë respektuam edhe familjen Ismaili, me rastin e ndërrimit jetë të veteranit të arsimit Shefket Ismaili, baba i z. Besnik Ismaili, drejtor rajonal i "Stopanska Banka", të cilit po ashtu i shprehëm ngushëllime, duke iu lutur Allahut Fuqiptotë për durim, ndërsa rahmetiut - xhenetin e amshueshëm. Zoti i mëshiroftë – ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hf. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 30 prill, 2022.

# IA DORËZOI SHPIRTIN ALLAHUT HAFËZ JUSUF ABDULLAHU



Më 28 mars, 2022, ia dorëzoi shpirtin Allahut njëri nga bilbilat e xhamive të Shkupit, Imami i dikurshëm i xhamisë "Isa Beu" – hfz. Jusuf Abdullahu. Allahu e shpërbleftë për gjithçka që ka bërë për këtë fe dhe për myslimanët në përgjithësi, thuhet në njoftimin e xhamisë "Isa Beu" në Shkup.

Falja e merhumit bëhet me namazin e iqindisë në Xhaminë Isa Beu, ndërsa varrimi në varrezat e fshatit Hotël (Kumanovë), kanë njoftuar të njëjtën ditë nga familja.

Sot, në prani të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, prezantuam në faljen e namazit të xhenazes të rahmetli hafëz Jusuf Abdullahut, ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Hafëz Jusuf Abdullahu, imam i mëparshëm i xhamisë "Isa Beu", tërë jetën e tij ishte i lidhur ngushtë me xhematin dhe ishte në shërbim të besimtarëve dhe të xhematit të Shkupit e me gjerë.

Gjatë gjithë kohës sa i shërbeu këtij xhemati si Imam, i jepnin nur shumë veti të mira morale; para së gjithash, dija, modestia, durimi dhe përpikëria në kryerjen e detyrës.

Hafëz Jusuf Abdullahu do të mbahet

mend për zërin e bukur. Allahu (xh. sh.) e pastë nën mëshirën e Tij! – ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Shkupit.

Me dhimbje të madhe përcollëm për në botën tjetër imamin dhe hafëzin e mirënjohur, rahmetli Jusuf ef. Abdullahun, ka deklaruar në vazhdim Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Në fjalën time ngushëlluese, me qëllim të dëshmisë në emër të BFI-së, theksova se rahmetli hafëz Jusuf ef. Abdullahu ishte një besimtar i devotshëm, një prind shembullor dhe, mbi të gjitha, një imam dhe një hafëz që i shërbeu Islamit tërë jetën në mënyrë dinjitoze.

Shërbeu në xhaminë e mirënjohur "Isa Beu" në Shkup dhe gjithmonë ishte i gatshëm të vihet në shërbim të nevojave të besimtarëve dhe të Bashkësisë Fetare Islame të RMV.

Zoti i kishte falur zë të këndshëm dhe lexim të bukur të Kuranit famëlartë, që i jepte kënaqësi shpirtit, zemrës dhe syve. Ishte simbol i Shkupit dhe i gjithë myslimanëve të Ballkanit.

Neve na mbetet ta kemi inspirim të gjallë për jetën dhe veprat tona.

Në emër të xhematit foli Imami Muharrem ef. Ismaili, namazin e xhenazes e fali Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, ndërsa duanë e bëri h. Fesal ef. Kadriu, Referent pranë Myftinisë së Shkupit.

Në emër të BFI të RMV dhe në emrin tim iu shpreh ngushëllime të thella fa-

miljes, Myftinisë së Shkupit dhe gjithë besimtarëve, duke iu lutur Allahut Fuqiptotë që t'u japë durimin e pashoq, ndërsa rahmetli hafëz Jusufin ta bashkojë me robtë e mirë të Allahut Fuqiptotë në Xhenetin e amshueshëm, ka deklaruar Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Me mesazh ngushëllimi kishin dalë Myftinia e Shkupit dhe Myftiu i saj dr. Qenan ef. Ismaili. Në mesazh thuhet: Hafëz Jusuf Abdullahu mbi tridhjetë vjet e kreu me përkushtim detyrën e Imamit në xhaminë "Isa Beu" në Shkup. Nga thellësia e zemrës i shprehim familjes së tij ngushëllimet më të sinqerta. Familja e tij humbi njeriun e tyre të dashur, xhemati i tij imamin e përkushtuar, kurse Shkupi hafëzin e dalluar, që i shërbeu xhematit dhe xhamisë gjatë gjithë jetës. I bëjmë lutje Allahut të Madhërishëm që ta shpërblejë me Xhenet për kontributin e tij! – thuhet në mesazhin e ngushëllimit të Myftinisë së Shkupit dhe të Myftiut të saj.

Hafëzllarët janë kategoria më e lartë e ummetit. Pa dyshim, njëri prej tyre është edhe hafëz Jusuf Abdullahu nga fshati Hotël, komuna e Likovës, imam shumëvjeçar në xhaminë "Isa Beu" të Shkupit. Me zërin e tij të mrekullueshëm dhe me moralin e tij të lartë, ai ka lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e xhematit të tij dhe më gjerë. Allahu e mëshiroftë agën Hafëz dhe me Xhenetin Firdeus e gradoftë. Amin – ka shkruar hoxha nga Kumanova Eljasa ef. Mahmudi.



Në vizitë ngushëllimi te familja Abdullahu, me rastin e ndërrimit jetë të hafëzit të mirënjohur Jusuf ef. Abdullahu. Bashkë me Myftiun e Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, dhe bashkëpunëtorët tjerë, shprehëm përkrahjen tonë institucionale për këtë dhimbje dhe humbje të madhe. Iu dëshiroam sabër të pashoq dhe i bëmë lutje Allahut (xh. sh.) që rahmetiut t'i falë xhenetin e amshueshëm – ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 30 mars, 2022.

# NDËRRON JETË HOXHË AMDI EF. SHEJ NGA VELESHTA

“Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem!”: Ka ndërruar jetë në moshë të re Imami Amdi ef. Shej, ka njoftuar më 20 prill, 2022, Myftinia e Myftinisë së Strugës.

Më tej, në mesazhin e ngushëllimit që ajo ka shpërndarë thuhet:

Ia dorëzoi shpirtin Allahut hoxhë Amdi ef. Shej nga fshati Veleshtë, Imam në Xhaminë Teqe të Veleshtës. Myftinia e Strugës, në emër të Myftiut mr. Salim ef. Sulejmani, hoxhallarëve dhe besimtarëve, i shprehin familjes së merhumit

ngushëllimet më të sinqerta.

Familja humbi njeriun e tyre të dashur, xhemati i tij Imamin, kurse Struga një hoxhë që i shërbeu xhematit dhe xhamisë gjatë gjithë jetës së tij.

I bëjmë lutje Allahut të Madhërisëm që hoxhë Amdi ef. Shejin ta mëshirojë dhe ta shpërblejë me Xhenet, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Strugës.



## KA NDËRRUAR JETË HOXHA I RASHÇES

Më 1 prill, 2022, ia dorëzoi shpirtin Allahut Abdylnuri ef. Poliku, hatib dhe imam në Xhaminë e fshatit Rashçe të Poshme, ka njoftuar Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Në mesazhin e ngushëllimit Myftiu dr. Qenan ef. Ismaili thotë: “Në emrin

tim personal dhe të Myftinisë së Shkupit, ju shpreh ngushëllime të thella të gjithëve që e kanë njohur; në veçanti, familjes së ngushtë. Allahu ju dhashtë sabrin. Allahu e mëshiroftë me Xhenetin e amshueshëm Abdylnuri ef. Polikun.”

## ZUKORLIQ ËSHTË HELMUAR!?

Kryetari i Partisë për Drejtësi dhe Pajtim (SPP) në Serbi, Usame Zukorliq, tha më 10 prill, 2022, se analizat e dy laboratorëve të huaj tregojnë se babai i tij, themeluesi i partisë dhe ish-myftiu i Sanxhakut, Muamer Zukorliq, nuk ka vdekur nga shkaqet natyrore, ka njoftuar Radio Evropa e Lirë (REL).

Duke iu drejtuar publikut, ku morën pjesë familjarë të shumtë, ai tha se në ata laboratorë kanë dërguar mostra për analizë dhe se rezultatet janë bazë për dyshimin se Zukorliq ka qenë i helmuar.

Ai nuk saktësoi se për cilët laboratorë bëhet fjalë dhe as nga cili shtet, duke bërë të ditur se familja do të informojë publikun për gjithçka në kohën e duhur. Ai shtoi se do të nisin një hetim para autoriteteve gjyqësore për të “përcaktuar përfundimisht shkaku e vdekjes” së



Muamer Zukorliqit, i cili ishte nënkryetar i parlamentit serb.

Muamer Zukorliq ka vdekur më 6 nëntor 2021 në moshën 51-vjeçare. Si

shkak i vdekjes u përmend një sulm në zemër, ka njoftuar Radio Evropa e Lirë. (REL/në bashkëpunim)

# NAIM MEHMETI, TI NUK ISHE SOT NË XHAMI!

*Nga Hysein ef. Rizai*

E xhuma. Por, jo si xhumatë tjera! Ishte më ndryshe.

Ti, Naim, nuk ishe sot në xhami!

Ndjeva një zbrazëti, sikur i vetëm isha në xhami. Shikimi im gjithë kohën ngeli mu te vendi ku ti uleshë. Nuk e di pse, ende të prisja se do vish.

Gëzoju vdekjes tënde, vëlla Naim!

Kur një mik, dost, kushëri ndërron jetë, e gjithë pjesa e jetës në të cilën ai ka qenë prezent zgjohet dhe trazohet ashtu siç trazohet deti nga erërat e fuqishme. Kështu më ndodhi edhe mua pas rastit të vdekjes së mikut, shokut, kushëririt tim të dashur, Naim Mehmeti.

Largimi yt nga kjo botë ndodhi ashtu sikur ta kishe përgatitur vetë ti vdekjen tënde. M’u desh kohë për t’u bindur se ti nuk munde të më lajmëroje për vdekjen tënde. Ndodhi aq shpejt dhe ike në heshtje, tamam ashtu si ishe i heshtur gjatë jetës tënde.

Kjo vdekje do të ngelë në kujtimet e mia, sepse ndodhi në Xhaminë Tabhane (Tetovë), ditën e xhuma, në kohën kur unë isha duke mbajtur ligjëratën e kësaj dite.

Gjithnjë do të më shfaqen ato imazhe të asaj rrëmuje të njerëzve që vrapuan për t’ju ndihmuar, sepse ti vetëm se ishe në agoni të vdekjes!

Erdha pranë teje dhe mundohesha të flas me vdekjen tënde. Po! Buzëqeshja jote në ato momente me fliste se ti je

duke ia dorëzuar shpirtin Krijuesit të Gjithësisë, ndjeja se je nën mëshirën e Allahut. Në ato momente unë iu dorëzova erës së furishme që filloi simfoninë e saj brenda shpirtit tim, duke trazuar çdo skutë të kujtesës dhe duke ngjallur çdo çast e përjetim që lidhej me Naimin.

Naimi vërtet ishte djalë i mirë dhe shumë i qetë. Në çdo bisedë me të ndjehej se ishte shumë stabil dhe i sinqertë. Kishte një kulturë shumë të lartë, që vërehej edhe në fytyrën dhe në buzëqeshjen e tij.

Asnjëherë në jetë nuk më ka shkuar në mend se Naimin do ta humbim në xhami. Por, ai na la mu në xhami, në ditë xhumaje. Vërtet ishte një vdekje e bukur, të cilën secili prej nesh do ta dëshironte për veten e vet.

Sidoqoftë, një mik, një dashamir, një kushëri dhe një njeri i mirë ndërroi jetë në xhami. Allahu e pastë mëshiruar. Xhumatë në vijim, dhe Xhamia e Tabhanes në veçanti, do të vazhdojnë pa Naimin. Për përherë.

Qofsh i Xhenetit, Naim! Zoti të mëshiroftë!

/8.04.2022/

*(Autori është Hoxhë, i angazhuar në Myftininë e Tetovës)*



Shënim i Redaksisë: Naim Mehmeti (1978-2022) ka ndërruar jetë më 1 prill, 2022. Është varrosur në varrezat e qytetit të Tetovës të nesërmen, më 2 prill. Prej vitit 2014 deri në vitin 2018 ka qenë Ambasador i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Danimarkë.

Rahmetliu është vlerësuar si një politikan me vizion dhe modest. Ka ndërruar jetë një ditë para Ramazanit, në xhami, duke shkuar në sexhde.

Lamtumirë, shoku ynë i shtrenjtë! – ka shkruar gazetari nga Shkupi Semi Mehmeti në faqen e vet në Facebook.

Jemi jashtëzakonisht të pikëlluar me vdekjen e parakohshme të shokut tonë të çmuar Naim Mehmeti. Shpirti i tij i bardhë pastë dritë. Mungesa e tij do të jetë e përjetshme dhe e pazëvendësueshme.

Prehu në paqe, Naim i dashur. Gjithmonë do të të mbajmë në zemër dhe do të kujtojmë pozitivitetin tënd. Ngushëllime më të sinqerta familjes Mehmeti, shokëve dhe farefisit, ka shkruar Semi Mehmeti.

## NGUSHËLLIME PËR ZONJËN OLLBRAJT

Më 25 mars, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i dërgoi telegram ngushëllimi Ambasadore së SHBA-ve në Shkup, znj. Kate Byrnes (Kejt Bërns), pas kalimit në amshim të ish-Sekretares së Shtetit të SHBA-ve, znj. Madeleine Albright (Medlin Ollbrajt), thuhet në njoftimin e BFI.

“Shkëlqesia Juaj, Ambasadore e

SHBA-ve Kate M. Byrnes. Më lejoni që në emrin tim dhe në emër të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shkup dhe Stejt Departamentit Amerikan t’u përcjell ngushëllime të sinqerta për kalimin në amshim të ish-Sekretares së Shtetit të SHBA-ve, znj. Madeleine Albright, dhe largimi i saj nga kjo jetë është një humbje e madhe.

Sekretarja Albright ishte mike e madhe e popullit tonë, simbol i shpresës, dashamirë e paqes dhe luftëtare e pakompromis për liri dhe demokraci. Kujtimi për të do të mbetet përgjithmonë. Përjetësisht i jemi falënderues”, thuhet në telegramin e ngushëllimit të Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu drejtuar Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, njoftojnë nga BFI.



**Agjencia për Hallall Standard**  
**Агенција за Халал Стандард**  
**Helal Standard Ajansı**  
**Agency for Halal Standard**  
**مكتب شهادة للمنتجات الحلال**



**Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.**

**Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.**  
**Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.**  
**Fax: + +389 (0)23117 883**

**websait: [www.bfi.mk](http://www.bfi.mk)**  
**email: [halal.bfi@gmail.com](mailto:halal.bfi@gmail.com)**